



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE
REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK**

RAPORT PËR AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE.

Titulli : “Mbi Auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”

Subjekti: “Universiteti Politeknik,Tiranë”

Auditimi është kryer ne bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 738/1 prot, datë 07.08.2017.

Auditimi është kryer nga:

1. Andrea Kristo, përgjegjës grupi,
2. Valentina Golemi, anëtare,
4. Mimoza Lloji anëtare,
- 4.Aldo Kume anëtar

Auditimi ka filluar më 04.09.2017

Auditimi ka përfunduar më 30.10.2017

Dhjetor 2017



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	Faqe	2-3
Hyrje	Faqe	3-4
Qëllimi dhe procesi i auditimit	Faqe	4
Rezultatet e auditimit 1.Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditivit të mëparshëm. 2.Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. 3.Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave. 4.Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave që realizon institucioni. 5.Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimidispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. 6.Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. 7.Auditimi mbi prokurimin e fondeve publike. 8.Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. 9.Vlerësimi i funksionimit të auditit të brendshëm. 10.Auditim në njësitë e varësisë. 11.Të ndryshme të dala gjatë auditimit.	Faqe	4-115
Konkluzionet dhe Rekomandimet	Faqe	115-130
Anekset	Faqe	131

Përmbledhje

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Universitetin Politeknik të Tiranës, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2015,2016, 2017, respektimin e kërkesave të Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe në lidhje me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore për përdorimin e fondeve buxhetore dhe në zbatim të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Universiteti Politeknik, Tiranë (UPT), si institucion i Arsimit të Lartë Publik, funksionon në zbatim të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, ndryshuar me ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, akteve nënligjore në zbatim të tij. Në zbatim të detyrimeve ligjore UPT, ka miratuar dhe funksionon në bazë të Statutit dhe të Rregullores së Brendshme të Universitetit për administrimin, financimin dhe kontabilitetin, në të gjitha njësitë përbërëse organizative të këtij Universiteti, i cili funksionon mbi bazën e parimit të autonomisë financiare. Auditimi u krye mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë të aktivitetit ekonomiko-financiar, duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin e plotë dhe me zgjedhje. Përveç auditimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

dokumentacionit jemi bazuar edhe në këshillimin dhe ballafaqimet me stafin drejtues e atë administrativ të subjektit të auditimit.

Në përfundim të auditimit me personat përkatës përgjegjës në UPT, u mbajtën aktkonstatime dhe pas ballafaqimeve me personat drejtues dhe zbatues si dhe pasi u shqyrtuan vërejtjet dhe shpjegimet e këtyre punonjësve, paraqitet Raporti i Auditimit.

Hyrja

Universiteti Politeknik i Tiranës ka për mision:

- Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për të tretë si dhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj;

- Të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë të gjithë jetës;

- Të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;

Universiteti Politeknik i Tiranës ka një profil të tij dhe në dallim nga institucionet e tjerë të arsimit të lartë shqiptar, ka një mision të diferencuar: mbulon shkencat teknike, duke përgatitur inxhinierë/arkitektë dhe shkencëtarë të rinj, të aftë për të zgjidhur detyrat përkatëse në ndërmarrjet industriale, në qendrat e projektimit, në institucionet kërkimore-shkencore, etj. Një nga detyrat e rëndësishme të këtij institucioni, është që të shërbejë sa më efektivisht nevojave të vendit në përgjithësi dhe nevojave të komunitetit dhe bizneseve lokale në veçanti.

Nga grupi i auditimit të KLSH-së u ushtrua auditim në lidhje me zbatimin e kriterëve të hartimit të projektbuxhetit afatmesëm 2014-2017 dhe zbatimit të buxhetit të shtetit veçanërisht për vitet 2017 dhe 2016 në lidhje me përdorimin ligjor të fondeve të çelura gjatë këtyre viteve, zbatimi i tarifave ligjore dhe të miratuara në lidhje me krijimin e të ardhurave të institucionit dhe përdorimi i tyre. Gjithashtu u auditua ruajtja, evidentimi i dokumentacionit dhe raportimi buxhetor dhe financiar në zbatim të akteve ligjore në fuqi. Auditimi në Universitetin Politeknik Tiranë, u fokusua në çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me vlerësimin e dokumentacionit bashkëlidhur fondeve të përdorura, në lidhje me vërtetësinë dhe ligjshmërinë e tyre, përdorimin ligjor të fondeve sipas përcaktimeve konkrete në to.

Në njësitë e varësisë së UPT-së, u audituan të ardhurat e krijuara nga institucioni siç janë të ardhurat e krijuara nga oponenca në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN) apo të ardhurat e krijuara nga tarifat e shkollimit dhe përjashtimin nga këto tarifa të shtresës sociale që përfiton nga ligji “Për jetimët”, me ndryshime, Ligji “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” me ndryshime, dhe shtresa të ndryshme sociale që përfitojnë lehtësira për regjistrim.

Një vëmendje e posaçme i është kushtuar auditimit mbi ligjshmërinë e procedurave të prokurimit publik në përdorimin e fondeve për kryerjen e shërbimeve, blerjen e mallrave dhe pajisjeve.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Objekti i auditimit – Auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, për veprimtarinë ekonomiko-financiare dhe aktivitetin financiar të Universitetit Politeknik Tiranë prej datës 01.01.2014 deri 30.09.2017 dhe njësitë e varësisë të tij.

Qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit apo lëshimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes..

Identifikimi i çështjes. Auditimi u krye në lidhje me hartimin dhe zbatimin e buxhetit të institucionit, përdorimin e fondeve publike të çelura nga buxheti dhe të ardhurat e vet institucionit, procedurat e prokurimit public me fonde publike dhe nga të ardhurat e pakushtëzuara.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar. Nga auditimi për funksionimin e veprimtarisë së Universitetit Politeknik Tiranë u konstatuan mangësi në plotësimin e kuadrit ligjor, pas daljes së Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, pasi ndonëse kanë kaluar mbi 2 vjet nga miratimi i këtij ligji Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, nuk kanë hartuar dhe miratuar një pjesë të rëndësishme të akteve nënligjore (VKM dhe Udhëzime) si derivate të ligjit të mësipërm, pasi mos miratimi i tyre ka krijuar një ngërç në funksionimin e institucionit, në aspektin organizativ, e konkretisht:

Përgjegjësitë e audituesve. Baza për opinionin e kualifikuar mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë së Universitetit Politeknik Tiranë (UPT), është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 4100¹ dhe 4200²)

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga Universiteti Politeknik Tiranë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale për nga sasia, **por janë materiale për nga konteksti**³, të cilat konsistojnë si më poshtë:

Kriteret e vlerësimit. Auditimi u krye duke u mbështetur në dispozitat ligjore dhe nënligjore si më poshtë:

Ligji 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligji nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar me ligjet nr. 9832, datë 12.11.2007, ligjin 10 307, datë 22.07.2010; ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë Publik në Republikën e Shqipërisë, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjet vjetore të buxhetit për vitin 2014, 2015, dhe udhëzimet në zbatim të tyre; ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Vendimet e Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore” si dhe “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit

¹ **ISSAI 4100** – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

² **ISSAI 4200** - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare

³ **ISSAI 1320:** Përcaktimi i materialit për nga konteksti përfshin gjykimin profesional të audituesit, i cili ndikohet nga akuptueshmëria që ka audituesit nga njësisë, procedurave të vlerësimit të riskut, si dhe natyrës dhe shkallës së shkeljeve të konstatuara



KONTROLLI I LARTË I SHITIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë” i ndryshuar, ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit, ligji nr. 114/205 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, etj.

Standardet e auditimit, Auditimi u krye mbështetur standardeve ndërkombëtare të auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, përveç efekteve të cështjeve që përshkruhen në paragrafin e Bazës për Opinion të Kualifikuar, transaksionet e lidhura me llogaritë vjetore të Universitetit Politeknik të Tiranës për periudhën objekt auditimit, përputhen në të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

GJETJE NGA AUDITIMI

Nga auditimi për funksionimin e veprimtarisë së Universitetit Politeknik Tiranë u konstatuan mangësi në plotësimin e kuadrit ligjor, pas daljes së Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, pasi ndonëse kanë kaluar mbi 2 vjet nga miratimi i këtij ligji Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, nuk kanë hartuar dhe miratuar një pjesë e rëndësishme e akteve nënligjore (VKM dhe Udhëzime) si derivate të ligjit të mësipërm, pasi mos miratimi i tyre ka krijuar një ngërç në funksionimin e institucionit, në aspektin organizativ, e konkretisht:

1.Nga auditimi në Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT), në bazë të Programit të Auditimit nr.738/1prot, datë 07.08.2017, me objekt auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare në Universitetin Politeknik Tiranë dhe institucionet e varësisë”, konstatohet se, Universiteti Politeknik Tiranë është institucion publik i arsimit të lartë i llojit universitet dhe ka statusin e personit juridik publik. Ai përbëhet nga dhjetë njësi shpenzuese, nga të cilat tetë njësi kryesore (shtatë fakultete dhe një institut), një njësi administrative (Administrata e Rektoratit) dhe një njësi ndihmëse (Biblioteka Shkencore).

Nga ndarja e tij me Universitetin e Tiranës, me VKM Nr. 215, datë 15/07/1991 “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës” deri më sot, UPT është i organizuar dhe funksionon si një strukturë e centralizuar, me buxhet unik dhe një kod buxhetor.

Gjithashtu, me miratimi i ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, është konstatuar, mbivendosje kompetencash, për shkak të interpretimeve të ndryshme të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike midis Rektorit të Universitetit dhe Administratorit në drejtim të ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe veprimeve administrative. Kështu, për pasojë, mjaft praktika, administrative, financiare dhe realizimi i prokurimeve, në disa raste kanë rezultuar me probleme, si rezultat i mos zbatimit të nenit 141, e Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH”, **(miratimi e akteve nënligjore brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit)**. Nga auditimi konstatohet se:



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

a. Në ligjin e arsimit të lartë, neni 39 “Rektorin” përcaktohet se, **“Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare sipas përcaktimeve të këtij ligji.....”** dhe Administratori (neni 51) **“Administratori është autoriteti më i lartë administrative dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative sipas përcaktimeve të këtij ligji....”**

Edhe për organet e tjera kolegjiale Senati (neni 37 dhe 38), Bordi i Administrimit (neni 47, 48 dhe 49), funksionet nuk janë të përcaktuara plotësisht në mënyrë të detajuar, duke ja lënë akteve e brendshme rregullatore (Statuti dhe Rregullore e UPT, janë ende të pamiratuara), të cilat duhej të ishin miratuar brenda dy viteve të parë akademike, sipas nenin 129 të ligjit.

b. Në ligj përcaktohet se, “Institucionet e arsimit të lartë” janë persona juridikë që vetëfinancohen, financohen nga Buxheti i Shtetit ose nga burime të tjera të ligjshme dhe ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në interpretim të këtij paragrafi “Institucionet e arsimit të lartë” që shpenzojnë fonde publike duhet t’i nënshtrohen Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore, në zbatim të tij.

Në nenin 56 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, përcaktohet se **“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrit të prokurimit...”**

...Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. **Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.**

Pra, sipas ligjit specifik, që është ai arsimit të lartë, Administratori mund të jetë Titullari i njësive publike dhe njëkohësisht **Titullar i Autoritetit Kontraktor**, në kuptim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore, në zbatim të tij.

c. Sipas nenit 4/22, të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, “Titullar i njësive publike” është kreu i organit qendror të njësive publike. Në kuptim të këtij ligji, titullar i njësive publike, që drejtohen **me organe vendimmarrëse kolegjiale**, por që nuk organizohen si shoqëri tregtare, **konsiderohet ky organ.**

...Titullarët e njësive publike, përgjigjen **për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike**, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet **si dhe cakton nëpunësin autorizues dhe njofton nëpunësin e parë autorizues në Ministrinë e Financës.**

Titullari i njësive publike është përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit që përmban politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Ndërsa “Nëpunës autorizues” sipas Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, si dhe Ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit në njësinë publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tyre.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme dhe funksionet që ligji i arsimit të lartë i ka caktuar Bordit të Administrimit dhe Administratorit, titullar i njësisë publike duhet të jetë Bordi i Administrimit ndërsa “Nëpunës Autorizues”, Administratori i institucionit.

Por ky konkluzion, mbetet i paqartë për sa kohë, Bordi nuk është i vetmi organ kolegjal drejtues në njësinë publike (IAL), si dhe për sa kohë ne nenin 51, pika 1, të ligjit të arsimit të lartë përcaktohet se Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit.

d. Zbatimi efektiv i ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor është përfshirë në procesin e hartimit të një numri të gjerë aktesh nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij, që janë parashikuar të miratohen si vendime të Këshillit të Ministrave. Ministria e Arsimit ka përgjegjësinë e propozimit të akteve nënligjore për nenet e ligjit si më poshtë:

-Nuk janë hartuar dhe miratuar 10 VKM, dhe janë në proces të draftimi 6 VKM, (Bashkëlidhur lista në Aneks nr.1).

-Nuk janë hartuar dhe miratuar nga Ministri i Arsimit Sportit dhe Rinisë 13 Udhëzime dhe janë në proces draftimi 2 Udhëzime, (Bashkëlidhur lista në Aneks nr.1).

2.Nga auditimi rezultoi se, për Akreditimin e UPT, me urdhrin nr.1564,datë 28.12.2016 nënshkruar nga administratori është ngritur Grupi i Vetëvlerësimit individual (GVI) me 28 punonjës të cilët kanë funksione përdagogjike dhe për kryerjen e vetëvlerësimit individual me objekt vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, janë paguar sipas urdhër shpenzimeve nr. 1792, dhe 1793, datë 30.12.2016 në vlerën prej 1,507,886 lekë.

Urdhri nga Administratori është mbështetur në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i shfuqizuar, si dhe në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Arsimit Sportit dhe Rinisë, nr.29/1, datë 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”. Ky veprim financiar është realizuar në zbatim të ligjit të mëparshëm i cili aktualisht është shfuqizuar me daljen e ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH” datë 22.07.2015, fakt që tregon se kjo pagesë është mbështetur në një udhëzim të nxjerrë mbi bazën e një ligji të shfuqizuar.

B. REKOMANDIME PËR MASA ORGANIZATIVE



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

1. Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2013, 2014, 2015, 2016, dhe 2017 pranë ish strukturës organizative dhe strukturës faktike organizative të Rektoratit të UPT-së, funksionojnë 4 drejtori (Drejtorja e Kurikulave, Drejtorja e Kërkimit Shkencor, Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë), të cilat janë drejtuar nga personel akademik, me pagë sipas ligjit nr.9471, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në bazë të Vendimit Këshillit Administrativ, të UPT-së, nr.5, datë 17.07.2012, ku thuhet se, *“Personeli akademik efektiv dhe ai administrativ teknik i UPT që caktohet në veprimtari të tjera dytësore jashtë funksionit të tyre organik kanë të drejtën e përfitimit financiar në masën deri në dy paga mujore në vit, sipas përkatësive. Masa e pagesës përcaktohet me urdhër të veçantë të miratuar nga rektori i UPT-së dhe përballohet nga fondi i të ardhurave të kushtëzuara të Universitetit”*. Punësimi i personelit të brendshëm akademik, në funksione drejtuese administrative, jo vetëm që është në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e vecantë të personelit akademik”, por gjithashtu ka sjellë si pasojë kryerjen e kësaj detyre me kohë të pjesshme, si dhe funksionimin e drejtorive me mangësi në burime njerëzore. Në këto kushte, struktura organizative e Rektoratit të UPT-së ka qenë dhe vazhdon të jetë e paplotësuar.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se, për Akreditimin e UPT, sipas urdhrit nr.1564, datë 28.12.2016 nënshkruar nga administratori është ngritur Grupi i Vetëvlerësimit individual (GVI) me 28 punonjës të cilët kanë funksione akademike dhe për kryerjen e vetëvlerësimit individual me objekt vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, janë paguar sipas urdhër shpenzimeve nr. 1792, dhe 1793, datë 30.12.2016 në vlerën prej 1,507,886 lekë.

Grupi i audituesve, vlerëson dhe mendon se, mos funksionimi me kapacitet me kohë të plotë të Drejtuesve dhe personelit të Drejtorisë së Kurikulave, Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ka sjellë që ky grup pune i krijuar, deri diku ka bërë detyrat funksionale të drejtorive respektive. Kjo mangësi vjen dhe për faktin që nga ana e Senatit të UPT-së, ende nuk janë miratuar Draft Statuti dhe Draft Rregullore e funksionimit të Universitetit Politeknik i Tiranës.

Tashmë, jemi në kushte të funksionit të ligjit të ri Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH” dhe të VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e vecantë të personelit akademik” pika 16, ku citohet se, *“Personeli akademik, me kohë të plotë apo të pjesshme, nuk mund të ushtrojë asnjë funksion administrimi në institucionin e arsimit të lartë ku është punësuar, me përjashtim të zgjedhjes anëtar në Bordin e Administrimit”*, i cili i përjashton mundësinë e punësimit të personelit akademik si me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, pra nga drejtuesi i UPT-së (Rektori dhe Senati) duhet të përzgjidhen drejtues të drejtorive të mësipërme, të cilët duhet të mos jene pjesë akademike me kohë të plotë ose të pjesshme, pranë UPT-së, në mënyrë që të ushtrojnë detyrën administrative dhe akademike, në respekt të bazës ligjore.

Këshilli Administrativ dhe Rektori i UPT, mbajnë përgjegjësi për mosfunksionimin e drejtorive të mësipërme me kapacitet të plotë dhe në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe për kryerjen e shpenzimeve pa efektivitet të fondeve publike për total shumën 822,892 lekë (si pasojë e përfitimit të shpërblimit prej 2 paga mujore /vit, për të 4 pozicionet drejtuese).



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

2. Universiteti Politeknik i Tiranës, për periudhën prej daljes së ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë e në vijim, *nuk ka marrë asnjë masë për të përditësuar Statutin dhe rregulloret e funksionimit me ndryshimet ligjore që ka pësuar kuadri ligjor mbi arsimin e lartë, konkretisht ligji*”. UPT ka vijuar të funksionojë me Statutin e miratuar nga Senati në datën 25.06.2008, si dhe Rregulloren e Brendshme, miratuar me urdhrin nr. 60, datë 26.06.2015, të Rektorit të UPT. Për rrjedhojë, detyrat dhe të drejtat e personelit të institucioneve të arsimit të lartë nuk janë përcaktuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njëkohësisht edhe procedura e punësimit të personelit akademik pranë departamenteve të UPT është hartuar nga Rektorati në Tetor 2010, procedurë e cila nuk është rishikuar pas ndryshimeve që ka pësuar Ligji për Arsimin e Lartë. Kështu edhe kriteret për punësim për çdo kategori të personelit akademik dhe administrativ duhet të përcaktohen në përputhje me legjislacionin në statutin e institucionit dhe rregulloren e brendshme.

3. UPT për periudhën 05.05.2015, e në vijim, ka funksionuar me strukturën organike të miratuar në Këshillin Administrativ me vendimin nr. 2, datë 05.05.2015 “Për miratimin e strukturës dhe numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet”. Krijimi i drejtorive si Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike Drejtoria e Investimeve dhe Mirëmbajtjes nuk janë organizuar në përputhje me kërkesat e Vendimit nr.474, datë 16.6.2011, pika 21 ku citohet: “*Një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë të drejtuar nga një shef ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës*”. Për periudhën 05.05.2015 e në vijim, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ka në përbërje 2 punonjës (1 drejtor + 1 specialist), Drejtoria Juridike 3 punonjës (1 drejtor +1 përgjegjeës sektori + 1specialist), Drejtoria Ekonomike 4 punonjës (1 drejtor + 2 specialist+magazinjër), Drejtoria e investimeve dhe mirëmbajtjes 2 punonjës (1 drejtor + 1 përgjegjeës sektori). Sektori i Auditit të Brendshëm si njësi organizative e veçantë, ka në përbërje 1 punonjës, në pozicionin përgjegjësit të sektorit. Ky sektor ka funksionuar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.474, datë 16.6.2011, “Për përcaktimin e Standarteve të Procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”, pika 20 ku citohet: “*Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e vecantë kur në të jenë të paktën një pozicion shef sektori dhe dy vartës.....*”.

4. Struktura Organike e UPT, nuk ka të plotësuar dhe as tejkaluar numrin e miratuar të punonjësve si për Rektoratin ashtu dhe në total me njësitë e vartësisë. Për vitin 2014 numri i punonjësve efektivë të miratuar nga ish KAD është gjithsej 744 dhe në fakt janë të punësuar 599 ose më pak 145 punonjës akademikë. Konstatohet, edhe pse numri i punonjësve akademikë efektivë nuk është realizuar, numri i punonjësve akademikë me kontratë është 471. Po i njëjti fenomen konstatohet edhe për vitet në vijim. Për vitin 2015 numri i punonjësve akademikë me kontratë është 378, dhe vendet vakant në stafin akademik janë 136 punonjës, për vitin 2016 numri i punonjësve akademikë me kontratë është 378 dhe vendet vakant në stafin akademik janë 157 punonjës, për tetë mujorin e vitit 2017 numri i punonjësve akademikë me kontratë është 330 dhe vendet vakant në stafin akademik janë 158 punonjës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

5. Dosjet e materialeve mbi procedurat e punësimit të personelit akademik janë arkivuar, por duke mos përmbushur plotësisht kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe të manualit mbi arkivimin e dokumentave. Dosjet nuk janë administruar me indeks të veçantë, sipas kërkesave të Kapitullit V, Formatit Standard nr. 17, ku evidentohen shkresat e fashikujt në veçanti si dhe pasqyrimi kronologjik i numrit të fletëve në dosje.

6. Nga auditimi i kryer me objekt programimin dhe realizimin e të ardhurave kryesore që krijon Universiteti Politeknik Tiranë, konstatohet se, njësitë vartëse (fakultetet) paraqiten me mosrealizim të të ardhurave, kështu për vitin akademik 2016-2017 nga 14,039 studentë të regjistruar, 36 % e tyre ose 5,166 studentë nuk kanë paguar tarifën e regjistrimit, ose më pak për shumën prej 122,341 mijë lekë, duke sjellë si pasojë që të ardhurat nga 522,236 mijë lekë të realizohen 316,266 mijë lekë ose 62 %. Ky mosrealizim vjen si pasojë e studentëve ngelës të paregjistruar në vitin pasardhës, e cila përbën një burim potencial i konsiderueshëm të ardhurash.

7. Me miratimin e ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, konstatohet se, për herë të parë në historinë e IALP, ky ligj parashikon ekzistencën e dy titullarëve, Rektorin dhe Administratorin, të cilët ushtrojnë kompetencat e tyre në fusha të ndryshme dhe pa varësi administrative nga njeri tjetri.

Konkretisht, në nenin 39 e vijues, të ligjit në fjalë, përcaktohet qartë se **“Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare**(pritje përcjellje të delegacioneve, autoriteteve të larta shtetërore, ceremonitë zyrtare etj), sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Gjithashtu në nenin 5, të ligjit, përcaktohet qartë se **“Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëkuptimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij ligji”.**

Nga auditimi konstatohet se, pas marrjes së detyrës nga Rektori i UPT, dhe interpretimeve të gabuara të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike midis Rektorit të Universitetit dhe Administratorit në drejtim të ushtrimit të detyrave funksionale të Autoritetit Kontraktor, nga Rektori është pretenduar se i takon këtij të fundit (rektorit) vendimmarrja në lidhje mbi procedurat tenderuese, kjo mënyrë veprimi ka sjellë si pasojë mbivendosje kompetencash dhe anulimin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje orendi dhe pajisje zyre për nevojat të Njërive të Universitetit Politeknik të Tiranës” me fond limit 37,600 mijë lekë**. Kështu në datën 01.06.2016, pikërisht ditën e hapjes së tenderit, Rektori UPT, me shkresën nr.702, datë 01.06.2016 drejtuar APP-së, ka vendosur “Anullimin e procedurës së prokurimit të mësipërme, me argumentimin “për disa ndryshime në preventive”, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Nisur në këto kushte, nga operatorë ekonomikë ka pasur ankesa për sqarime pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e anulimit. Kjo situatë është krijuar për shkak se.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Anulimi i këtij tenderi, nga Rektori i UPT-së, ditën që do hapej procedura përbën tejkalim të kompetencave, veprim i cili është në kundërshtim me ligji n nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH”, ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” duke sjellë në këtë mënyrë të tejzgjatje të kësaj procedure deri në datën 09.09.2016, me 3 muaj vonesë.

Kjo situatë është zgjidhur, në bazë të interpretimeve shkresore, të kërkuara nga Administratori të UPT-së, me, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Financës, dhe me Vendimin e KPP-së, nr.530/3/2016, nëpërmjet të cilave Rektori i UPT-së, ka njohur pozicionin e vet.

8. Nga auditimi me objekt “Ndërtimi i shtesës së Korpusit Kryesor të Universitetit Politeknik të Tiranës”, rezultoi se :

- Nga ana e Institutit të Monumenteve të Kulturës, me shkresë, nr. 1472 prot. datë 22.09.2014, Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit , i janë drejtuar Universitetit Politeknik Tiranë, është kërkuar hartimi dhe miratimi i projektit të shtesës së Korpusit Kryesor në Këshillin Kombëtar të Restaurimit, me qëllim unifikimin e veshjes së jashtme duke u referuar materialeve të fasadës së korpusit qendror të UPT, i shpallur Monument Kulture i kategorisë së dytë me urdhër nr. 122 prot. datë 05.03.2007, në bazë të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, ku në thelb është kërkuar dhe ndryshimi i fasadës së shtesës së UPT-së, duke mos e bërë eficiente projektin e mëparshëm që fondet publike të përdoren me ekonomikitet,

-Me vendimin e Ministrisë së Kulturës nr. 128, datë 11.12.2014, është miratuar projekti “Rehabilitimi dhe trajtimi i fasadave të dy shtesave anësore dhe objektit fundor të UPT-së”, ku në bazë të relacionit të mbikëqyrësit të punimeve nr. 147 prot. datë 16.04.2015, është shpjeguar se, ndryshimi i projektit të fasadës, ku janë llogaritur volumet e punës, duke hartuar preventivin e rishikuar të fasadës.

-Nga auditimi, zërat e pandryshuar të cilat ishin në preventivin fillestar, ruajtën të njëjtin çmim njësi, ndërsa zërat e rinj u vendosën me negociim. Në procesverbalin e datës 20.04.2015, midis palëve, është negociuar për çmimet e reja, ku zëri “Veshje fasade me pllaka mermer traventinë 100 cm x 50 cm, trashësi 3 cm, me ngjyrë dhe teksturë si monumentet e kulturës në sheshin “Nën Tereza”, e venteluar, me strukturë mbajtëse metalike të galvanizuar, me ankorim vida inoksi, me kapëse çeliku inoksi”, u propozua me 8,800 lekë/m² dhe pas negociimit u ul me 240 lekë/m², ku u miratua çmimi 8,560 lekë, ku sasia përfundimtare rezultoi 2,858.75 m², me vlerë 24,470,900 lekë pa TVSH. Ndërkohë me projekt-preventivin fillestar zëri nr. 30 “Veshje me fasadë me pllaka traventinë trashësi 3 cm, e venteluar, me strukturë mbajtëse metalike e galvanizuar, me ankorim vida inoxi, me kapëse çelik inox”, ka qenë e parashikuar në sasinë prej 451 m², me çmim të ofertuar 1,800 lekë/m². Në thelb zëri i veshjes me traventinë është në kuptimin e njëjtë të procesit të punës, por me ndryshimin e fasadës dhe përmasave të saj ka ndryshuar edhe çmimi.

Përsa më sipër, ndryshimi i fasadës u shoqërua edhe me ndryshim preventivi shtesë i kontratës me vlerë prej 54,401,280 lekë me TVSH, me financim buxheti i shtetit. Ky ndryshim vjen si rrjedhojë e mos koordinimit të Institucioneve të nivelit qendror me UPT-në, duke sjellë si pasojë



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

rritjen e vlerës së kontratës dhe kostos së objektit, si dhe përdorim jo efektiv i fondeve publike të akorduara shpesh nga buxheti i shtetit, për shkak të ndryshimit të projektit fillestar.

- Kontrata për punë publike nr. 16/42 prot. datë 28.02.2013, e lidhur midis Autoritetit Kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "X&Y", sipas nenin 40.2 të kontratës, Garancia e punimeve prej 5 % të vlerës së kontratës e cila është përcaktuar 12 muaj pas përfundimit të punimeve nga operatori ekonomik. Nga auditimi rezultoi se, në garanci janë futur zëri i punimeve dhe zëri i mallrave të inkorporuar në objekt gjatë punimeve. Kështu, duke u nisur nga natyra komplekse, e këtij investimi, duhej që nga AK të kishte përcaktuar qysh në fillim në DT, afatin prej 24 muaj garanci punimesh, pasi grupi i audituesve ka konstatuar, që në zonën e parkimeve ka lagështi, e cila detyrimisht do të kërkojë mirëmbajtje nga AK (për mos dëmtim objekti). Po kështu edhe pajisjet si, ashensorë, sistemit kundra zjarrit etj, u konstatuan mosfunksionime normale të tyre, duke kërkuar shërbime dhe mirëmbajtje të ndryshme. Për sa më sipër, përcaktimi i një garancie kohore me të gjatë nga sa është parashikuar, mirëmbajtja dhe difektet e ndryshme do të bëheshin nga operatori ekonomik fitues dhe jo nga Autoriteti Kontraktor sikurse ndodh në fakt.

-Kontrata është likuiduar me 26 situacione pjesore progresive dhe 4 situacione pjesore progresive të shtesës së kontratës, të cilat nuk janë shoqëruar me librezë masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, pika 8.1 ku citohet se, “*situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori*”. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës. Në disa zëra të punimeve elektrike, ngrohje etj, tabela e lëvizjes së volumeve nuk pasqyron të detajuar sasinë e realizuar në fakt.

9. Nga auditimi në tenderin me objekt " *Blerje dhe instalim i sistemit të kamerave për sigurinë e objekteve të UPT* ", përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, nga grupi i studimit të tregut, *nuk rezulton të jetë vendosur ndonjë referencë* mbi cilësinë, parametrat kryesorë të kamerave, në mënyrë që të përcaktohej saktë vlera e përlllogaritur e kontratës për sistemin eurvejimit, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VII, neni 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”.

Gjithashtu, në DT, nga grupi për hartimin e specifikimeve teknike dhe termave të referencës, janë vendosur indirekt parametra cilësie vetëm të një produkti nga një prodhues i vetëm, ku operatorët ekonomik janë orientuar drejt një prodhuesi të paracaktuar, pasi është vendosur autorizim prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, duke favorizuar operatorë të cilët gëzojnë autorizim e prodhuesit, e për pasojë kemi ulje të konkurrencës në mënyrë të ndjeshme.

10. Nga auditimi i procedurave me objekt “*Shërbimi i informatizimit të aktivitetit dhe dokumentacionit të sekretarive mësimore*”, për vitet, 2014, 2015, 2016” rezultoi se, ky shërbim është përftuar për nevojat e UPT-së, nga njëjt operator ekonomik “B.-A...” shpk. Nga auditimi konstatohet se në rastin konkret ndonëse është i njëjt shërbim, vlera e këtij shërbimi është rritur pa asnjë argument nga viti në vit, e konkretisht për vitin 2014, operatori ekonomik është



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

likuiduar për vlerën prej 1,600,000 lekë pa TVSH , për vitin 2015 ku shërbim është kryer me vlerën prej 1.855,000 lekë pa TVSH dhe për vitin 2016 vlera e tij është rritur në shumën prej 1,918,800 lekë pa TVSH, pra në total ku shërbim ka kushtuar 5,373,000 lekë pa TVSH. Nëpërmjet këtij shërbimi, është realizuar përmbushja e qëllimit mbi mundësimin e funksionimit informatik në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, emetimin e dokumenteve zyrtare të provimeve si dhe ofrimi i shërbimeve më cilësore ndaj studentëve dhe pedagogëve në funksion të procesit mësimor.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se, ky program dhe ky shërbim nuk do të jetë funksional, pasi UPT, po implementon dhe do vërë në funksion infrastruktura hardëare për instalimin lokal të sistemit UGOV, kjo në kuadër të projektit të ndërtimit të rrjetit telematik për Universitet Shtetërorë Publike, sipas ligjit nr.9704, datë 02.04.2007 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një Qendre Shërbimesh dhe të një Rrjeti Telematik për Universitetet”

Pra si konkluzion, nga ana e AK të Universitetit Politeknik të Tiranës, për tre vitet e mësipërme, nga të ardhurat dytësore, u sigurua shërbimi i informatizimit të “SEKRETARIA”, i cili tashmë, nuk do të funksionojë, si pasojë e mungesës së hartimit të projekteve afatgjata dhe koordinimit të veprimeve të UPT-së me Ministrinë e Arsimit dhe më gjerë, duke sjellë përdorim të fondeve publike, pa eficiencë, pa efektivitet dhe pa ekonomikitet, të cilat në total llogariten në vlerën prej 5,373,000 lekë pa TVSH.

11. Nga auditimi i të gjitha procedurave të prokurimit për mallra, shërbime dhe rikonstruksione, për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017, të përzgjedhura nga grupi i KLSH-së konstatohet se, në Universitetin Politeknik të Tiranës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, sektori i prokurimeve (sipas organigramës organizative) është caktuar si Njësi e Prokurimit, por e pa shoqëruar me Urdhrin përkatës, nga Titullari i AK. Gjithashtu në disa raste anëtarët e komisioneve të posaçme (kur kjo detyrë i është ngarkuar një strukture tjetër), janë burime njerëzore të pa trajnuara pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike (APP), për pasojë u evidentuan mangësi të elementeve të procedurave prokuruese, si në përlllogaritjen e fondit limit, në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, të cilat duhet t’i paraqesin në mënyrë të hollësishme dhe argumentuar për çdo kriter të vendosur prej tyre duke i pasqyruar në dokumentat e tenderit.

12. Nga auditimi, rezultoi se, në procedurat “*Kërkesë për propozim*” të realizuara gjatë vitit 2014, me objekt “*Blerje dokumentacioni specifik*”; “*Blerje orendi dhe pajisje zyre*”; “*Shërbim për mirëmbajtjen e ndërtesave*”, nga ana e Njësisë së Prokurimit, për hartimin e fondit limit është mbështetur në oferta të sjella nga operatorë ekonomikë, të cilët nuk kanë paraqitur NIPT-in, e për pasojë fondi limit konsiderohet “fiktiv”. Ftesa për ofertë u është dërguar 5 operatorëve ekonomikë dhe jo nga një listë e përditësuar, si dhe pa argumentuar arsyen e përzgjedhjes së tyre, në një proces verbal të veçantë, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu VI, germa “b” dhe “c”.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Ndërsa për vitet 2015, 2016 dhe 2017, kjo e mangësi nuk është konstatuar, pasi AK ka zbatuar përputhshmërinë ligjore të realizimit të procedurave tenderuese të financura nga fondi i UPT-së.

13. Nga auditimi rezultoi se, raporti përmbledhës i hartuar nga Komisionet e Vlerësimit të Ofertave dhe i miratuar nga titullari i Autoriteti Kontraktor i UPT-së, nuk përmban në mënyrë të detajuar; referencën e procedurës, përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve, çmime/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës, ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit, ofertuesin e renditur të parin, informacionin nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrja në lidhje me to, në kundërshtim me ligjin nr 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, (VKM nr. 1, datë 10/01/2017, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”) dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 68.

14. Nga auditimi rezultoi se, të gjitha dosjet e procedurave prokuruese që na u vunë në dispozicion, ishin të pa inventarizuara në kundërshtim me ligjin “Për arkivat”. Plotësimi dhe administrimi i dosjeve nuk paraqitet në nivelin e kërkuar, pasi nuk janë arkivuar, nuk janë nënshkruar si nga marrësi në dorëzim ashtu dhe nga dorëzuesi. Dosjet e procedurave prokuruese nuk janë plotësuar sipas ligjit për arkivat, ka mungesë të dokumentacioneve shoqëruese, kryesisht mungon në dosje përlllogaritja e fondeve limit, apo dokumente të tjera, në kundërshtim me Ligjin “Për Prokurimin Publik”, Kreu II, neni 12, pika 3.

Për pikat 11,12,13, dhe 14 rekomandoj:

-Në fillim të çdo viti të veprimtarisë ushtrimore të ngrihet Njësia e Prokurimit e miratuar me Urdhër nga Titullari i AK .

-Të shmanget fiktiviteti në studimin e tregut për prokurimet për blerje mallra, duke marrë oferta nga ato subjekte të regjistruara në QKL që kanë si aktivitet kryesor mallin, punën apo shërbimin që do prokurohet.

-Në dokumentet e tenderit të hartohen dhe paraqiten në mënyrë të hollësishme duke e argumentuar për çdo kriter të veçantë.

- Anëtarët, në grupet e punës për llogaritjen e vlerës së kontratës dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përzgjidhen nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, në cilësinë e specialistëve të fushës së prokurimit ose të aplikohet marrja e ekspertëve të jashtëm, në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve, të vendosen specialistë të fushës përkatëse, dhe të trajnohen anëtarët e saj, pranë Agjencisë së Prokurimeve, me qëllim që të rritet efica e përdorimit të burimeve dhe fondeve publike në dispozicion.

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit të përgatitë raportin përmbledhës, ku një vend të veçantë duhet për ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit, informacionin nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrja në lidhje me to.

Vazhdimisht

15. Nga auditimi rezultoi se, në bazë të kërkesave për mallra, shërbime ose punë, të paraqitura nga administrata e Rektoratit (AK) për vitet buxhetore, 2014, 2015, 2016 dhe 2017, është përgatitur regjistri i parashikimeve, brenda datës 15 janar të çdo viti, por nga ana e KAD (Këshillit Administrues Drejtues), tashmë i emërtuar Bordi i Administrimit (BA) krijuar në bazë



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, detajimi i fondeve është miratuar me vonesë dhe janë dërguar jashtë afateve në Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencisë së Prokurimeve Publike. respektivisht:

Për vitin 2014, sipas vendimit të KAD nr. 2, datë 08/04/2014 për “Miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2013 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2014”;

Për vitin 2015, sipas vendimit të KAD nr. 3, datë 05/05/2015 për “Miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2014 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2015”;

Për vitin 2016, sipas vendimit të KAD nr. 2, datë 11/02/2016 për “Miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2015 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2016”;

Për vitin 2017, sipas vendimit të BA nr. Nr. 23, datë 04/05/2017 “Miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2016 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2017”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, (VKM nr. 1, datë 10/01/2017, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”) dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 4 dhe Udhëzimit të APP nr. 2, dt 27.01.2015.

16. Nga auditimi rezultoi se, në administratën e Rektoratit të UPT-së, ende nuk është plotësuar njësia e auditimit të brendshëm, rekomandim i lënë në auditimin e mëparshëm të KLSH-së, sipas Raportit Përfundimtar me shkresë nr.850/7 prot datë 05.05.2014.

Në strukturën organike aktuale (e cila ende nuk është e miratuar dhe vazhdon të jetë në një proces të tejzgjatur për pozicionimin e saj), ekziston “struktura” me 1 përgjegjes sektori dhe 1 specialist (vakand), ku vetëm përgjegjësi i sektorit është i punësuar, kjo në kundërshtim me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.

Nga ana e titullarëve të UPT-së (ish Rektori dhe Rektori aktual), nuk është përmbushur detyrimi ligjor dhe administrativ, për plotësimin e vendeve vakande në sektorin e auditit. Kjo strukturë organizative nuk plotëson kërkesat e minimumit ligjor, 1 drejtues dhe 2 specialistë, gjendje e cila vazhdon edhe me momentin e miratimit të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”.

Kështu, nga ana e Rektorit UPT, në cilësinë e Kryetarit të Senatit, organ i cili sipas ligjit miraton paraprakisht ndryshimet në strukturën e institucionit, nëpërmjet mosveprimit ka refuzuar të paraqesë për shqyrtim në senat, propozimin e njësive të auditit të brendshëm dhe Administratorit, sipas shkresës nr.1090 prot datë 21.09.2016, për plotësimin e kësaj njësie në përputhje me kërkesat dhe aktet nënligjore në fuqi. Ky veprim është bërë në kundërshtim me ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, neni 38 pika 1/ç.

Gjithashtu, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, vendim marrja për plotësimi e strukturës së auditimit është në koordinim midis Rektorit dhe strukturës kolegjiale (Bordi i Administrimit).



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Kështu, nga Bordi i Administrimit, me shkresë nr.7 prot datë 08.02.2017, ka vlerësuar se është e domosdoshme që veprimtaria e njësisë së auditimit të brendshëm, të pezullohet deri në shqyrtimin dhe marrjen e një vendimi për veprimtarinë e sektorit në fjalë, kjo në kundërshtim të detyrave dhe përgjegjësi të tij ligjore, e për rrjedhojë që nga muaji shkurt të vitit 2017 e në vazhdim, pranë UPT-së, ndonëse me një strukturë të paplotë nuk realizohet qëllimi i misionit të auditimit, gjë që e ngarkon me përgjegjësi Bordin e Administrimit.

Edhe pse *Njësia e auditit të Brendshëm, për vitin 2015, 2016 dhe 2017*, ka vijuar punën ndonëse me strukturë të paplotësuar, nga auditimi u konstatua se, kjo punë audituese nuk e justifikon qëllimin dhe misionin që duhet të këtë struktura audituese e brendshme e njësisë publike, duke rezultuar në raporte auditimi jocilësore. Auditimi i Brendshëm është një prej dy shtyllave themelore të Kontrollit të Brendshëm i cili duhet të shërbejë si filtër kontrolli brenda institucionit.

17.Nga auditimi, në lidhje me objektin “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ligjore për rikthimin në detyrë të z.I.H*”, rezultoi se, z. H mban titullin “Profesor”, i cili ka qënë në marrëdhënie pune pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, deri në datën 06.09.2009, me detyrë punonjës kërkimor –shkencor (personel akademik) në departamentin e teknologjisë të Gjeoinformacionit, pranë ish Institutit të Gjeoshkencave. Më pas në periudhën nga data 07.09.2009 deri në datën 08.09.2013, z.Hoxha ka ushtruar funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë, referuar vertetimit nr.24 prot, datë 24.11.2014 të Kuvendit të Shqipërisë.

Me mbarimin e mandatit të deputetit, z.Hoxha i është drejtuar UPT-së me kërkesë nr.1106 prot, datë 24.09.2013, duke kërkuar rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, si pedagog dhe jo si punonjës kërkimor–shkencor (personel akademik) në departamentin e teknologjisë të Gjeoinformacionit, pranë ish Institutit të Gjeoshkencave, gjë që e cila nuk u mundësua, për shkak se nga Universiteti Politeknik i Tiranës, i ka kthyer përgjigje, z. H duke refuzuar kërkesën për kthimin në detyrën e mëparshme, për shkak se, pika 7 e nenit 50 të ligjit “Për arsimin e lartë” e cila parashikon këtë të drejtë, ka hyrë në fuqi me ndryshimet e bëra me ligjin nr.10307, datë 22.07.2010, pra pas largimit nga detyra, e po ashtu nuk rezulton që midis palëve të ketë ndonjë marrëveshje të shkruar për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës në përfundim të detyres së funksionarit public, pasi nga ana e Departamentit, për të plotësuar nevojat e veprimtarisë mësimore në këtë departament, është punësuar sipas procedurave përkatëse personel akademik me kohë të plotë.

Z.H, ka kërkuar pranë dy shkallëve të Gjykatës Administrative Tiranë, të drejtën për kthimin në vendin e punës si pedagog i përhershëm, por në të dyja vendimet e Gjykatës Administrative , është marrë vendimi për kthimin si punonjës shkencor akademik dhe jo si pedagog. Gjithsesi, theksojmë që është gabim i rrëndë që nuk është vepruar menjëherë pas përfundimit të procesit gjyqësor për rikthimin e tij në punë. Me zgjedhjen e Rektorit i UPT-sw, me Vendimin nr.50 datë 28.07.2016, është vepruar drejt që Prof.Dr. IH është rikthyer në detyrën e mëparshme si personel akademik me kohë të plotë në Institutin e Gjeoshkencave Energjisë Ujit dhe Mjedisit, duke filluar marrëdhënie financiare në të njëjtën datë me vendimin e mësipërm



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

18. Sipas nenit 5 ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në zbatim të këtij neni “Bordi i Administrimit të UPT cakton në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe përcakton pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit”.

Për sa më lart, ndonëse ligji i jep autonomi, por kjo pavarësi është e kushtëzuar nga të ardhurat financiare, pasi për realizimin e misionit të tij, UPT financohet nga buxheti i shtetit me rreth 75 % të fondeve dhe në këto kushte nuk mund të caktojë vetë pagat pa u mbështetur në dispozita të tjera nënligjore që duhet të rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni që deri sot nuk kanë dalë e për rrjedhojë është krijuar vakum ligjor në interpretimin dhe funksionimin e autonomisë së UPT. Mungesa e dispozitave të tjera ligjore në përcaktimin e formës së institucionit, nuk lejon që Bordi i Administrimit të ushtrojë këtë funksion.

Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht nga ky kusht, Bordi i Administrimit me vendimin nr. 18, date 03.02.2017 ka miratuar dhe rritur masën e shpërblimit për veten e vet me shumë se 2 herë, duke përfutur padrejtësisht shumën prej **280,281 lekë**. Miratimi i tarifave të shpërblimit të anëtarëve të Bordi i Administrimit, është jo vetëm në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.02.2012, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësisë të qeverisjes qendrore” lidhja nr. 1, por përben edhe konflikti interesi, pasi në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar është përcaktuar: “Interesat privatë të zyrtarit janë ato interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga, të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre”.

19. Në muajin qershor 2016 është likuiduar Agjencia e Akreditimit, në shumën prej 1,965,000 lekë me objekt “Vlerësimin e akreditimit të Universitetit Politeknik Tiranë”. Dokumenti justifikues i paraqitur për kryerjen e pagesës me emërtimin “Faturë arkëtimi”, është një fletë formati A4, jo sipas modelit të miratuar me ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 101 “Përmbajtja e faturës”, pasi nuk ka të dhëna për: numrin serial që e identifikon faturën, nuk ka numrin e identifikimit të TVSH-së të personit të tatueshëm që kryen furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, sipas përcaktimit të nenit 92, të këtij ligji.

Kjo pagesë është bazuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave nr. 29/1, datë 16.08.2016 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”. Ky udhëzim mbështetet në nenin 62, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, **aktualisht i shfuqizuar**. Kjo pagesë nuk ka mbështetje ligjore dhe është e pajustificuar pasi, Akreditimi i UPT është bërë në kohën hyrjes në fuqi të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në nenin 5, të këtij ligji, “Roli i shtetit në arsimin e lartë”, pika 2, germa “b” përcaktohet se: “Shteti, nëpërmjet organeve dhe strukturave përgjegjëse të tij, është përgjegjës për monitorimin e standardeve në arsimin e lartë për hapjen dhe akreditimin e institucioneve e të programeve të studimit që ato ofrojnë”.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Krahas pagesës së mësipërme për akreditimin e UPT, është ngritur Grupi i Vetëvlerësimit individual (GVI) me objekt “Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies”. Për punën e kryer ky grup është paguar në shumën prej **1,507,886 lekë**, pagesë e cila është e pajustificuar dhe e paargumentuar pasi vetëvlerësimi duhet të kruhej nga “Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” e cila ka për objekt kryerjen e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, si një kusht për Akreditimin e UPT-së.

20. Nga auditimi, në lidhje mbi vlerësimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën tenderuese me objekt “*Blerje dhe instalim i sistemit të kamerave për sigurinë e objekteve të UPT, viti 2016.*”, është s'kualifikuar operatori ekonomik "F", për shkak të specifikimeve teknike dhe termave të referencave, të cilat rezultuan se i plotësonte vetëm një prodhues në treg, pasi specifikimet teknike të kamerës të markës "D", të paraqitur prej tij nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në DST markës "H".

Autoriteti kontraktor nuk duhej të kishte përcaktuar terma të referencave të produkteve të markës "H" dhe të vendoste parametra normal cilësie, duke vendosur kriteret që të nxisin konkurrencën dhe duke zgjeruar tregun e produkteve, atëherë OE "F" sh.p.k (me kamerat e markës “D”), do të ishte shpallur fitues me vlerë më të ulët, në të cilën asnjë kamerë apo produkt, nuk mund të plotësojë plotësisht 100 % specifikimet teknike të DST (përveç markës “Hikvizion”) dhe diferenca midis 2 ofertave të kamerave të markave të ndryshme në vlerën **1,707,332 lekë me TVSH**, përbën menaxhim pa efektivitet dhe efikasitet të fondeve të UPT.

21. Nga auditimi i shpenzimeve operative konstatohet se, në tre raste janë kryer shpenzime pa efektivitet, në shumën prej **1,103,741 lekë**, e konkretisht:

a. Me urdhër shpenzimin nr. 741, datë 31.05.2016 është likuiduar shoqëria private “E” në shumën 185,741 lekë, sipas shkresës së ish Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 5232/1, datë 20.05.2016 nënshkruar nga sekretari i përgjithshëm i MASH me objekt: “*Organizimin e panairit pranë City Park për njohjen e kriterëve të pranimit të maturanëve në vitin akademik 2016-2017*”.

Shkresa e mësipërme është dërguar për zbatim nga 14 Universitetet Shtetërore, për të lidhur kontratën me subjektin “EXPO City” me objekt “*Organizimin e panairit pranë City Park për njohjen e kriterëve të pranimit të maturanëve në vitin akademik 2016-2017*”.

Pagesa e kryer me tarifën 70 Euro/m² për standin e vendosur nga UPT në “E”, është kryer pa procedurë prokurimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në kundërshtim me ligjin “Për prokurimin publik”, pagesë e cila përbën përdorim pa efektivitet të fondeve publike, pasi për kryerjen e këtij aktiviteti, ish Ministria e Arsimit duhej të përdorte ambientet e çdo Universiteti, si dhe publikimin e kriterëve në faqen zyrtare të MASH dhe të 14 Universiteteve të vendit, apo mënyra të tjera komunikimi me medien e shkruar dhe elektronike.

b. Në muajin Gusht 2015 dhe 2016 janë kryer shpenzime në shumën prej 918,000 lekë, për shërbimin e kryer nga shoqëria “Pass-Programi Alternativa sociale Stimulue” për akomodim,



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

trajtim ushqimor dhe shpenzime transporti në Jalë, për këshillat studentorë të UPT, me objekt “Njohjen dhe zbatimin e neneve të rregullores së këshillave të fakulteteve”.

Kjo kategori shpenzimi konsiderohet pa efektivitet dhe e paargumentuar, pasi njohja e rregulloreve të këshillave studentore do të ishte më efektive të bëhej gjatë vitit shkollor në ambientet e universiteteve. Gjithashtu zhvillimi i këtyre aktiviteteve në muajin Gusht në JALË, që “përkon” me zhvillimin e aktiviteteve rinore të disa partive politike nxit joshjen e studentëve në politikë, ndërkohë që ata duhet të kenë objektiv përgatitjen cilësore. Këto veprimtari janë në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 80/2015, pika 3 ku përcaktohet se: *“Institucionet e arsimit të lartë ruajnë neutralitet politik”*.

22. Nga auditimi në njësitë vartëse pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, konstatohet se, me vendimin e Senatit dhe Bordit të Administrimit nr. 5, datë 01.11.20116 është vendosur “Hapja e degës së Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU) në qytetin e Korçës, për zhvillimin e masterit profesional me objekt: “Restaurimin e monumenteve të kulturës”, në të cilin janë miratuar edhe efektet financiare të hapjes së kësaj dege.

Sipas programit financiar, shpenzimet për hapjen e kësaj dege do përballohen nga tarifat e regjistrimit dhe të shkollimit për 50 studentë, në shumën totale prej 5,125,000 lekë. Në fakt janë regjistruar 37 studentë nga të cilat janë realizuar të ardhura në shumën prej 3,792,500 lekë, ndërsa shpenzimet në përfundimin të vitit akademik janë parashikuar në shumën 12,307,000 lekë.

Nga të ardhurat e realizuara mbulohen vetëm 30 % e shpenzimeve, fakt që tregon se do ishte më efektive që hapja e kësaj dege të bëhej pranë Fakultetit të Arkitekturës në mbështetje të nenit 1, të ligjit 80/2015 pika c, me qëllim “Ofrimin e mundësive të barabarta për të përfutur nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës”.

Duhet theksuar se, hapja e kësaj dege në Korçë nuk gjen mbështetje në nenin 29, të ligjit nr. 80/2015, pika 3, ku përcaktohet se: *“Kriteret dhe procedurat për hapjen e degëve të institucioneve të arsimit të lartë, vendase dhe të huaja, të akredituara në vendin e origjinës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”*.

Kronologjia e hartimit dhe miratimit të dokumentacionit nga ish Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe vendimi i Senatit dhe Bordit të Administrimit, nuk rezultojnë të jenë në koherencë me dispozitat ligjore pasi:

Këshilli i Akreditimit me vendimin 145, datë 31.03.2016 “Për hapjen e programit të ciklit të dytë master profesional në “Restaurim Monumentesh Kulturore” të Universitetit politeknik të Tiranës, është bazuar në ligjin nr.9741, datë 21.03.2016. Fakt që tregon se, vendimi i Senatit dhe Bordit të Administrimit është marrë në një kohë që ligji për Arsimin e Lartë është shfuqizuar nga dalja e ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015. Ministri me urdhrin nr. 191, datë 22.04.2016 autorizon hapjen e kësaj dege pasi programi mësimor t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, ndërkohë që sipas dokumentacionit që administrohet, procesi i akreditimit ka përfunduar rreth 1 muaj para daljes së urdhrin të ministrit (31.03.2016). Këshillit të Akreditimit ka vendosur që forma e studimit në këtë degë të jetë më kohe të plotë, pra mësimi do të zhvillohet në ditët zyrtare të punës, dhe stafi pedagogjik do të sigurohet nga Fakulteti i Arkitekturës Tiranë. Nga verifikimi i kryer konstatohet se mësimi nuk është zhvilluar gjatë ditëve zyrtare të punës, pasi nga auditimi i shpenzimeve rezultuan pagesa të “shpenzimeve



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

udhëtim e dieta” pjesore në shumën prej 102,500 lekë gjatë ditëve të shtuna dhe të diela deri në datën 31.05.2017 (pa llogaritur shpenzimet e kësaj natyre deri në fund të programit mësimor). Pagesa e shpenzimeve udhëtim e dieta për ditët e shtuna dhe të diela është në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 20.04.2016 “Për disa ndryshime në VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës Brenda vendit”, Kreu I, ku përcaktohet se, punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme të cilët trajtohen financiarisht për shërbim jashtë qendrës së banimit vetëm gjatë ditëve zyrtare të punës.

Për këtë rekomandoj:

Nga ana e titullarit Akademik (Rektorit) dhe titullarit të Autoritetit Kontraktor (Administratorit), të vazhdohet, koordinimi dhe bashkëpunimi, pa mbivendosje kompetencash, në respekt të frymës së mirëkuotimit dhe të zbatimit të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm ushtruar nga KLSH.

Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve, të auditimit të mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 850/7, datë 05.05.2014 rezulton se:

- UPT, i ka kthyer përgjigje KLSH, me shkresën nr. 551/1, datë 23.05.2014, brenda afatit ligjor (20 ditë).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve, rezulton si më poshtë:

a. Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore është lënë 1 rekomandim, i cili është pranuar dhe është zbatuar nga subjekti.

b. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 17 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 16 rekomandime, nuk është pranuar nga subjekti 1 rekomandim. Nga të pranuarat 13 janë zbatuar plotësisht, 2 të pazbatuara dhe në proces zbatimi 1 rekomandim.

c. Për zhvendësimin e dëmeve ekonomike të shkaktuara, është lënë 1 rekomandim, i cili është pranuar plotësisht. Ky rekomandim nuk është zbatuar plotësisht, pasi është kërkuar shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 2,030,854 lekë, ku deri më datë 15 Tetor 2017 rezulton e arkëtuar shuma 686.066 lekë, pra ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

d. Nuk janë rekomanduar masa disiplinore.

2. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

- Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të hartimit të buxhetit. Zbatimi i kriterëve në çeljen e detajimit të planit fillestar, zbatimin e buxhetit gjatë vitit, nivelet e realizimit të planit përfundimtar, raportimi në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, etj.

- Mbi zbatimin e kriterëve për hartimin dhe zbatimin e buxhetit me destinacion fondet e investimeve për periudhën objekt auditimi.

- Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore nga institucionet vartëse dhe përgatitjen e përmbledhësës së pasqyrave financiare nga Universiteti dhe raportimi në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Universiteti Politeknik i Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë me status të personit juridik publik. Ai përbëhet nga dhjetë njësi shpenzuese, nga të cilat tetë njësi kryesore (shtatë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

fakultete dhe nje institut), një njësi administrative (Administrata e Rektoratit) dhe një njësi ndihmëse (Biblioteka Shkencore).

Që nga ndarja e tij me Universitetin e Tiranës, me VKM Nr. 215, date 15/07/1991 “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës” deri më sot, UPT është i organizuar dhe funksionon si një strukturë e centralizuar, procedurat e prokurimit për mallra, punë dhe shërbime edhe për njësitë vartëse realizohen në mënyrë të përqëndruar nga Administrata e Rektoratit, me të njëjtin kod buxhetor.

Programimi afat mesëm i buxhetit të Universitetit Politeknik të Tiranës është i lidhur me programimin buxhetor të të gjitha njësive vartëse të tij e cila përbëhet nga strukturat varësisë si: Biblioteka Shkencore, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti i Inxhinierisë Matematikës dhe Fizikës, Fakulteti Gjeologji Miniera, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Instituti i Gjeoshkences dhe Ujit dhe Mjedisit.

Për vitin 2016, në programin buxhetor të këtij viti është shtuar edhe hapja e Degës së Fakultetit të Arkitekturës dhe urbanistikës në qytetin e Korçës për zhvillimin e masterit Profesional në “Restaurimin e Monumenteve të Kulturës, shpenzimet e të cilës do mbulohen nga të ardhurat dytësore të realizuara nga tarifa e regjistrimit të studentëve pjesëmarrës.

Të gjitha strukturat e varësisë funksionojnë si njësi shpenzuese, veprimet financiare që ato kryejnë, nuk i bëjnë direkt me thesarin por nëpërmjet Administratës së Rektoratit dhe programit 011040.

Mbështetur në ligjin nr.9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 80/2015 dhe ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në Buxhetin e UPT-së (UPT) përfshihen këto komponentë kryesore:

- Transferta e pakushtëzuar (për funksionim)
- Të ardhurat e kushtëzuara të institucionit (për funksionim dhe investime)
- Fonde nga grandit i investimeve (me konkurrim projektsh)
- Fonde nga grandit për kërkim shkencor (me konkurrim projektsh)
- Burime të tjera të ligjshme (sponsorizime; donacione etj). Këto burime financiare, janë objekt i detajimit nëpërmjet organeve kolegjiale, Rektorat, Senat dhe Këshilli i Administrimit, për njësitë shpenzuese.

Nga auditimi konstatohet se programimi i shpenzimeve për vitin 2014 dhe 2015 është bërë konform ligjit 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa për vitin 2016 dhe 2017 “Programimi buxhetor dhe i shpenzimeve është bërë duke u bazuar në ligjin nr. 80/2015.

Ndryshe nga ligji i mëparshëm UPT financohet nga MAS me fonde buxhetore të pakushtëzuara, të cilat sipas kriterëve të këtij ligji janë në dispozicion të UPT për t’i detajuar dhe miratuar nga Bordi i Administrimit. Në fakt fondet e celura nga Ministria e Arsimit, UPT i ka detajuar dhe përdorur për të mbuluar shpenzimet për fond page, sigurime shoqërore të cilat mbulojnë rreth 75 % të këtyre zërave dhe pjesa tjetër rreth 25 % financohet nga të ardhurat dytësore, gjithashtu me të ardhurat dytësore mbulohen ojeserisht edhe zëra të tjerë shpenzimesh. Më hollësisht këtoraporte trejtohen në vijim të këtij kapitulli.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Sipas ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, përcaktohet se:

“Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

“Bordi i Administrimit të UPT cakton në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit”.

Për sa më lart teminologjia për autonomisë nuk mund të zbatohet pasi UPT, duke qënë se përfiton fonde buxhetore rreth 70 % të nevojave të saj nuk mund të caktojë vetë pagat pa u mbështetur në dispozita të tjera ligjore, të cilat deri sot nuk kanë dalë e për rrjedhojë është krijuar vakum ligjor në interperimin dhe funksionimin e autonomisë së UPT.

Njësitë kryesore (fakultetet dhe instituti) në përbërje të UPT-së, pavarësisht se janë njesi shpenzuese, nuk plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për prokurimit publik , për zhvillimin e procedurave të prokurimit pasi nuk kanë strukturën dhe organikën e nevojshme me burime njërezore, të cilat paraqiten me produktivitet të ulët në fushën e prokurimeve publike.

Mbi programimin afatmesëm të buxhetit të Universitetit Politeknik Tiranë

Programimi i shpenzimeve në projektbuxhetin afatmesëm 2014-2016, fondet e çelura nga Buxheti i shtetit në formën Grand i pakushtëzuar së bashku me të ardhurat e UPT, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	EMERTIMI	2014		2015		2016	
		Programuar	Celur	Programuar	Celur	Programuar	Celur
1	Paga, art. (600)	896.109	667.678	886.101	655.096	906.937	648.785
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	114.239	89.000	114.418	89.000	114.547	89.789
3	Shpenzime operative, art. (602)	264.697	163.418	221.043	232.302	229.243	236.382
4	Shpenzime transfertat me jashtë, art. (605)	3.500	4.000	5.520	5.974	5.200	4.000
5	Bursa per studentet, art. (606)	45.000	45.706	45.956	49.606	47.423	42.754
6	Investime, art. (230)	7.730	18.560	1.000	16.879	2.000	17.000
7	Investime , art. (231)	1.128.036	170.339	1.252.649	196.400	647.678	277.694
TOTAL BUXHETI		2.459.311	1.158.701	2.526.686	1.245.257	1.953.068	1.316.404

Nga tabela e mësipërme rezulton se për vitet 2014,2015 dhe 2016 Universiteti Politeknik së bashku me njësitë vartëse ka programuar shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore sipas nivelit të pagave të miratuara bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, sipas numrit të punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm dhe tabelës së pagave për punonjësit akademike dhe punonjësit e tjerë të administratës mbështetëse.

Shpenzimet operative për çdo vit janë miratuar nga Bordi i Administrimit sipas projektbuxhetit afatmesëm të paraqitur nga fakultetet sipas realizimit të viteve parardhës. Realizimi i treguesve të shpenzimeve krahasuar me faktin, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	EMERTIMI	2014		2015		2016	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Paga, art. (600)	662.678	652.909	651.699	635.096	648.972	640.237
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	89.000	87.141	89.000	87.820	91.000	87.849
3	Shpenzime operative, art. (602)	163.418	132.731	185.904	162.301	236.692	215.711

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE
REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK**

4	Shpenzime transferata me jashte, art. (605)	4.000	657	2.000	1.974	4.000	2.430
5	Bursa per studentet, art. (606)	45.706	45.485	48.648	41.307	42.436	24.740
6	Investime, art. (230)	18.560	1.680	6.900	6.821	1.300	4.518
7	Investime , art. (231)	163.299	122.102	177.657	151.401	278.208	125.861
TOTAL BUXHETI (1+7)		1.146.661	1.042.705	1.161.809	1.086.720	1.318.608	1.101.346
8	Te ardh te krijuara te paparashikuara	+12.040		+ 83.448		-2.204	
TOTAL BUXHETI		1.158.701	1.042.705	1.245.257	1086720	1.316.404	1.101.346

Nga krahasimi i treguesve të programuar dhe të çelur në fakt konstatohen disferenca të cilat përfaqësojnë ndryshme në pakësim të artikujve për çdo vit ushtrimor nga Ministria e Financave. Treguesit e mësipërm janë të rakorduar me degën e thesarit për çdo muaj dhe në fund të çdo viti.

Realizimi i shpenzimeve për vitet 2015 dhe 2016

Buxhetet e viteve 2015, 2016 janë hartuar dhe zbatuar në përputhje me ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Shkencën në Republikën e Shqipërisë”, ligjit 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.160/2014 date 27.11.2014 “per buxhetin e vitit 2015”, ligjit nr. 147/2015 datë 17.12.2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, Udhëzimit nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxheti”, i ndryshuar si dhe Statutit të UPT-së.

Fondet e çelura nga buxheti i shtetit për periudhën objekt auditimi dhe të ardhurat e realizuara nga taksa e regjistrimit dhe shkollimit janë përdorur përgjithësisht me efektivitet për realizimin e objektivave të Universitetit Politeknik Tiranë.

Në mujain janar 2015 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit është çelur grand i për UPT në shumën prej 616.003 mijë lek. Me shkresat nr.5 dhe nr 5/1 datë 06.01.2015 Universiteti Politeknik ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe MAS detajimin e këtij grand i. Ministria e Financave dhe dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit ka miratuar detajimet sipas zërave të shpenzimeve përkatësisht me shkresat nr.18082/207 daë 16.01.2015 dhe 9662/3 datë 12.01.2015.

Këshilli i Administrimit, bazuar në të ardhurat e pritshme të vitit 2015, ka miratuar në total dhe të detajuar buxhetin e vitit 2015, me Vendimin nr. 3 datë 05.05.2015 .

Gjatë vitit 2015 Ministria e Arsimit dhe Sportit ka bërë alokim fondesh në muajin mars 2015 dhe dhjetor 2015 me shkresat nr. datë 20.03.2015 dhe 11231/1 datë 29.12.2015.

Këshilli i Adminsitrimt me vendimin nr. 6 datë 27.11.2015 ka miratuar rishikimin e buxhetit të vitit. Gjithashtu në zbatim të akteve ligjore në fuqi janë kryer transferime nga fondi i pagave (fond i vecante) në zërin e shpenzime për rast dalje në pension pleqërie, rast fatkeqësie apo aktivitete sociale për punonjësit.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave dhe krahasimi me planin për vitin 2015 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Ne mijë lekë

Nr.	EMERTIMI	Fonde te grantit qendror (MASH)		Fonde nga të ardhurat e kushtezuara		Totali i fondeve		Në %
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	
1	Paga, art. (600)	482.784	481.784	168.915	152.312	651.699	635.096	97
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	86.000	85.610	3.000	2.210	89.000	87.820	99
3	Shpenzime operative, art. (602)	90	90	185.814	162.211	185.904	162.301	87

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE
REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK**

4	Shpenzime transferata me jashte, art. (605)	0	0	2.000	1.974	2.000	1.794	99
5	Bursa per studentet, art. (606)	47.148	40.768	1.500	539	48.648	41.308	85
6	Investime, art. (230)	0	0	6.900	6.820	6.900	6.820	99
7	Investime , art. (231)	36.071	36.071	141.586	115.329	177.657	151.401	85
TOTAL BUXHETI		652.093	645.323	509.715	441.162	1.161.809	1.086.721	94

Nga tabela e mësipërme rezulton se nëtotal shpenzimet janë relizuar në masën 94 %.

Në raport me totalin e shpenzimeve të programuar financimi nga buxheti i shtetit është në masë prej 56 %, e konkretisht fondet e celura nga grandit i pakushtëzuar kap shumën prej 652 milionë lekë, dhe të radhurat e insitucioni kapin shumën prej 509 mijë lekë. Të ardhurat në fakt krahasuar me planin janë përdorur sipas realizimit në masën 68.3 %.

Duke marrë në konsideratë politikën e ndjekur për reduktimin e shpenzimeve, kjo edhe sipas ecurisë së realizimit të të ardhurave dytësore për vitin 2015, realizimi i shpenzimeve sipas planit dhe faktit sipas të nënzërave përkatës, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	Nr Llogari 602	Objekti i prokurimit	Plani 2015	Realizimi 2015	Realizimi ne %
1	6020100	Kancelari + Leter	1,745,617	1,745,618	100
2	6020200	Materiale per pastrim dezinfikim ngrohje ndricim	3,198,684	3,198,684	100
3	6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	4,079,473	4,079,473	100
4	6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	238,000	48,000	20
5	6020500	Blerje dokumentacioni	400,000	195,568	49
6	6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre e te pergjith.	900,000	847,322	94
8	6021001	Unifforma dhe veshje te tjera speciale	50,000	130,800	87
9	6021007	Libra dhe publikime profesionale	300,000	224,536	75
9	6021009	Materiale dhe pajisje laboratorike	1,139,088	951,480	84
10	6021010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	752,400	752,400	100
11	6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	660,000	433,599	66
12	6022001	Energji elektrike	17,000,000	15,306,960	90
13	6022002	Uje	2,800,000	2,203,980	79
14	6022003	Sherbime telefonike	5,631,000	5,329,141	95
15	6022004	Sherbime postare	250,000	211,426	85
16	6022007	Sherbime bankare	30,000	23,093	77
17	6022008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	34,808,878	32,909,220	95
18	6022009	Sherbime pastrimi	450,000	403,248	90
19	6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	320,000	182,692	57
20	6022099	Sherbime te tjera + mirmbajtje e sek. Mesimore	3,354,750	2,673,490	80
21	6023100	Karburant dhe vaj	6,000,000	5,999,927	100

**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE
REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK**

22	6023200	Pjese kembimi automjete, goma bateri	400,000	343,740	86
23	6023300	Shpenzime per Siguracion per makina	150,000	126,466	84
24	6023900	Shpezime te tjera transporti	100,000	73,500	74
25	6024100	Udhetim brenda vendit	9,950,000	9,054,046	91
26	6024200	Udhetim jashte vendit	4,033,000	3,352,431	83
27	6025200	Shpenzime per mirembajtje objekteve specifike	200,000	6,000	3
28	6025300	Sh. per mirembajtje objekteve ndertimore	3,600,000	3,600,000	100
29	6025400	Sh. mirembajte rrjeteve hidraulike,elektrike,telefon, etj	600,000	389,868	65
30	6025500	Sh. mirembajte Pajisjeve, veglave te punes	500,000	463,078	93
31	6025600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	150,000	55,200	37
32	6025800	Sh. per mirembajte Pajisje zyre	879,600	640,435	73
33	6027500	Sh. gjyqesore	1,000,000	9,800	1
34	6029001	Sh. per pritje percjellje	800,000	432,070	54
35	6029002	Sh. per aktivitete sociale per personelin	960,000	945,480	98
36	6029004	Sh. sigurim ndertese	981,000	981,000	100
37	6029005	Sh. per honorare	60,600,000	50,109,486	83
38	6029007	Sh. Pjesmarrje ne konferenca	3,302,000	2,085,629	63
39	6029008	Sh. tatim dhe taksa	10,707,382	9,050,571	85
40	6029009	Sh. limit arka	20,000	10,000	50
41	6029099	Sh. te tjera materiale dhe sherbime operative	2,673,128	2,631,797	98
Shuma			185,814,000	162,211,254	87
Detyrime				4,569.363	
Shuma totale			185,814,000	166.780.617	90

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se zëri shpenzime operative për vitin 2015 është realizuar në masën 90 %. Peshën specifike më të madhe të shpenzimeve operative e zënë shpenzimet për honorare (Pagesat për punonjësit e angazhuar në kryerjen e oponencave teknike, analizave të tekstit, pagesat për anëtarë të KAD, Senat, Këshilla Fakulteti e Këshilla të Profesoreve), që zënë 32 % të shpenzimeve totale vjetore, shpenzimet për ruajtjen e objekteve që në plan dhe fakt zënë rreth 20% të shpenzimeve totale, shpenzime udhëtim e dieta brenda vendit e praktika të studentëve që në plan dhe fakt zënë rreth 5 % te shpenzimeve totale. Peshë specifike të madhe në shpenzimet e vitit, zënë edhe shpenzime e drejtperdrejta si energji, ujë, telefon,karburant që përbëjnë rreth 17 % të shpenzimeve vjetore.

Për vitin 2015 janë tenderuar dhe likujduar, blerjet e materialeve të kancelarisë, materialeve elektrike, materialeve të pastrimi, bojra printerive e fotokopjeve, shërbimi i ruajtjes së sigurisë fizike, blerje karburanti, mirëmbajtje të ndërtesave (lyerje), sigurimi i ndërtesave e paisjeve etj.

Për vitin 2016 janë mbartur si detyrime për tu paguar shuma 4.569.363 leke. Kjo shumë ka të bëjë me shërbimet e kryera në muajin dhjetor 2015, si shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike 3.229.188 lekë, lidhja online e stacioneve periferike të IGJEUM 402.956 lekë, shërbimi i



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

informatizimit të aktivitetit dhe dokumentacionit të sekretarive mësimore 869.500 lekë etj, që për arsye kohore nuk u mundësua likuidimi i tyre në 2015-ën.

Rezulton se nga njësitë ka një realizim të kënaqshëm të këtij zëri për vitin 2015. Rektori është njësi me shpenzimet më të mëdha në këtë zë, me rreth 36.2% të shpenzimeve vjetore. Kjo për arsye se nga financa e Rektorisë kryhen likuidimet e disa prej procedurave të prokurimit në rang Universiteti, si shpenzimet për sigurimin dhe ruajtjen objekteve, blerje të karburantit për kaldajat, makinat dhe gjeneratorët etj. Këto janë shpenzime që në fakt u përkasin njësive dhe ju ngarkohen si shpenzime këtyre njësive në momentin kur bëhen dalje malli nga magazina e Rektorisë.

Artikulli 602 (shpenzime korente).

Për vitin 2016, fondi i planifikuar për pagesa në zërin e shpenzimeve operative në total ishte 236.692 mijë lekë. Nga granti i akorduar në fillim të vitit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit u përdoren vetëm 13.192 mijë leke për shpenzimet operative. Kjo për arsye të pamjaftueshmërisë së këtij granti, si dhe të detyruar për të kryer pagesat e ujë, drita, telefon e tatim taksa në muajin Janar 2016. 94 % e shpenzimeve të këtij zëri u planifikuan të mbuloheshin nga të ardhurat dytësore.

Në mënyrë analitike financimet dhe lëvizjet e fondeve për vitin 2016 sipas zërave të buxhetit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në 000 lekë

Nr.	EMERTIMI	Fonde nga Granti		Fonde nga të Ardhurat		Totali i Fondeve		Në %
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	
1	Paga, art. (600)	516,784	516,784	132,188	123,453	648,972	640,237	99
2	Sigurimet shoq. dhe shëndets. art.(601)	88,000	87,849	3,000	-	91,000	87,849	97
3	Shpenzime operative, art. (602)	13,192	13,150	223,500	202,561	236,692	215,711	91
4	Shpenzime transferata me jashtë, art. (605)	-	-	4,000	2,430	4,000	2,430	61
5	Bursa për studentet, art. (606)	40,836	24,357	1,600	383	42,436	24,740	58
6	Investime, art. (230)	-	-	17,300	14,509	17,300	14,509	84
7	Investime , art. (231)	42,670	42,646	172,538	143,925	215,208	186,571	87
TOTAL BUXHETI		701,482	684,786	554,126	487,261	1,255,608	1,172,047	93

Për vitin 2016, granti akorduar UPT-së nga MAS (paga, sigurime, bursa e investime) ishte 701.482 mijë lekë, ndërsa financimi nga të ardhurat e institucionit ishte 554.126 mijë lekë. Rreth 44 % e shpenzimeve vjetore u parashikua të mbuloheshin me të ardhurat dytësore.

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se i gjithë buxheti në total për vitin 2016 është realizuar në masën 93 %.fakt që tregon për një planifikim të studiuar në rang, rektori dhe për çdo Universitet.

Fondi i pagave i përballuar nga buxheti i shtetit dhe nga të ardhurat dytësore është realizuar në masën 99 %, fondi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore është realizuar në masën 97% dhe shpenzimet operative financuar në masën më të madhe nga të ardhurat e kushtëzuara janë realizuar në masën 91 %.

**KONTROLI I LARTË I SHETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE
REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK**

Fondi i bursave të studentëve e transfertave të tjera për ndividët është realizuar në masën 58 %. Janë kryer gjithë pagesat për bursat e studentëve për muajt Tetor 2015 – Dhjetor 2016.

Me realizim të kënaqshëm paraqiten edhe investimet (Zëri 231). Financimet buxhetore për investime janë realizuar në masën 100%.

Nga tabela e mësipërme rezulton se, fondi i pagave është programuar në shumë prej 648,972 mijë lekë, nga të cilat fondi buxhetor i çelur nga MAS është në vlerën prej 516,784 mijë lekë dhe nga të ardhurat dytësore janë përdorur 123,453 mijë lekë, ose të ardhurat e vet institucionit në fondin e pagave zënë 23 %, fakt që do të thotë se Bordi i Administrimit nuk mund të realizojë dot autonominë e institucionit në përcaktimin e pagave të punonjësve përderi sa fondet publikë në paga zënë rreth 77 % të totalit të shpenzimeve të këtij zëri.

Krahasuar me vitin 2015, shpenzimet sipas zërave për vitin 2016 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	EMERTIMI	Fakt 2015	Fakt 2016	Në %
1	Paga, art. (600)	635.096	640.237	101
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	87.820	87.849	100
3	Shpenzime operative, art. (602)	162.301	215.711	133
4	Shpenzime transfertat me jashte, art. (605)	1.974	2.430	124
5	Bursa per studentet, art. (606)	41.307	24.740	60
6	Investime, art. (230)	6.821	4.518	67
7	Investime , art. (231)	151.401	125.861	84
TOTAL BUXHETI(1+7)		1.086.720	1.101.346	102

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se realizimi i buxhetit të vitit 2016 është 2% më i lartë se realizimi i buxhetit të vitit 2015. Krahasuar me vitin e kaluar shpenzimet për paga janë realizuar 1 % më tepër si rrjedhojë disa ndryshimeve në numrin e punonjësve.

Shpenzimet operative janë financuar në masën mbi 90 % nga të ardhurat e kushtëzuara në vitin 2016 të cilat janë realizuar 33 % më shumë krahasuar me vitin 2015.

UPT në zërin e transfertave të tjera me jashtë kryhen pagesa për kuotizime të anëtarësimeve në organizatat ndërkombëtare për vitin 2016 janë paguar 6 kuotizime në organizatat ndërkombëtare (AUF, UNICA, BSUN, CMU, Organizaten Botërore të Metereologjisë, dhe AUITEX) kundrejt 4 të paguara në vitin 2015 (CMU, AUF, RMEI dhe OBM). Edhe për këto pagesa janë përdorur fondet nga të ardhurat dytësore.

Sipas njësive vartëse realizimi i fondit të pagave për vitin 2016, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

(000 lekë)

Nr.	Njësitë shpenzuese	Plan Paga 600	Fakt Paga 600	%
1	Rektorati	28.381	28.313	100
2	Biblioteka Shkencore	15.800	15.669	99
3	Fakulteti i Inxh. Elektrike	48.000	47.654	99
4	Fakulteti i Inxh. Ndërtimit	100.000	97.065	97

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE
REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK**

5	Fakulteti i Arkitektures dhe Urbanistikës	48.882	48.770	100
6	Fakulteti i Inxh. Mekanike	85.582	85.020	99
7	Fakulteti i Gjeologjise dhe Minierave	84.334	84.339	100
8	Fakulteti i Teknologjise së Informacionit	59.420	58.651	99
9	Fakulteti i Inxhinierise Matematike dhe Fizike	108.808	107.369	99
10	IGJEUM	69.765	67.387	97
	TOTALI	648.972	640.237	99

Në zërin 606 , transferime korente të brendshme, bursat e studentëve, përfshin të gjitha ato shpenzime për të cilat institucioni nuk përfiton mallra ose shërbime. Për vitin 2016 ky fond është 40% më pak dhe janë likuiduar të gjitha detyrimet për bursa të studentëve për periudhën Tetor 2015 – Dhjetor 2016.

Për vitin 2016 artikulli 230 është realizuar 33 % më pak se sa shpenzimet faktike të vitit 2015. Gjatë këtij viti janë kryer pagesat për financime të projekteve si: Projekte të Kërkimit dhe Zhvillimit të financuara nga AKTI (2 projekte të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike e Fizike), Projekti NORMAK (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike) dhe Projekti UNILAB të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike e Fizike. Krahasur me vitin 2015 tregues i cili është realizuar në masën 99 % krahasuar me planin vjetor). Gjatë këtij viti janë kryer pagesa për Projektet Kërkim Zhvillimit të financuara nga AKTI dhe projekti NORMAK sipas planit të financimit të këtyre projekteve.

Edhe pagesat e këtij zëri janë përballuar nga të ardhurat dytësore

Realizimi i fondeve në zërin e investimeve 231 Investime për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 janë realizuar 16 % më pak se fakti i vitit të kaluar. Për vitin 2016 fondi i investimeve nga të ardhurat është 28 % më i lartë se në vitin 2015.

Realizimi i shpenzimeve të viteve 2016 dhe krahasimi me vitin 2015 , të detajuara sipas natyrës dhe llojit të shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme

Në lekë

Llog	N/Llog	Emertimi	Fakt		Realizimi ne %
			Viti 2015	Viti 2016	
1	6020100	Kancelari + Leter	1,745,618	1,669,339	96
2	6020200	Materiale per pastrim dezinfikim ngrohje ndricim	3,198,684	2,913,824	91
3	6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	4,079,473	3,961,981	97
4	6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	48,000	-	-
5	6020500	Blerje dokumentacioni	195,568	393,776	201
6	6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre e te pergjith.	847,322	444,680	52
7	6021001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	130,800	-	-
8	6021002	Blerje gjelberim, etj	-	-	-
9	6021007	Libra dhe publikime profesionale	224,536	206,434	92
10	6021009	Materiale dhe pajisje laboratorike	951,480	608,184	64
11	6021010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	752,400	1,592,400	212
12	6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	433,599	233,600	54
13	6022001	Energji elektrike	15,306,960	14,627,884	96

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE
REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK**

14	6022002	Uje	2,203,980	2,413,822	110
15	6022003	Sherbime telefonike	5,329,141	4,883,388	92
16	6022004	Sherbime postare	211,426	239,210	113
17	6022007	Sherbime bankare	23,093	35,225	153
18	6022008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	32,909,220	40,153,098	122
19	6022009	Sherbime pastrimi	403,248	501,600	124
20	6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	182,692	345,460	189
21	6022099	Sherbime te tjera + mirembajtje e sek. Mesimore	2,673,490	2,123,993	79
22	6023100	Karburant dhe vaj	5,999,927	6,699,856	112
23	6023200	Pjese kembimi automjete, goma bateri	343,740	105,850	31
24	6023300	Shpenzime per Siguracion per makina	126,466	79,137	63
25	6023900	Shpezime te tjera transporti	73,500	16,500	22
26	6024100	Udhëtim brenda vendit	9,054,046	8,325,554	92
27	6024200	Udhëtim jashte vendit	3,352,431	2,892,901	86
28	6025200	Shpenzime per mirembajtje objekteve specifike	6,000	119,334	-
29	6025300	Sh. per mirembajtje objekteve ndertimore	3,600,000	5,468,856	152
30	6025400	Sh. mirembajte rrjeteve hidraulike,elektrike,telefon, etj	389,868	736,520	189
31	6025500	Sh. mirembajte Pajisjeve, veglave te punes	463,078	686,338	148
32	6025600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	55,200	73,500	133
33	6025800	Sh. per mirembajte Pajisje zyre	640,435	630,100	98
34	6026300	Shpenzime per qiramarrje aparate, pajisjet teknike, etj	-	-	-
35	6027500	Sh. gjyqesore	9,800	-	-
36	6029001	Sh. per pritje percjellje	432,070	601,495	139
37	6029002	Sh. per aktivite sociale per personelin	945,480	1,108,499	117
38	6029004	Sh. sigurim ndertese	981,000	999,990	102
39	6029005	Sh. per honorare	50,109,486	79,123,755	158
40	6029007	Sh. Pjesmarrje ne konferenca	2,085,629	1,477,468	71
41	6029008	Sh. tatim dhe taksa	9,050,571	26,469,609	292
42	6029009	Sh. limit arka	10,000	10,000	100
43	6029099	Sh. te tjera materiale dhe sherbime operative	2,721,797	2,737,917	101
602		Totali	162,301,254	215,711,077	133

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se zëri shpenzime operative se për vitin 2015 peshën specifike më të madhe të shpenzimeve operative e zënë shpenzimet për honorare (Pagesat për punonjësit e angazhuar në kryerjen e oponencave teknike, analizave të tekstilit, pagesat për anëtarë të KAD, Senat, Këshilla Fakulteti e Këshilla te Profesoreve), që zënë 32 % të shpenzimeve totale vjetore, shpenzimet për ruajtjen e objekteve zënë rreth 20% të shpenzimeve totale, shpenzime udhëtim e dieta brenda vendit e praktika të studentëve zënë rreth 5 % te shpenzimeve totale. Peshë specifike të madhe në shpenzimet e vitit, zënë edhe shpenzime e drejtperdrejta si energji, ujë, telefon, karburant që përbëjnë rreth 17 % të shpenzimeve vjetore.

Në vitin 2015 janë kryer procedura prokurimi dhe janë likuiduar, blerje mallra e materiale kancelarie, materialeve elektrike, pastrimi, bojra printerive e fotokopjeve, shërbimi i ruajtjes së sigurisë fizike, blerje karburanti, mirëmbajtje të ndërtesave (lyerje), sigurimi i ndërtesave e pajisjeve etj.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Për kete vit nuk janë mbartur detyrime për t’u paguar shuma 4.569.363 leke, të kryera gjatë muajit dhjetor 2015, si shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike 3.229.188 lekë, lidhja online e stacioneve periferike të IGJEUM 402.956 lekë, shërbimi i informatizimit të aktivitetit dhe dokumentacionit të sekretarive mësimore 869.500 lekë etj, që për arsye kohore nuk u mundësua likuidimi i tyre për vitin 2015.

Edhe për vitin 2016 peshën specifike më të madhe në realizimin e shpenzimeve operative e zënë:

Shpenzimet për honorare rreth 34 % të shpenzimeve totale vjetore,

(Pagesat për punonjësit e angazhuar në grupet e punës për kryerjen e opionencave teknike të ndërtimit, analizave të tekstit, pagesat për anëtarë e Senatit, Këshillave të Fakultetit e Këshillave të Profesorëve si dhe anëtarat e Bordit të Administrimit)

Shpenzimet për tatim dhe taksa zënë 11 % të shpenzimeve totale vjetore,

Shpenzimet për ruajtjen e objekteve që në plan dhe fakt zënë rreth 18 % të shpenzimeve totale,

Shpenzimet e udhëtimit e dieta brenda vendit e praktika të studentëve që në plan dhe fakt zënë rreth 5 % të shpenzimeve totale.

Shpenzimet e drejtpërdrejta për pagesa të tilla si energji, ujë, telefon, karburant që përbëjnë rreth 13 % të shpenzimeve vjetore.

Edhe gjatë vitit 2016 janë tenderuar dhe likuiduar, blerjet e materialeve të kancelarisë, materialeve elektrike, materialeve të pastrimit, bojra printeri e fotokopje, shërbimi i ruajtjes së sigurisë fizike, blerje karburanti, mirëmbajtje të ndërtesave (lyerje), sigurimi i ndërtesave e paisjeve etj.

Po për këtë vit janë mbartur si detyrime për t’u paguar shuma 5,855,217 leke. Kjo shumë ka të bëjë me shërbimet e kryera në muajin dhjetor 2016, si shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike 3,671,090 lekë, shërbimi i informatizimit të aktivitetit dhe dokumentacionit të sekretarive mësimore 822,344 lekë, blerje fidanë, lule e gjelberim për ambientet e UPT – së në shumën 770,748 lekë, blerje materiale të tjera zyre e të përgjithshme në shumën 479,999 lekë, etj. Për arsye të afateve procedurale, nuk e mundur të kryej likuidimi i tyre brenda vitit 2016.

Rektorati është njësia me shpenzimet më të mëdha të këtij zëri me rreth 25-35 %, kjo për arsye se nga financa e Rektoratit kryen likuidimet e disa prej procedurave të prokurimit në rang Universiteti, si shpenzimet për sigurimin dhe ruajtjen e objekteve, blerje të karburantit për kaladajat, makinat dhe gjeneratorët etj. Këto janë shpenzime që në fakt u përkasin njësive, por u ngarkohen si shpenzime këtyre njësive në momentin kur bëhen dalje malli nga magazina e Rektoratit dhe hyrje në magazinat e njësive.

Në nivel krahasimi mes dy viteve konstatohet që në total si dhe disa nënzhëra realizimi i vitit 2016 është më i madh se viti 2015:

Në nënzhërat e shpenzime për honorare (6029905) dhe shpenzimet e bëra për tatim taksat (6029008) realizimi në vitin 2016 58% dhe 192 % me imadhi se viti 2015. Efekt pozitiv në realizimin e të ardhurave kanë dhënë arkëtimet nga opionencat teknike për Projektet Teknike të Gazsjellësit të Projektit TAP, nga të cilat u realizuan edhe pagesat për grupet e punës së punonjësve të angazhuar në kete veprimtari si dhe pagesat e TVSH-së për llogari të shoqërisë T..., në lidhje me opionencat teknike të ndërtimeve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Gjatë vitit 2016 në zërin blerje dokumentacioni dhe dokumentacioni specifik, shpenzimet janë rritur rreth 2 herë më shumë se viti paraardhës, pasi janë kryer shpenzime për riprodhimin e tyre sipas kërkesave në rritje të njësive, siç mund të përmendim diploma, librezat etj.

Në zërin shërbime të sigurimit dhe ruajtjes, mirëmbajtje të objekteve ndërtimore, pritje përcjellje në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 me rreth 22-50 %. Kjo rritje ka ardhur si rrjedhojë kryerjes së shpenzimeve për ruajtje objekteve dhe rritjes së shpenzimeve për mirëmbajtje endertesave, etj.

Ralizimi i investimeve gjatë vitit 2016 dhe krahasimi me vitin 2016, sipas natyrës dhe llojit të shpenzimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000 lekë

Nr.		Investimet	Fakt2015	Fakt 2016	Në %
I	230				
1		Studime kerkime nga projektet	6.821	4518	67
II	231				
1	231.2103	Shpenzime per rikonstruksion -ndertesa shkollore e te tjera ndertimore	132.244	53.221	41
2	231.3500	Shpenzime per instalim rrjeti		214	-
3	231.4130	Shpenzime per paisje qe sigurojne energji	0	11.340	-
4	231.4140	Shpenzime per paisje dhe instrumenta laborator	86	7.792	-
5	1.4170	Shpenzime per blerjedhe instalim kondicioner	0	4.812	-
5	31.4290	Shpenzime per blerje video projektor	768	0	-
6	2314320	Shpenzime per paisjete tjera teknike	2.200	3168	144
7	2314310	Shpenzime per blerje te tjera (shkalle)		479	-
8	2318100	Shpenzime per orendi e te tjera zyre	4.794	44.700	-
9	2318500	Shpenzime per softe informatike	534	0	-
10	2318600	Shpenzime per blerje pajisje kompjuterike	9815		-
11	2318700	Shpenzime te tjera paisje zyre	959	614	64
		T O T A L I	158.222	130.379	83

Për vitin 2016 investimet krahasuar me vitin 2015 janë realizuar 17 % më pak se viti i kaluar. Për çdo vit ushtrimor buxheti ka përcaktuar prioritetet sipas kërkesave të parqitura nga njësitet vartëse, si dhe kërkeat për investime janë më të mëdha se fondet që janë në dispozicion. Në investimet e vitit 2015 i është dhënë prioritet plotësimi i kërkesave, që kanë të bëjnë me ndërtimet e reja e rikonstruksione për përmirësimin e infrastrukturës bazë si dhe blerjen e bazës materiale (orendi zyre e pajisje kompjuterike) në funksion të përmirësimit të kushteve për realizimin e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.

Ndërsa investimet e vitit 2016 kanë si prioritet plotësimin e kërkesave, që kanë të bëjnë me blerjen e bazës materiale orendi zyre e pajisje kompjuterike e pajisje që sigurojnë energji në funksion këto të përmirësimit të kushteve për realizimin e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor si dhe përmirësimit të infrastrukturës bazë (rikonstruksione), mbi bazën e projekteve të plotësuara dhe të argumentuara.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Për vitin 2015 Universiteti Politeknik u financua nga grandi në vlerën prej **36.071 mijë** për ndërtimin e shtesës së korpusit, vlerë e cila finançoi të gjithë punimet e deklarura në situacionet e paraqitura nga shoqëria sipërmarrëse.

Për vitin 2015, nga të ardhurat dytësore, investimet u financuan si më poshtë:

-Në kategorinë II, “Shpenzime për ndërtesa shkollore e te tjera rikonstruksione” nta të cilat për ndërtimin e shtesës së korpusit kryesor, është përdorur fondi 83.944 mijë lekë. Për rikonstruksione e të tjera ndërtimore janë shpenzuar 12.229 mijë lekë.

Gjatë vitit 2015 ka janë realizuar procedurat për blerje të pajisjeve kompjuterike dhe inventareve sipas parashikimit të projektbuxhetit të këtij viti, si dhe janë kryer të gjitha procedurat e prokurimit për blerje pajisje laboratorike, kondicioner, orendi zyre etj.

Për vitin 2016 financimet nga buxheti i shtetit paraqiten si më poshtë:

-Për vitin 2016, në zërin studime e projekte e investime nga të ardhurat dytësore (zëri 230+231), ishin parashikuar fonde në shumën 189.838 mijë lekë, në mënyrë të detajuara plan-fakt dhe sipas destinacionit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në 000 /lekë

Nr.	Nr. Llogari 230-231	Objekti i prokurimit	Plani 2016	Fakt 2016	Likujuar me bankë 2016	Lidhur Kontrata 2016 por e palikujdur në 2017
1	230.2000	Shpenz. për projektim nga ana konstruksioneve e godinave të UPT	10,300	9.991	0	9.991
2	230.2000	Shpenzime për studime e projekte të tjera	7.000	4518	4.518	0
	A	Shuma zerit 230	17.300	14.509	4.518	9.991
1	2312103	Shpenzime për Mbikqyrje dhe Kolaudim të ndërtesës së godinës së re Korpusi UPT dhe punimeve të tjera	1.670	1735	1.735	0
2	2312101	Ndërtim i shtesës së korpusit dif e papaguar vitit 2015	468	468	468	0
3	2312103	Rikonstruksion i nyjeve sanitare të korpusit qendror të UPT	6.547	6.547	6.547	0
4	2312103	Shpenz. Rikonstruksion ndërtesa shkollore, hidroizolim tarace	960	915	915	0
5	2312103	Shpenz. Rikonstruksion kati nëndheshëm i BSH	8,300	0	0	0
6	2312103	Shpenz. për rikonstruksion - ndërtesa shkollore (laboratori DIM) 20% shtesë kont.	804	813	813	0
7	2312103	Shpenz. për rikonstruksion - Dyer anësore të Godina Korpusit	2,500	0	0	0
8	2312112	Shpenz. për krijim fondi biblioteke	1.472	512	512	0
9	2312118	Shpenz. të tjera ndërtimore	935	285	285	0
10	2313300	Shpenz. për instalim rrjeti kaldajes	2,500	1187	0	1.187
11	2312116	Shpenz. për instalim rrjeti kompjuterik	400	214	214	0
12	2314130	Shpenz. për pajisje që sigurojnë energji (transformatore+gjeneratore + shtesë fuqie)	12.000	11.340	11.340	0
13	2314140	Shpenz. për - pajisje dhe instrumente laboratorike	24.046	21.507	7.792	13.715



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

14	2314170	Shpenz. për Blerje dhe instalim kondicionere shtese 20%	4.912	4812	4.812	0
15	2314280	Shpenz. per paisje per sistemin e sigurimit	9,000	8853	0	8.853
16	2314290	Shpenz. per paisje audio-vizuale	1,380	964	0	964
17	2314320	Shpenz. per paisje te tjera teknike	2,913	2468	2.468	0
18	2318100	Shpenz. per Orendi zyre	44,700	44700	44.700	0
19	2318500	Shpenz. per Softe informatike profesionale	3,720	0	0	0
20	2318600	Shpenz. per Paisje kompjuterike	42,350	35991	0	35.991
21	2318700	Shpenz. per te tjera paisje zyre	960	614	614	0
	B	Shuma zerit 231	17.2538	143.925	83.215	60.710
	A+B	Gjithsej investimet 2016 (230+231)	189.838	158.434	87.733	70.701

Shpenzimet për investime në mënyrë analitike paraqiten:

- 1.Ndërtimi i shtesës së korpusit në shumën prej 41.970 mijë lekë, e cila u shpenzua sipas shtesës së kontratës shoqëruar me situacionet periodike dhe përfundimtare.
- 2.Për pagesa të TVSH në shumën 700 mijë lekë të paisjeve të ardhura në doganë nga Projekti “PROJEKTI GOEWEB- ERASMUS + “.

Nga të ardhurat dytësore për vitin 2016, prioritet në zërin e investimeve ka qenë blerja e orendive “Pajisje zyre e kompjuterike” për plotësimin e shtesës së re të korpusit në mënyrë të veçantë si dhe njësisë të tjera vartëse. Këto dy zëra shpenzimi zënë 45.8 % të të gjithë shumës së planifikuar të investimeve për vitin 2016.

Prioritet i rëndësishëm i investimeve i realizuar për vitin 2016, ishte dhe procedura për pajisjen e një laboratorit të ri në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit (laboratori i hidraulikës) si dhe pajisje laboratorike për laboratorë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike dhe Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave në shumën prej 21.507 mije lekë.

Për vitin 2016 është parashikuar blerja e pajisjes për sigurimin e burimit alternativ të energjisë, si një nga kërkesat percaktuara në standartet Europiane të cilësive, për sigurimin e panderprerë me energji elektrike në ndërtesën e shtesës së re të korpusit, apo edhe në ndërtesat e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, Fakultetit të Gjeologjisë Minierave Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës. Kjo blerja u realizua me procedurë elektronike me fond limit në shumën prej 12.000 mije lek dhe me fitusin u lidh kontrata në vlerën prej 11.340 mijë lek.

-Nga procedurat e parashikuara në vitin 2016 nuk u realizuan:

1. Procedura e rikonstruksion të katit të nëndheshëm të Bibliotekës Shkencore për investimin e të cilit ishte miratuar një fond prej 8.300 mije leke pasi për arsye administrative kërkesa për lejen e punimeve nuk u shqyrtua në kohë nga Bashkia e Tiranës.
2. Rikonstruksioni i dyerve anësore të korpusit. Për këtë investim ishte miratuar një fond prej 2.500 mije lekë. Nuk u realizua sepse procedura e miratimit të projektit nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, zgjati tej afateve të parashikuara.
3. Blerje soft informatike profesionale. Procedura e blerjes u hodh elektronikisht në dhjetor 2016. Nuk u paraqit asnjë subjekt ofertues me cmimet dhe parametrat e hedhura, gjë që solli anulimin e procedurës dhe mosfinalizim të saj.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

4. Blerje paisjeve kompjuterike për dy laboratorët e Gjeoinformatikës në FGJM në shumën 4.660 mijë lek. Kjo procedurë u hodh si loti i tretë i procedurës “Blerje paisjeve kompjuterike e servera për nevojat e UPT” por nuk u realizua për mungesë konkurrence (nuk u paraqit asnjë operator që ofron paisje të tilla).

Më hollësisht sipas burimeve të financimit shpenzimet sipas zërave për vitin 2015 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Për vitin 2016 shpenzimet operative sips planit dhe realizimit në fakt paraqiten sipas tabelës së mëposhtme

Në lekë

Nr.	Nr Llogari 602	Objekti i prokurimit	Plani 2016	Realizimi 2016	Realizimi ne %
1	6020100	Kancelari + Leter	1,669,340	1,669,339	100
2	6020200	Materiale per pastrim dezinfikim ngrohje ndricim	2,913,824	2,913,824	100
3	6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	3,961,990	3,961,981	100
4	6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	350,000	-	-
5	6020500	Blerje dokumentacioni	500,000	393,776	79
6	6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre e te pergjithshme	900,000	444,680	49
7	6021002	Blerje gjelberim, etj	1,000,000	-	-
8	6021007	Libra dhe publikime profesionale	360,300	206,434	57
9	6021009	Materiale dhe pajisje laboratorike	960,000	608,184	63
10	6021010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni	1,592,400	1,592,400	100
11	6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	400,000	233,600	58
12	6022001	Energji elektrike	15,000,000	14,627,884	98
13	6022002	Uje	2,800,000	2,413,822	86
14	6022003	Sherbime telefonike	6,169,875	4,883,388	79
15	6022004	Sherbime postare	425,000	239,210	56
16	6022007	Sherbime bankare	40,000	35,225	88
17	6022008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	44,000,000	40,153,098	91
18	6022009	Sherbime pastrimi	630,000	501,600	80
19	6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	760,000	345,460	45
20	6022099	Sherbime te tjera + mirembajtje e sek. Mesimore	3,000,000	2,123,993	71
21	6023100	Karburant	6,700,000	6,699,856	100
22	6023200	Pjese kembimi automjete, goma bateri	119,590	105,850	89
23	6023300	Shpenzime per Siguracion per makina	100,000	79,137	79
24	6023900	Shpezime te tjera transporti	120,000	16,500	14
25	6024100	Udhetim brenda vendit	10,530,000	8,325,554	79
26	6024200	Udhetim jashte vendit	5,150,000	2,892,901	56
27	6025200	Shpenzime per mirembajtje objekteve specifike	120,000	119,334	99
28	6025300	Sh. per mirembajtje objekteve ndertimore	5,500,000	5,468,856	99
29	6025400	Sh. mirembajte rrjeteve hidraulike,elektrike,telefon, etj	800,000	736,520	92
30	6025500	Sh. mirembajte Pajisjeve, veglave te punes	880,000	686,338	78



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

31	6025600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	100,000	73,500	74
32	6025800	Sh. per mirembajte Pajisje zyre	765,000	630,100	82
33	6027500	Sh. gjyqesore	200,000	-	-
34	6029001	Sh. per pritje percjellje	800,000	601,495	75
35	6029002	Sh. per aktivite sociale per personelin	1,152,000	1,108,499	96
36	6029004	Sh. sigurim ndertese	1,000,000	999,990	100
37	6029005	Sh. per honorare	81,102,681	79,123,755	98
38	6029007	Sh. Pjesmarrje ne konferenca	3,500,000	1,477,468	42
39	6029008	Sh. tatim dhe taksa	26,700,000	26,469,609	99
40	6029009	Sh. limit arka	20,000	10,000	50
41	6029099	Sh. te tjera materiale dhe operative	3,900,000	2,737,917	70
Shuma (1)			236,692,000	215,711,077	91
Kontata te lidhura dhe fatura per likuidim ne 2017)			-	5,855,217	
Gjithsej (1+2)			236,692,000	221,566,294	94

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se zëri shpenzime operative për vitin 2016 është realizuar në masën 94 %. Peshën specifike më të madhe të shpenzimeve operative e zënë:

Shpenzimet për honorare rreth 34 % të shpenzimeve totale vjetore,

(Pagesat për punonjësit e angazhuar në grupet e punës për kryerjen e opionencave teknike të ndërtimit, analizave të tekstit, pagesat për anëtarë e Senatit, Këshillave të Fakultetit e Këshillave të Profesorëve si dhe anëtarat e Bordit të Administrimit)

Shpenzimet për tatim dhe taksa zënë 11 % të shpenzimeve totale vjetore,

Shpenzimet për ruajtjen e objekteve që në plan dhe fakt zënë rreth 18 % të shpenzimeve totale,

Shpenzimet e udhëtimit e dieta brenda vendit e praktika të studentëve që në plan dhe fakt zënë rreth 5 % të shpenzimeve totale.

Shpenzimet e drejtpërdrejta për pagesa të tilla si energji, ujë, telefon, karburant që përbëjnë rreth 13 % të shpenzimeve vjetore.

Gjate vitit 2016 janë tenderuar dhe likuiduar, blerjet e materialeve të kancelarisë, materialeve elektrike, materialeve të pastrimi, bojra printeri e fotokopje, shërbimi i ruajtjes së sigurisë fizike, blerje karburanti, mirëmbajtje të ndërtesave (lyerje), sigurimi i ndërtesave e paisjeve etj.

Për vitin 2017 janë mbartur si detyrime për tu paguar shuma 5,855,217 leke. Kjo shumë ka të bëjë me shërbimet e kryera në muajin dhjetor 2016, si shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike 3,671,090 lekë, shërbimi i informatizimit të aktivitetit dhe dokumentacionit të sekretarive mësimore 822,344 lekë, blerje fidanë, lule e gjelberim për ambientet e UPT – së në shumën 770,748 lekë, blerje materiale të tjera zyre e të përgjithshme në shumën 479,999 lekë, etj. Për arsye të afateve procedurale, nuk e mundur te kryej likuidimi i tyre brenda vitit 2016.

Rektorati është njësi me shpenzimet më të mëdha, me rreth 34 % të shpenzimeve vjetore. Kjo për arsye se nga financa e Rektoratit kryen likuidimet e disa prej procedurave të prokurimit në rang Universiteti, si shpenzimet për sigurimin dhe ruajtjen objekteve, blerje të karburantit për kaldajat, makinat dhe gjeneratorët etj. Këto janë shpenzime që në fakt u përkasin njësisë, por u ngarkohen si shpenzime këtyre njësisë në momentin kur bëhen dalje malli nga magazina e Rektoratit dhe hyrje në magazinat e njësisë.

Artikulli 605 (transferime korente të jashtme)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Për vitin 2016 janë paguar kuotizacionet në organizatat ndërkombëtare nga Rektorati (AUF, UNICA, BSUN, CMU), nga IGJEUM (anetaresim në Organizaten Botërore të Metereologjisë) dhe FIM (AUITEX) sipas parashikimit.

Këto pagesa janë kryer me fondet e të ardhurave dytësore.

Artikulli 606 (transferime korente të brendshme, bursat e studentëve)

Ky artikull përfshin të gjitha ato shpenzime për të cilat institucioni nuk përfiton mallra ose shërbime. Për vitin 2016, grandit akorduar për bursa ishte në shumën **40.000 mijë lekë**, shuma e cila nuk u ezauroi plotësisht, por janë likujduar të gjitha detyrimet për bursa të studenteve për periudhën Tetor 2015 – Dhjetor 2016.

Investimet në total për vitin 2016 janë realizuar në masën 83.4% ose nga 189.838 leke në plan janë realizuar 158.434 mijë leke, nga të cilat 87.763 mijë lekë janë likujduar dhe 70.701 mijë lekë janë realizuar si procedura dhe për arsye të afateve procedurale janë mbartur si detyrime për likujdim në vitin 2017.

Në zërin 230 janë kryer pagesat për shpenzimet e pritshme për vitin 2016.

Në këtë zë janë kryer të gjitha pagesat sipas parashikimit dhe planit të financimit të projekteve si: Projekte të Kërkimit dhe Zhvillimit të financuara nga AKTI (2 projekte të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike e Fizike), Projekti NORMAK (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike) dhe Projekti UNILAB të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike e Fizike, të cilat në total kapin shifrën 4.518 mijë lek.

Është mbartur si detyrim shuma 9.991 mijë lek dhe kjo është procedura e shërbimit të konsulencës për *“Projektit e vlerësimit strukturor dhe rehabilitimitin e ndërtesave të Universitetit Politeknik të Tiranës (shitesat anësore të godinës së korpusit, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike*. Ky projekt ka qenë një ndër prioritetet kryesore të parashikuara në objektivat strategjike të Institucionit me qëllim rritjen e sigurisë së godinave dhe parametrave infrastrukturore në përputhje me normativat aktuale të ndërtimit.

Në zërin 231 janë kryer pagesat për shpenzimet e pritshme për vitin 2016.

Në zërin 231 realizimi nga të ardhurat është në shumën 143.925 mijë lekë, nga të cilat 83.215 mijë lekë të likujduara me bankën dhe 60.710 mijë lekë detyrim për tu likujduar në vitin 2017.

Për vitin 2016, prioritet në zërin e investimeve ishin blerje orendi zyre e paisje kompjuterike për plotësimin e shtesës së re të korpusit në vecanti dhe njësisë në teresi. Këto dy zëra zënë dhe 45.8 % të gjithë shumës së planifikuar të investimeve për vitin 2016. Të dyja procedurat janë realizuar. Blerje orendi zyre është realizuar si procedurë dhe është likujduar me bankë në muajin dhjetor 2016, ndërsa blerje paisje kompjuterike janë lidhur kontratat, për lotin e parë më datë 28.12.2016 “Blerje paisje kompjuterike dhe videoprojektor” dhe për lotin e dytë “Blerje paisje për infrastrukturën hardware për instalim lokal të sistemit U-GOV” më datë 24.01.2017.

Sipas afateve të prokurimit likuidimi është kryer në muajin Prill 2017.

Prioritet i rëndësishëm i investimeve i realizuar për vitin 2016, ishte dhe blerja paisje laboratorike për një laborator të ri në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit (laboratori i hidraulikës) si dhe paisje laboratorike për laboratorë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike dhe Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave në shumën 21.507 mijë lekë.

Për vitin 2016 ishte parashikuar edhe blerja e paisje për sigurimin e burimeve alternative të energjisë, si një nga kërkesat percaktuara në standartet Europiane të cilesisë, për të siguruar në mënyrë të përdorshme energji elektrike, në ndërtesën e shtesës së re të korpusit, në ndërtesat e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave si dhe Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës. Kjo blerje u tenderua elektronikisht për fondin limit 12.000 mijë lek dhe u fitua nga subjekti me lidhjen kontratës në shumën 11.340 mijë lek. Likujdimi i kësaj shume u krye në muajin dhjetor 2016. Gjatë vitit 2016 ishte parashikuar edhe blerje e instalimi i sistemit të kamerave për sigurinë e objekteve të Universitetit në shumën 9.000 mijë lek . Edhe kjo procedurë është realizuar dhe është finalizuar me lidhjen e kontratës në janar 2017. Likujdimi kontrates për furnizim është bërë në muajin Shkurt 2017.

Vihet re që ka funksionuar mirë procesi i blerjeve të paisjeve dhe inventareve pasi në çdo prokurim janë krijuar “kursime”, si rezultat i ofertave më të ulta të operatorëve që kanë ofruar mallrat dhe shërbimet.

Për vitin 2017 programimi dhe realizimi i shpenzimeve deri në datën 31.09.2017, parqitet në tabelën e mëposhtme:

Ne mijë lekë

Nr.	EMERTIMI	Fonde të grantit qendror (MASH)		Fonde nga të ardhurat e kushtezuara		Totali i fondeve		Në %
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	
1	Paga, art. (600)	584.144	450.425	126.476	56.178	710.620	506.603	71
2	Sigurimet shoq. dhe shëndets. art.(601)	91.000	69.711	4.000	0	95.000	69.728	73
3	Shpenzime operative, art. (602)	10.000	10.000	199.020	108.676	209.020	118.676	57
4	Shpenzime transferata me jashte, art. (605)	0	0	3.800	2.410	3.800	2.410	63
5	Bursa për studentet, art. (606)	45.000	20.012	2.000	644	47.000	20.656	44
6	Investime, art. (230)	0	0	14.500	12.660	14.500	12.660	87
7	Investime , art. (231)	575	0	183.960	58.576	284.535	58.576	32
TOTAL BUXHETI		730.719	550.148	533.756	239.161	1.264.475	789.309	62

3. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

-Respektimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin për periudhën objekt auditimi.

-Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve,

-Realizimi i fondit të pagave dhe krahasimi me vitet e mëparshme.

-Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi etj.

-Respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

3. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Në Universitetin Politeknik të Tiranës zbatimi e marrëdhënieve të punës për periudhën 01.10.2013 deri më 17.09.2015, rezulton se janë rregulluar sipas dispozitave të ligjit nr. 9741 datë 21.05.2007 “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu VII “Personeli i Institucioneve të Arsimit të Lartë”, neni 46, ku përcaktohet se “*Personeli i institucionit të arsimit të lartë përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës mësionor dhe shkencor dhe personeli administrativ*” dhe “*Detyrat dhe të drejtat e personelit të institucioneve të arsimit të lartë përcaktohen në statutin e institucioneve përkatëse e në rregulloret e tyre, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi*”. Në zbatim të nenit 50 të ligjit, kriteret për punësim në institucionet e larta për çdo kategori të personelit akademik dhe administrativ përcaktohen në statutin e institucionit. Nga auditimi i kryer mbi strukturën dhe vendimet e UPT-së rezultoi se në zbatim të ligjit nr.9741 datë 21.05.2007 i ndryshuar, neni 16 pika 1, gërma “gj” Rektori ka propozuar strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të institucioneve për të gjitha nivelet dhe sipas nenit 16, pika 1, gërma “ç” Këshilli i Administrimit ka miratuar strukturën dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet, kjo në përputhje dhe me Statutin e miratuar nga Senati në datën 25.06.2008, Kreu V, neni 49 pika 4, ku citohet “*Numri i përgjithshëm i personelit në UPT miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës*”.

-Me shkresën nr.181 prot., datë 14.02.2014, me objekt “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin 2014”, UPT i ka kërkuar MASH miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit, konkretisht: punonjës efektiv me kohë të plotë 744 (shtatëqindëdyzetekatër, akademikë, administrativ, ndihmës), punonjës me kontratë 760. për vitin 2014. MASH në kundërshtim me nenin 16, 47, 48, 49 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nuk i ka kthyer përgjigje UPT për miratimin e strukturës organizative për vitin 2014.

-Me shkresën e MASH nr.4276/1 prot., të datës 11.06.2015 me objekt “Dërgohet numri i përgjithshëm i personelit i miratuar për vitin 2015” përcaktohet se, numri i përgjithshëm i personelit i miratuar, për vitin 2015 është 744 (shtatëqindëdyzetekatër).

Për periudhën 01.10.2016 deri më 31.08.2017 marrëdhënjet e punës në UPT, janë rregulluar sipas dispozitave të ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu VI “Personeli i institucioneve të arsimit të lartë”, neni 57 pika 1, ku përcaktohet se “*Personeli i institucionit të arsimit të lartë përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës akademik dhe personeli administrative*”. Nga auditimi i kryer mbi strukturën dhe vendimet rezultoi se për këtë periudhë UPT ka funksionuar me strukturën organike të miratuar me vendimin nr. 2, datë 05.05.2015 “Për miratimin e strukturës dhe numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet” të Këshillit Administrativ, duke mos mos e rinovuar strukturën, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, neni 38, pika 1, gërma “ç” në të cilën citohet “Senati Akademik harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet” si dhe nenin 49, pika 1, gërma “ç” ku citohet “Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

UPT për periudhën 17.09.2015 e në vijim, nuk ka përditësuar Statutin dhe Rregulloren e Administratës së Rektoratit me ndryshimet ligjore që ka pësuar legjislacioni mbi arsimin e lartë, konkretisht ligjin nr. 80/2015 datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, gërma “c” në të cilën citohet “Senati miraton statutin e institucionit të arsimit të lartë.....”. UPT ka vijuar të funksionojë me Statutin e miratuar nga Senati në datën 25.06.2008, si dhe Rregulloren e Brendshme, miratuar me urdhrin nr. 60, datë 26.06.2015, të rektorit të UPT. Për rrjedhojë detyrat dhe të drejtat e personelit të institucioneve të arsimit të lartë nuk janë përcaktuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njëkohësisht edhe procedura e punësimit të personelit akademik pranë fakulteteve të UPT është hartuar nga Rektorati i UPT-së në Tetor 2010, procedurë e cila nuk është rishikuar pas ndryshimeve që ka pësuar LAL. Kështu edhe kriteret për punësim për çdo kategori të personelit akademik dhe administrativ duhet të përcaktohen në përputhje me legjislacionin në statutin e institucionit dhe rregulloren e brendshme. Gjithashtu edhe Rregullorja mbi funksionimin e Bordit të Administrimit të UPT-ës, nuk është miratuar nga Senati, në kundërshtim me kërkesat e nenit 38, pika 1, gërma “d” të ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015, ku citohet “Miraton rregulloret e institucionit dhe aktet e tjera, sipas përcaktimeve të bëra në statut”. Po kështu edhe Rregulloret e brendshme pothuajse në të gjithë fakultetet e UPT duhet të rishikohen për tu prshtatur kërkesave të kuadrit të ri ligjor, konkretisht ligjit 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Respektimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin për periudhën 01.10.2013 deri më 31.08.2017.

Struktura e personelit për UPT-në për periudhën objekt auditimi

Tabela nr.1

VITI	Numri i punonjesve efektive				Numri i punonjesve me kontrate			
	Plan KAD	Fakt			Plan KAD	Fakt		
	Punonjes gjithsej	Punonjes gjithsej	Punonjes akademik	Punonjes ndihmes administrate	Punonjes gjithsej	Punonjes gjithsej	Punonjes akademik	Te jashtem IGJEUM, Punonjes ndihmes administr.
Viti 2013								
Rektorat	61	36	3	33	0	0	0	0
Fak.Teknologjise Informacionit	86	57	34	23	37	41	41	0
Fak.Inxhinierise Elektrike	60	42	24	18	27	22	22	0
Fak.Inxhinierise Mekanike	85	73	50	23	80	80	80	0
Fak.Gjeologjise e Minierave	98	77	47	30	47	44	44	0
Fakulteti Inxhinierise Ndertimit	93	131	96	35	140	140	140	0
Fakulteti I Arkitektures dhe urbanistikes	53	0						
IGJEUM	76	65	50	15	290	269	0	269



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Biblioteka Shkencore	26	26	0	26	0	0	0	0
Fakulteti Inxhinierise matematike Fizike	106	93	76	17	139	111	111	0
Gjithsej 2013	744	600	380	220	760	707	438	269
Viti 2014								
Rektorat	58	36	3	33	0	0	0	0
Fak.Teknologjise Informacionit	84	57	34	23	49	46	46	0
Fak.Inxhinierise Elektrike	60	47	26	21	27	22	22	0
Fak.Inxhinierise Mekanike	86	70	48	22	80	80	80	0
Fak.Gjeologjise e Minierave	97	73	43	30	47	44	44	0
Fakulteti Inxhinierise Ndertimit	101	87	63	24	90	90	90	0
Fakulteti I Arkitektures dhe urbanistikes	55	48	35	13	50	50	50	0
IGJEUM	71	62	51	11	278	262	0	262
Biblioteka Shkencore	26	24	0	24	0	0	0	0
Fakulteti Inxhinierise matematike Fizike	106	95	78	17	139	139	139	0
Gjithsej 2014	744	599	381	218	760	733	471	262
Viti 2015								
Rektorat	58	38	3	35	0	0	0	0
Fak.Teknologjise Informacionit	84	54	34	20	40	35	35	0
Fak.Inxhinierise Elektrike	60	47	26	21	20	13	13	0
Fak.Inxhinierise Mekanike	86	71	51	20	87	78	78	0
Fak.Gjeologjise e Minierave	97	77	48	29	45	21	21	0
Fakulteti Inxhinierise Ndertimit	101	85	61	24	80	64	64	0
Fakulteti I Arkitektures dhe urbanistikes	55	48	35	13	70	50	57	
IGJEUM	71	53	38	15	265	257	0	257
Biblioteka Shkencore	26	23	0	23	0	0	0	0
Fakulteti Inxhinierise matematike Fizike	106	94	77	17	153	117	117	0
Gjithsej 2015	744	590	373	217	760	635	378	257
Viti 2016								
Rektorat	56	38	3	35	0	0	0	0
Fak.Teknologjise Informacionit	84	54	34	20	40	36	36	0
Fak.Inxhinierise Elektrike	60	47	26	21	20	13	13	0
Fak.Inxhinierise Mekanike	86	72	52	20	87	66	66	0
Fak.Gjeologjise e Minierave	97	75	47	28	45	25	25	0

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE
REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK**

Fakulteti Inxhinierise Ndertimit	102	84	60	24	80	61	61	0
Fakulteti I Arkitektures dhe urbanistikes	56	49	36	13	70	62	62	
IGJEUM	71	53	38	15	257	257	0	257
Biblioteka Shkencore	26	23	0	23	0	0	0	0
Fakulteti Inxhinierise matematike Fizike	106	92	75	17	153	83	83	0
Gjithsej 2016	744	587	371	216	760	603	346	257
9/mujori Viti 2017								
Rektorat	56	38	3	35	0	0	0	0
Fak.Teknologjise Informacionit	84	52	34	18	45	36	36	0
Fak.Inxhinierise Elektrike	60	48	27	21	20	10	10	0
Fak.Inxhinierise Mekanike	86	72	52	20	80	62	62	0
Fak.Gjeologjise e Minierave	97	75	47	28	45	25	25	0
Fakulteti Inxhinierise Ndertimit	102	84	60	24	82	68	68	0
Fakulteti I Arkitektures dhe urbanistikes	56	49	36	13	90	40	40	
IGJEUM	71	53	38	15	260	250	0	250
Biblioteka Shkencore	26	23	0	23	0	0	0	0
Fakulteti Inxhinierise matematike Fizike	106	92	75	17	138	89	89	0
Gjithsej 9 mujori 2017	744	586	372	214	760	580	330	250

(Burimi i Informacionit është Drejtoria Ekonomike dhe institucionet e varësisë)

Në Strukturën Organike të UPT, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, për periudhën objekt auditimi, nuk është plotësuar dhe as tejkaluar numri i miratuar i punonjësve si për rektoratin ashtu dhe në total me njësitë e vartësisë.

Për vitin 2014 numri i punonjësve efektivë të miratuar nga KAD për UPT është 744 gjithsej dhe realizimi 599 (-145 punonjës akademik) dhe njëkohësisht konstatohet se edhe pse numri i punonjësve akademikë efektivë nuk është realizuar, numri i punonjësve akademikë me kontratë për këtë vit kalendarik është 471. Po i njëjti fenomen konstatohet edhe për vitet në vijim, kështu, për vitin 2015 numri i punonjësve akademikë me kontratë është 378, dhe vendet vakant në stafin akademik janë 136 punonjës, për vitin 2016 numri i punonjësve akademikë me kontratë është 378 dhe vendet vakant në stafin akademik janë 157 punonjës, për nëntë mujorin/viti 2017 numri i punonjësve akademikë me kontratë është 330 dhe vendet vakant në stafin akademik janë 158 punonjës.

Tabela: Punonjës akademikë efektive sipas gradës shkencore

Nr.	Emërtimi	Viti akademik 2013/2014	Viti akademik 2014-2015	Viti akademik 2015-2016	Viti akademik 2016-2017
1	Profesor	54	59	57	57
2	Profesor i asociuar	69	65	69	73
3	Lektor i parë (lektor)	94	65	98	137
4	Asistent lektor (asistent lektor)	131	170	122	105
5	Docent	0	1	6	-
6	Kërkues i parë	13	10	10	-
7	kërkues	17	15	11	-

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE
REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK**

		378	385	373	372
--	--	-----	-----	-----	-----

(Burimi i Informacionit, Drejtoria Burimeve Njerëzore)

Numri i punonjësve sipas listë pagesave për çdo muaj dhe paga bruto e tyre, është realizuar si më poshtë:

Mbi numrin e punonjësve dhe pagën bruto

Tabela nr.2

	Muaji	Viti 2014			Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
		Nr. Pun	Fakt	Paga bruto /000 lekë	Nr. Pun	fakt	Paga bruto /000 lekë	Nr. Pun	fakt	Paga bruto /000 lekë	Nr. Pun	fakt	Paga bruto /000 lekë
1	Janar	744	594	45051	744	603	44826	744	587	44493	744	586	44943
2	Shkurt	744	598	45323	744	602	44917	744	585	44619	744	586	44510
3	Mars	744	601	46221	744	607	46069	744	585	44421	744	582	46322
4	Prill	744	598	45965	744	605	44969	744	586	44566	744	583	54304
5	Maj	744	596	45546	744	602	44483	744	584	44403	744	585	50612
6	Qershor	744	595	45470	744	595	44658	744	586	44102	744	585	50080
7	Korrik	744	594	43842	744	601	47353	744	585	46520	744	588	50242
8	Gusht	744	595	43560	744	600	44849	744	582	43902	744	586	50334
9	Shtator	744	591	43705	744	600	46022	744	581	46367	744	0	0
10	Tetor	744	592	44700	744	597	44020	744	583	44665	744	0	0
11	Nëntor	744	601	45090	744	593	43774	744	587	45000	744	0	0
12	Dhjetor	744	599	45062	744	590	47072	744	587	48439	744	0	0
	Shuma			539539			543019			541499			391352

(Burimi i Informacionit është Drejtoria Ekonomike dhe institucionet e varësisë)

UPT për periudhën 05.05.2015 e në vijim, ka funksionuar me strukturën organike të miratuar në Këshillin Administrativ me vendimin nr. 2, datë 05.05.2015 “Për miratimin e strukturës dhe numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet”. Krijimi i drejtorive si Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike Drejtoria e Investimeve dhe Mirëmbajtjes nuk janë organizuar në përputhje me kërkesat e Vendimit nr.474, datë 16.6.2011, pika 21 ku citohet: “*Një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë të drejtuar nga një shef ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës*”. Për periudhën 05.05.2015 e në vijim, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ka në përbërje 2 punonjës (1 drejtor + 1 specialist), Drejtoria Juridike 3 punonjës (1 drejtor + 1 përgjegjës sektori + 1specialist), Drejtoria Ekonomike 4 punonjës (1 drejtor + 2 specialist +1 magazinjer), Drejtoria e investimeve dhe mirëmbajtjes 2 punonjës (1 drejtor + 1 përgjegjës sektori)

Sektori i Auditit të Brendshëm si njësi organizative e veçantë, ka në përbërje 1 punonjës, në pozicionin e përgjegjës të sektorit. Ky sektor ka funksionuar në kundërshtim me kërkesat e Vendimit nr.474, datë 16.6.2011, “*Për përcaktimin e Standarteve të Procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike*”, pika 20 ku citohet: “*Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e vecantë kur në të, të jenë të paktën një pozicion shef sektori dhe dy vartës.....*”.

Në strukturën organizative të Rektoratit të UPT-së, Drejtoria e Kurikulave, Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënjeve me Jashtë, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Sektori i Marrëdhënjëve me Jashtë drejtohen nga personel akademik, të cilët përvec pagesës për mësimdhënie kanë përfituar pagesë suplementare dy paga mujore për çdo vit kalendarik, në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” pika 16, ku citohet “Personeli akademik, me kohë të plotë apo të pjesshme, nuk mund të ushtrojë asnjë funksion administrimi në institucionin e arsimit të lartë ku është punësuar, me përjashtim të zgjedhjes anëtar në Bordin e Administrimit”. Po kështu edhe specialisti i Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënjëve me Jashtë përvec pagesës për mësimdhënie ka përfituar pagesë suplementare dy paga mujore për çdo vit kalendarik, në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”.

- Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, realizimi i fondit të pagave dhe krahasimi me vitet e kaluara

Të gjithë punonjësit janë pjesë e strukturës së institucionit. Është respektuar struktura dhe nivelet e pagave sipas klasifikimit të funksioneve, duke përfshirë pagën bazë mujore dhe shtesat mbi pagë. Realizimi i fondit të pagave, sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe fondit të veçantë për UPT për periudhën objekt auditimi, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 3 Mbi realizimin e numrit të punonjësve dhe fondin e pagave

Ne lekë

Nr	VITI	Nr. Punonjsve		Fondi i pagave		% realizimit
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar	
1	2013	744+760	600+707	649632513	633948624	97.5
2	2014	744+760	599+733	667677553	652909249	97.7
3	2015	744+760	590+635	651699609	635096267	97.4
4	2016	744+760	587+603	648972125	640237570	98.6
5	9M/ 2017	744+760	586+580	672413674	444242024	66.0

Të dhënat e tabelës janë marrë nga specialisti i buxhetit dhe përpunuar nga audituesi

Nga sa më lart rezulton se, për vitin 2013 fondi i pagave është realizuar në masën 97.5%, për vitin 2014 në masën 97.7%, për vitin 2015 në masën 97.4%, për vitin 2016 në masën 98.6% dhe për tetë mujorin e vitit 2017 në masën 66% e planifikimit vjetor. Realizimi i fondit të pagave në vlerat e mësipërme ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të numrit të punonjësve, pasi për çdo vit kalendarik numri i punonjësve të institucionit në krahasim me organikën e miratuar në Këshillin e Administrimit është më i vogël. Sigurimet shoqërore për vitin 2014 janë realizuar në masën 97.9% ndërsa për vitin 2015 në masën 98.6%, për vitin 2016 në masën 96.5% dhe për tetë mujorin e vitit 2017 në vlerën 67.7% ,

- Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi etj.

Fondi i veçantë, është përdorur në zbatim të VKM nr. 369, datë 13.06.2007 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar me VKM nr. 929, datë 17.11.2010 dhe VKM nr. 826, datë 05.12.2011, duke u përdorur pjesërisht, kryesisht për raste të veçanta si, për sëmundje rezulton se janë kryer pagesa në vlerën 300,000 lekë, për dalje në pension, rezulton se janë kryer pagesa në vlerën 4,879,359 lekë, për fatkeqësi në familje në vlerën 804,800 lekë si dhe për aktivitete në vlerën 713,229 lekë.

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE
REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK**

Ky fond është transferuar nga fondi i pagave me miratimin e Degës së thesarit Tiranë me shkresat nr. 279/1, datë 21.03.2014; nr. 279/2, datë 16.04.2014; nr. 1077/2, datë 18.09.2014; 1553, datë 21.11.2014; 99/5, datë 17.03.2015; nr. 227, datë 09.02.2016. Fondi i veçantë, nuk është përdorur për shpërblimin e punonjësve në fund të viti ushtrimor. Me hollësisht të dhënat paraqiten në tabelën nr.4 dhe 5.

Mbi realizimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi

Tabela nr.4 Në lekë

nr.	EMERTIMI	Viti 2014			Viti 2015		
		Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%
1	Pagat (600)	667677553	652909249	97.7	651699609	635096267	97.4
2	Sig. Shoqërore (601)	89000000	87141201	97.9	89000000	87819918	98.6
3	Fondi i vecantë	2754447	2724677	98.9	2218391	2218391	100
3/a	Bonus karburanti	0	0	0	0	0	0
3/b	Shpërblim për punë të mirë	0	0	0	0	0	0
3/c	Shpërblim në fund të vitit	0	0	0	0	0	0
3/d	Për sëmundje	0	0	0	200000	200000	100
3/e	Për fatkeqësi	150000	150000	100	240000	240000	100
3/f	Për pension	210447	2101447	100	1688391	1688391	100
3/g	Për aktivitete	503000	473230	94	90000	90000	100

Tabela nr. 5

Në lekë

nr.	EMERTIMI	Viti 2016			Viti 2017		
		Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%
1	Pagat (600)	648972125	640237570	98.6	672413674	444242024	66.1
2	Sig. Shoqërore (601)	91000000	87849594	96.5	91000000	61696637	67.7
3	Fondi i vecantë	1027875	877874	85.4	1077326	876446	81.3
3/a	Bonus karburanti	0	0	0	0	0	0
3/b	Shpërblim për punë të mirë	0	0	0	0	0	0
3/c	Shpërblim në fund të vitit	0	0	0	0	0	
3/d	Për sëmundje	50000	50000	100	50000	50000	100
3/e	Për fatkeqësi	316600	208600	65.9	266200	206200	77.4
3/f	Për pension	469275	469275	100	761126	620246	81.4
3/g	Për aktivitete	192000	149999	78.1	0	0	0

- Respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.

Nga auditimi i kryer me zgjedhje, për respektimin e dispozitave ligjore për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, rezultoi se për periudhën objekt kontrolli janë zbatuar dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë konkretisht ligji nr.7703, dt 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar, ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga auditimi u konstatua përputhshmëri midis vlerës në total të kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

- Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjëve.

Pagat e stafit akademik të UPT-së janë paguar bazuar në nenin 47 pika 5, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, në VKM- nr.748, datë 11.06.2009, ndryshuar me VKM-në nr.694 datë 18.08.2010, VKM-në nr.550, datë 11.08.2011 dhe bazuar në Udhëzimin nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, i cili përcakton në mënyrë specifike veprimtarinë në të cilat përfshihet personeli akademik, menyrën e organizimit të kohës vjetore të punës dhe normimin e ngarkesës mësimore. Paga e punonjësve ndihmës të administratës bëhet në përputhje me VKM-në nr.717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunëve të disa institucioneve buxhetore”, ndryshuar me VKM-në nr. 621 datë 6.7.2010, si dhe me Vendimet e Këshillit të Ministrave për rritjen e pagave të kësaj kategorie punonjësish respektivisht çdo vit.

Nga auditimi në Administratën e Rektoratit dhe me përzgjedhje të disa institucioneve të varësisë, rezultoi se për periudhën objekt auditimi nga Drejtoritë e Financës janë hapur librat e pagave me azhurnimet përkatëse për çdo punonjës nga pagat mujore të përfituara në formatin që kërkon ligji në të gjitha institucionet e varësisë. Librat e pagave të Rektoratit, FTI, FIE, FIM, Biblotekës Shkencore, kishin të evidentuar pagën bazë, shtesat për funksion, pagën mbi të cilën llogaritet tatami mbi të ardhurat, pagën mbi të cilën llogaritet kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetsore dhe ndalesat. Nga auditimi rezultoi se gjithë personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm (me kontratë të përkohshme) kryen veprimtari mësimore të konvertuara në orë mësimore. Për personelin akademik orët e mësimit për mbingarkesën mësimore deri në 30 % pasi është plotësuar i gjithë detyrimi vjetorë i punës, janë dhënë nga titullari i institucionit në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e Personeli Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar. Për pagesën e orëve të mbingarkesës mësimore në masën mbi 30 %, pasi është plotësuar i gjithë detyrimi vjetor i punës i është kërkuar miratimi MASH-it dhe me shkresat e mëposhtme i është aprovuar deri në masën 70 % me shkresat, si më poshtë:

-shkresa nr.1664/8 prot,të datës 11.12.2014“Për miratimin e pagesës së orëve mësimore mbi 30 % për vitin akademik 2013-2014”, UPT-ja i kërkon Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës miratimin e orëve mësimore të realizuara për mësimdhënien mbi 30 % për vitin akademik 2013-2014 dhe në përgjigje të saj me shkresën nr. 9252/1 prot të datës 17.12.2014, MASH miraton pagësën e orëve mësimore për personelin akademik me kohë të plotë në masën mbi 30% deri në 70 % për vitin akademik 2013-2014.

-shkresa nr.1117/2 prot, të datës 09.12.2015 “Për miratimin e pagesës së orëve mësimore mbi 30 % për vitin akademik 2014-2015” UPT i kërkon MASH-it miratimin e orëve mësimore të realizuara për mësimdhënien mbi 30 % për vitin akademik 2014-2015 dhe në përgjigje të saj me shkresën nr.10475/1 prot, të datës 16.12.2015, Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton pagësën e orëve mësimore për personelin akademik me kohë të plotë në masën mbi 30% deri në 70 % për vitin akademik 2014-2015.

Kjo procedurë e ndjekur nga Titullari i Rektoratit është në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.20 datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e Personeli Akademik në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” i ndryshur, neni 20, pika 2 “Tejkalimi i paguar mbi 30% i mësimdhënies së normuar vjetore mund të bëhet vetëm me miratimi nga Ministria e Arsimit.”

-Për vitin akademik 2016-2017, me vendimin nr.14, datë 14.12.2016 “Për miratimin e masës së pagesës për orët mësimore mbi normë dhe rishikim të fondit të pagave” të Bordit të Administrimit, është miratuar masa e pagesës për orët mësimore mbi normë. Kjo procedurë e ndjekur është në përputhje me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2016 si dhe në rregulloren e brendshme miratuar me vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit.

UPT për periudhën objekt auditimi ka kryer pagesa për punë mbi kohën normale të punës, për Sekretaritë Mësimore në njësitë vartëse, për periudhën e regjistrimit të studentëve në vitet akademike përkatës, në zbatim të VKM nr. 463, datë 16.06.2011 “Disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 511, datë 24.10.2002, për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar, të udhëzimit nr. 16, datë 27.07.2011 “Mbi zbatimin e VKM nr. 463, datë 16.06.2011, të shkresave përkatëse të njesive të vartësisë drejtuar drejtorisë ekonomike “Mbi punën e kryer mbi kohën normale të sekretarive mësimore” (bashkëngjitur grafiku i punës) si dhe shkresat përkatëse nga MF për miratim të pagesave. Vlera totale e paguar është 822,892 lekë.

Mbi pagesat e kryera mbi kohën normale të punës, për sekretaritë mësimore në lekë

Njësia vartëse	Viti 2015	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
FIE	-	-	-	138,600
FIM	-	-	-	73,812
FAU	-	-	-	134,892
FIMIF	-	-	-	74,304
FTI	-	-	104,263	-
FGJM	-	-	100,858	-
FIN	-	-	151,829	-
IGJEUM	44,334	-	-	-
TOTALI	44,334	-	356,950	421,608

Në lidhje me punësimin e personelit akademik u audituan me përzgjedhje procedura mbi punësimin e lekorëve në FAU nga ku rezultoi se, janë zbatuar kriteret e punësimit të personelit akademik të hartuar dhe miratuar nga Rektorati i UPT-së në Tetor 2010, procedurë e cila nuk është rishikuar pas ndryshimeve që ka pësuar LAL.

Në lidhje me plotësimin dhe ruajtjen e dosjeve të nëpunësve të institucionit, u konstatua se për çdo punonjës ka dosje të veçantë të plotësuar me dokumentacionin e duhur konform legjislacionit në fuqi si Cv, diplome, listë notash, certifikatë personale, rekomandim, raport mjekësor, librezë pune, certifikatë të gjendjes gjyqësore, vlerësimi etj.

Regjistri i personelit është plotësuar sipas rubrikave të tij për të gjithë punonjësit ku janë regjistruar të gjitha emërimet, lëvizjet, largimet si për punonjësit në organikë dhe për punonjësit e emëruar me kontratë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Dosjet e materialeve mbi procedurat e punësimit të personelit akademik për periudhën objekt auditimi janë arkivuar, por duke mos përmbyshur plotësisht kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe të manualit mbi arkivimin e dokumentave. Dosjet nuk janë administruar me indeks të vecantë, sipas kërkesave të Kapitullit V, Formatit Standard nr. 17, ku evidentohen shkresat e fashikujt në vecanti si dhe pasqyrimi kronologjik i numrit të fletëve në dosje.

4. Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave që realizon institucioni.

-Burimet e krijimit të të ardhurave.

-Mbledhja e të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore.

-Përdorimi i të ardhurave nga institucioni.

Auditimi mbi krijimin dhe përdorimin e të ardhurave që realizon institucioni u krye mbi bazën e të ardhurave që kanë si burim krijimi tarifat e shkollimit dhe të regjistrimit të studentëve konform dispozitave ligjore në fuqi që burojnë nga ligji nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, të cilat përbëhen nga:

Tarifat e shkollimit,

tarifat e regjistrimit dhe tarifat e konkurseve të regjistrimit në shkollën e lartë të cilat miratohen me VKM për çdo vit akademik

të ardhurat nga trajnimet, kualifikimet,

dhënia e ambienteve me qirabe cila realizohet sipas kontratave specifike të lidhura

tarifa për shërbime të ndryshme për subjekte private dhe të huaja si vërtetime, programe në shqip dhe në gjuhë të huaja, listë notash, diploma studenti etj. në përshtatje me natyrën e Universiteti Politeknik të Tiranës, të cilat krijohen dhe administrohen sipas VKM nr. 432, datë 28.6.2006.

Tarifat nga oponencat e Inxhinerisë së ndërtimit dhe Arkitekturës.

Të ardhurat e realizuara përdoren 100 % nga Universiteti Politeknik Tiranë, të cilat detajohen dhe miratohen nga Bordi i Administrimit, për financimin e zërave të shpenzimeve sipas programit për vitin 2016 paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Nr.	EMERTIMI	Fonde nga Granti		Fonde nga të Ardhurat		Totali i Fondeve		Në %
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	
1	Paga, art. (600)	516,784	516,784	132,188	123,453	648,972	640,237	99
2	Sigurimet shoq. dhe shëndets. art.(601)	88,000	87,849	3,000	-	91,000	87,849	97
3	Shpenzime operative, art. (602)	13,192	13,150	223,500	202,561	236,692	215,711	91
4	Shpenzime transferata me jashte, art. (605)	-	-	4,000	2,430	4,000	2,430	61
5	Bursa per studentet, art. (606)	40,836	24,357	1,600	383	42,436	24,740	58
6	Investime, art. (230)	-	-	17,300	14,509	17,300	14,509	84
7	Investime , art. (231)	42,670	42,646	172,538	143,925	215,208	186,571	87
TOTAL BUXHETI		701,482	684,786	554,126	487,261	1,255,608	1,172,047	93



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Nga tabela e mësipërme rezulton se të ardhurat për vitin 2016 nga 554,126 tëprogramuara janë janë përdorur për financimin e shpenzimeve në masën prej 487,261 mijë lekë ose 88 %.

Në një analizë më të detajuar, realizimi i buxhetit për vitin 2016 sipas zërave paraqitet si vijon:

Realizimi i të ardhurave të kushtëzuara për vitin 2016.

Të ardhurat dytësore të arkëtuara ishin në masën 99.4 % të shumës së planifikuar për vitin 2016, ose u realizuan me pak se planifikimi në shumën prej **2.204** mije lekë.

Pasqyra e parashikimit të krijimit të të ardhurave të dytësore dhe realizimi i tyre sipas njësive të Universitetit Politeknik për vitin 2016, paraqiten në tabelën nr.2.

Fakulteti	Numri studenteve gjithëj	Numri i studenteve që kane paguar tarifen për vitin	Shuma gjithëj e arketuar në 000/ lek	Numri i studenteve që nuk kane paguar tarifen për vitin	Numri i studenteve Te perjashtuar nga pagesa e tarifës së shkollimit	Numri i studenteve që nuk kane paguar tarifen e shkollimit	Shuma gjithëj e pa arketuar në 000/ lekë
FTI	1659	1004	45050	655	53	602	14806
FIMIF	964	563	19169	401	34	367	2851
FGJM	2555	1358	40048	1197	48	1149	25019
FIM	2956	1404	51132	1552	54	1498	38555
FIN	2709	1850	74264	847	95	790	21982
FIE	1766	1092	39489	674	60	614	17274
FAU	1430	1231	47114	199	53	146	1854
Gjithëj	14,039	8502	316266	5525	397	5,166	122,341

Nga tabela e mësipërme konstatohet se, përgjithësisht njësitet paraqiten me mosrealizim të të ardhurave. Konstatohet se nga 14,039 studentë të regjistruar nuk kanë paguar tarifen e regjstrimit 5,166 studentë në shumën prej 122,341 mijë lekë. Duke sjellë si pasojë që të ardhurat nga 522,236 mijëlekë të realizohen në masën prej 316,266 lekë, ose janë realizuar në masën prej 62 %

Mospagesa e mësipërme vjen si pasojë e studentëve ngelës të paregjistruar në vitin pasardhës për arsye të ndryshme, e për rrjedhojë përbën një burim potencial të ardhurash që varet nga koha në të cilën do të paraqiten për regjistrim dhe dhenie provimesh.

Nëtotal të ardhurat e paresalizuara paraqKy mosrealizim ka ardhur nga mosarkëtimi i tarifës së shkollimit të studenteve të vitit të parë të ciklit të dytë të studimeve për vitin 2016-2017. Pë këtë vit akademik është parashikuar që 30% e kësaj tarife të arkëtohej në periudhën Tetor –Dhjetor 2016. Nga të dhënat rezulton se Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ka realizuar vetëm 70% të të ardhurave të planifikuara, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave ka realizuar vetëm 75

**KONTROLI I LARTË I SHETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE
REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK**

% të të ardhurave të planifikuara , Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierise Fizike 80 % të të ardhurave të planifikuara dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka realizuar 95% të të ardhurave.

Me tejkalim të të ardhurave, paraqitet Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimi, i cili ka realizuar 118% të të ardhurave të planifikuara.

Tejkalimi ka ardhur nga arkëtimi i dy oponencave teknike të ndërtimit me porositës T..... Vetëm nga ky subjekt janë arkëtuar oponenca teknike në shumën **66.798 mijë lekë nga 31.550 mijë lekë** të planifikuara të arkëtuar.

Me tejkalim të të ardhurave paraqitet edhe Rektorati. Në këtë rritje kanë ndikuar të ardhurat e arkëtuar nga dy projekte me financim të huaj, projekti NOVIWAM dhe projekti TENECOPORT.

Për vitin 2017 planifikimi dhe pjesëmarrja e të ardhurave në shpenzimet e universitetit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000 lekë

Nr.	EMERTIMI	Fonde nga Granti		Fonde nga të Ardhurat		Totali i Fondeve	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Paga, art. (600)	547,015	-	126,476	-	673,491	-
2	Sigurimet shoq. dhe shëndets., art.(601)	87,000	-	4,000	-	91,000	-
3	Shpenzime operative, art. (602)	10,000	-	199,020	-	209,020	-
4	Shpenzime transferata me jashtë, art. (605)	-	-	3,800	-	3,800	-
5	Shpenzime transferata të brendshme, art. (606)	-	-	2,000	-	2,000	-
6	Bursa për studentet, art. (606)	45,000	-	-	-	45,000	-
7	Investime, art. (230)	-	-	14,500	-	14,500	-
8	Investime nga të ardhurat, art. (231)	-	-	183,960	-	183,960	-
9	Investime nga buxheti (I pritshëm) art. (231)	-	-	-	-	-	-
TOTAL BUXHETI I UPT		689,015	-	533,756	-	1,222,771	-

5. Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Nga auditimi i kryer u konstatua se shpenzimet e kryera nëpërmjet veprimeve të bankës janë mbajtur dhe dokumentuar përputhje me aktet ligjore e nënligjore, si dhe konform planit unik kontabël, regjistrimet e veprimeve janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe në llogaritë përkatëse të shpenzimeve. Gjendja e llogarive bankare rakordon me ekstraktin e bankës në fund të çdo muaji.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Të gjithë urdhër shpenzimet janë plotësuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Financave nr.6153, datë 27.05.2009 dhe mbështeten në dokumentet ligjorë justifikues.

Nga auditimi i shpenzimeve të kryera nëpërmjet veprimeve të bankës, u konstatua si mëposhtë:

1.Me urdhër shpenzimin nr. 790, date 14.06.2016, është likuiduar Agjencia e Akreditimit, në shumën prej 1,965,000 lekë me objekt “Vlerësimin e akreditimit të Universitetit Politeknik Tiranë”. Dokumenti justifikues i paraqitur nga Agjencia e Akreditimit për kryerjen e pagesës me emërtimin “Faturë arkëtimi” nr. 15, datë 03.06.2016, është një fletë formati A4, nënshkruar nga përgjegjësj e finances së Agjencisë së Akreditimit dhe nga Drejtore Ekonomike e UPT në cilësinë e blerësit. Likuidimi i kryer në favor të Agjencisë së Akreditimit mbi bazën e kësaj fature është në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 101 “Përmbajtja e faturës”, pasi fatura e paraqitur nuk ka elementët e mëposhtëm:

a.Numrin serial që e identifikon faturën në mënyrë unike; numrin e identifikimit të TVSH-së të personit të tatueshëm që kryen furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, sipas përcaktimit të nenit 92, të këtij ligji;

b. Numrin e identifikimit të TVSH-së të blerësit, sipas përcaktimit të nenit 92, të këtij ligji, kur ai është person i tatueshëm për furnizime brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

c.emrin, adresën dhe NIPT-in e shitësit.

Gjithashtu ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 66 “Faturimi” pika 4 “Formati i faturës tatimore dhe procedurat e administrimit të tyre”.

Nga auditimi, konstatohet se likuidimi i kryer në favor të Agjencisë së Akreditimit është në kundërshtim me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 5 “Roli i shtetit në arsimin e lartë”, pika 2 “Shteti, nëpërmjet organeve dhe strukturave përgjegjëse të tij, (Agjencia e Akreditimit) ka përgjegjësi dhe detyrim si më poshtë:

a. garanton autonominë dhe lirinë akademike të institucioneve të arsimit të lartë;

b. është përgjegjës për përcaktimin dhe monitorimin e standardeve në arsimin e lartë për hapjen dhe akreditimin e institucioneve e të programeve të studimit që ato ofrojnë;

c. vlerëson cilësinë dhe funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë, përmes agjencive të tij, atyre të pavarura ose të huaja, duke bërë publik procesin dhe rezultatet e tij.

Për Akreditimin e UPT, sipas urdhrit nr.1564,date 28.12.2016 nënshkruar nga administratori është ngritur Grupi i Vetvlerësimit individual (GVI) me 28 punonjës të cilët kanë funksione përdagogjike dhe për kryerjen e vetvlerësimit Individual me objekt vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, janë paguar sipas urdhër shpenzimeve nr. 1792, dhe 1793, datë 30.12.2016 në vlerën prej **1,507,886 lekë**. Kjo pagesë është e pajustificuar dhe e paargumentuar pasi vetvlerësimi duhet të bëhet nga “Drejtoria e e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” e cila sipas organikës së miratuar ka për objekt vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Vlerësimi për cilësinë e mësimdhënies nga vetë stafi akademik përbën konflikt interesi, pasi stafi pedagogjik nuk mund të vlerësoje vetvehten, e për rrjedhojë vlera e përfituar nga grupi i vetvlerësimit në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

shumën prej 1,507,886 lekë është e pargumentuar dhe e pajustificuar, për faktin se agjencia e akreditimit ka kryer detyrat funksionale për akreditimin konform ligjit për Arsimin e Lartë. Duhet theksuar se vetvlerësimi individual për akreditimin e këtij Universiteti duhet të kryhej nga “Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. Kjo drejtori, sipas organikës së miratuar, nuk ka ushtruar kompetencat e saj ligjore për mungesë të stafit dhe mosplotësim të organikës e cila nga 8 punonjës në organikë funksionon me 3 punonjës.

U shqyrtua observacioni i paraqitur me shkresën nr. 1361, date 06.11.2017, me të cilën sqarohet se kjo pagesë është kryer në bazë të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave nr 29/1, date 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryhen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë” pika 2, a2, ku është përcaktuar tarifa për me 3-5 fakultete në shumën prej 1,965,000 lekë.

Observacioni i paraqitur për pagesën e Agjencisë së Akreditimit merret në konsideratë, megjithatë dduhet theksuar se për kryerjen e akreditimit, krahas kësaj pagese është kryer edhe një pagesë tjerë me urdhrin nr.1564, datë 28.12.2016 nënshkruar nga administratori për ngritjen e Grupit të Vetëvlerësimit individual (GVI) me 28 punonjës të cilët kanë funksione përdagogjike dhe për kryerjen e vetëvlerësimit individual me objekt vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, janë paguar sipas urdhër shpenzimeve nr. 1792, dhe 1793, datë 30.12.2016 në vlerën prej **1,507,886 lekë**.

Urdhri nga Administratori është mbështetur në bazë të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i shfuqizuar, si dhe në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, nr.29/1, datë 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryhen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”. Ky veprim financiar është realizuar në zbatim të ligjit të mëparshëm i cili aktualisht është shfuqizuar me daljen e ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH” datë 22.07.2015, fakt që tregon se kjo pagesë është mbështetur në një udhëzim të nxjerrë mbi bazën e një ligji të shfuqizuar.

2.Me urdhër shpenzimet nr. 207, 208, 209, 213, datë 22.02.2017, janë paguar anëtarët e Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik Tiranë respektivisht; ish Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në cilësinë Kryetar Bordi me tarifën 17,000 lekë për çdo mbledhje dhe anëtarët, me 15,000 lekë për çdo mbledhje.

Pagesa e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 9584, date 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” dhe VKM nr. 418, date 27.06.2012 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore”, lidhja nr. 1 “Arsimi i Lartë Publik” ku është përcaktuar se, tarifat e shpërblimit për pjesëmarrje në borde, këshilla, është 8,000 lekë si për kryetarin dhe anëtarët e tjerë të bordit.

Nga auditimi konstatohet se, Senati i Universitetit Politeknik të Tiranës, me vendimin nr. 4, datë 27.01.2017, në pikën 1, të këtij vendimi ka orientuar masën e shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Administrimit, respektivisht për kryetarin në shumën prej 17,000 lekë dhe për 6 anëtarët e tjerë masën prej 15,000 lekë. Në pikën 2 të vendimit të mësipërm, senati ka kërkuar që tarifat e reja të miratohen nga Bordi i Administrimit të UPT, në mbështetje të nenit 3 pika 3 germa “c” e ligjit 80/2015 ku përcaktohen “Rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Zgjedhja e këtij argument është e paargumentuar për këtë pagesë, pasi në këtë nen përcaktohen vetëm rregullat e brendshme të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, dhe jo mënyra apo tarifat për përcaktimin e shpërblimit të Bordit apo komisioneve.

Bordi i Administrimit me vendimin nr. 18, date 03.02.2017 miraton masën e shpërblimit respektivisht për kryetarin në masën 17,000 lekë dhe anëtarët në masën 15,000 lekë për çdo mbledhje.

Miratimi i tarifave të shpërblimit të anëtarëve të tij nga Bordi i Administrimit, është jo vetëm në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.02.2012, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore” lidhja nr. 1, por përben edhe konflikti interesi, pasi Bordi i Administrimit nuk ka tagër ligjorë të përcaktojë tarifën e shpërblimit për veten e vet, pasi nënenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar është përcaktuar:

“Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesat që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga, të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyresë”.

Për sa më lart anëtarët e Bordit të Administrimit kanë përfituar padrejtësisht më tepër shumë prej 280,281 lekë.

U shqyrtuan sqarimet e paraqitura nga Bordi i Administrimit me shkresën nr. 1361/10, datë 14.11.2017, me të cilën pretendohet se, “VKM nr. 418, datë 27.06.2012, cakton pagat e Këshillit Administrativ, sipas ligjit të vjetër, ndërsa me ligjin e ri Këshilli Administrativ ndryshon dhe emërohet Bord Administrimi. Bordi i Administrimit është organ i ri kolegjal, i krijuar me vendimin nr. 1, datë 21.07.2016 dhe si i tillë nuk parashikohet në aktin nënligjor cituar më sipër, ndaj dhe referenca në këtë akt nënligjor është e pabazuar.

Në kuadër të autonomisë financiare është e qartë se ligji i ri ka parashikuar së është në tagrin e IAL-së të përcaktojë masën e shpërblimit të personelit të tij, në këtë rast të anëtarëve të Bordit të Administrimit, të cilët sipas nenit 48, pika 1, janë punësuar me kohë të pjesëshme”.

Në lidhje me Komentet e Bordit të Administrimit, sqarojmë se:

VKM nr. 418, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore”, lidhja nr. 1 “Arsimi i Lartë Publik”, nuk ka dalë në zbatim të ligjit nr. 9741, datë 11.05.2007 “Për arsimin e lartë në RSH”, siç pretendohet nga Bordi i Administrimit, por ka dalë në funksion të ligjit 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, i cili aktualisht nuk është shfuqizuar. Po kështu pretenimi se Këshilli i Administrimit me ligjin e ri 80/2015 ka ndryshuar emërtimin në Bord Administrimi dhe në këto kushte nuk mund të zbatohet VKM nr. 418, datë 27.06.2012, nuk është i drejtë pasi edhe në VKM nr. 418, datë 27.06.2012 qysh në emërtimin e këtij vendimi, krahas pagesave për këshillat, përcakohen edhe pagesat për Bordet.

Pë sa më lart pretenidimi juaj është i pabazuar.

Gjithashtu sqarojmë se “Autonomia e përcaktuar në ligjin e ri nuk mund të zbatohet plotësisht, pasi UPT, duke qënë se përfiton fonde buxhetore rreth 70 % të nevojave të saj nuk mund të caktojë vetë pagat pa u mbështetur në dispozita të tjera ligjore, të cilat deri sot nuk kanë dalë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

për rrjedhojë është krijuar vakum ligjor në interpertimin dhe funksionimin e autonomisë së UPT.

3. Me urdhër shpenzimin nr. 741, datë 31.05.2016 shumën prej 185,541 lekë është likuiduar shoqëria private “E” në shumën prej 185,741 lekë, sipas shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 5232/1, datë 20.05.2016 nënshkruar nga ish sekretari i përgjithshëm me objekt: “Organizimin e panairit pranë City Park për njohjen e kriterëve të pranimit të maturantëve në vitin akademik 2016-2017”.

Shkresa e mësipërme u është dërguar për njohje dhe zbatim nga 14 universitet shtetërore, për të lidhur kontratës me subjektin “E” me objekt “Organizimin e panairit pranë City Park për njohjen e kriterëve të pranimit të maturantëve në vitin akademik 2016-2017”.

Nga auditimi konstatohet se, Universiteti Politeknik ka likuiduar në favor të subjektit “E” shumën prej 185,741 lekë, pa procedurë prokurimi, në kundërshtim me ligjin “Për prokurimin publik” dhe pa kërkuar informacion nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për tarifën prej 70 Euro/m², pagesë e cila përbën përdorim pa efektivitet të fondeve publike, pasi për kryerjen e këtij aktiviteti duhej të përdoreheshin ambientet e Universitetit apo për publikimin e kriterëve të pranimit të shfrytëzohej edhe faqja zyrtare e UPT, apo mënyra të tjera komunikimi me medien e shkruar apo elektronike.

4. Bordi i Administrimit me urdhrin nr. 5, datë 01.11.2016 ka vendosur “Hapjen e degës së Fakultetit të arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU) në qytetin e Korçës, për zhvillimin e masterit profesional në “Restaurimin e monumenteve të kulturës”, me të cilin ka miratuar edhe efektet financiare të degës së këtij fakulteti.

Bashkëlidhur urdhrin të mësipërm është Programi Financiar, në të cilin janë përcaktuar tarifat e regjistrimit dhe tarifë shkollimit në shumën prej 102,500 lekë. Sipas programit financiar që shoqëron këtë vendim janë parashikuar të regjistrohen 50 studentë nga të cilët do krijohen të ardhura në shumën prej 5,125,000 lekë respektivisht (tarife regjistrimi 2,500 dhe tarifë shkollimi 100,000 lekë).

Sipas relacionit që shoqëron vendimin vendimit të bordit, Universiteti i Arkitekturës do të mbulojë:

- shpenzimet udhëtim e dieta në shumën prej 2,626,500 lekë,
- shpërblym për orë mësimore për akademikë të jashtëm 2,181,1000 lekë
- paga për 18 profesorë të brendshëm në shumën prej 1,500,000 lekë
- shpenzime personeli 5,760,000 lekë.

Bashkia Korçë merr përsipër dhe do financojë shpenzime të tjera operative dhe investime në shumën prej 6,000,000 lekë.

Nga verifikimi i kryer konstatohet se nga 50 studentë të parashikuar janë regjistruar 37 studentë ose 13 studentë më pak se parashikimi, fakt që tregon se kanë munguar të dhënat mbi numrin e studentëve që ka zona dhe që dëshirojnë të ndjekin studimet për master.

Nga auditimi, konstatohet se në fakt janë regjistruar 37 studentë dhe të ardhurat janë realizuar në shumën prej 3,792,500 lekë, ndërsa shpenzimet deri në përfundimin e tij janë parashikuar në vlerën prej 12,307,000 lekë.

Duke u nisur nga fakti që nga të ardhurat e realizuara mbulohe vetëm 30 % e shpenzimeve do ishte me efektive që hapja e kësaj dege të realizohej pranë Fakultetit të Arkitekturës në



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

mbështetje të nenit 1 të ligjit 80/2015 pika c, me qëllim “Ofrimin e mundësive të barabarta për të përfitur nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës”.

Në nenin 29 të ligjit nr. 80/2015, pika 3 përcaktohet se:

“Kriteret dhe procedurat për hapjen e degëve të institucioneve të arsimit të lartë, vendase dhe të huaja, të akredituara në vendin e origjinës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Në kushtet e mungesës së Vendimit të Këshillit të Ministrave, apo të dispozitave nënligjore, çelja e kësaj dege të re nuk është mbështetur në nenin 29, të ligjit 89/2015.

Nga verifikimi i kronologjisë së hartimit dhe miratimit të dokumentacionit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës deri te Bordi i Administrimit, konstatohet se:

Këshilli i Akreditimit me vendimin 145, date 31.03.2016 “Mbi hapjen e programit të ciklit të dytë master profesional në “Restaurim Monumentesh Kulturore” të Universitetit politeknik të Tiranës, është bazuar në ligjin nr.9741, date 21.03.2016, i cili në këtë periudhë është i shfuqizuar dhe jo në zbatim të ligjit të ri nr. 80/2015, datë 22.07.2015. Në lidhje me vendimin e Këshillit të Akreditimit ka vendosur se programi mësimor përmbush standardet e cilësisë për këtë cikël program studimi dhe në përfundim vendos, “që të hapet kjo degë”.

Ministri me urdhrin nr. 191, date 22.04.2016 autorizon hapjen e kësaj dege pasi programi mësimor t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, ndërkohë që sipas vendimit të Këshillit të Akreditimit, procesi i akreditimit ka përfunduar rreth 1 muaj para daljes së urdhrin të ministrit.

Në vendimin e Këshillit të Akreditimit është përcaktuar që forma e studimit do të jetë më kohe të plotë, pra mësimi do të zhvillohet në ditët zyrtare të punës.

Nga verifikimi i kryer në Universitetin e Arkitekturës konstatohet se, stafi pedagogjik i kësaj dege universitare ka përfitur “shpenzime udhëtim e dieta” edhe gjatë ditëve të shtuna dhe të diela në kundërshtim me VKM nr. 329, date 20.04.2016 “Për disa ndryshime në VKM nr.997, date 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës Brenda vendit”, Kreu I, ku përcaktohet se, punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme të cilët trajtohen financiarisht për shërbim jashtë qendrës së banimit vetëm gjatë ditëve zyrtare të punës. Trajtimi financiar për shërbimet udhëtim e dieta për ditët e shtuna dhe të diela në shumën prej 102,500 lekë e cila përbën pagesa në kundërshtim me vendimin e mësipërm.

Gjithashtu duhet theksuar se, vendimi i Bordit të Administrimit duhej të kishte përcaktuar edhe mënyrat për verifikimin e ecuerisë akademike të kësaj dege të re me qëllim respektimin e programit mësimor konform vendimit të Bordit të Administrimit që mësimi të zhvillohet me kohe të plotë.

5. Nga auditimi i shpenzimeve për periudhën objekt auditimi, konstatohen se janë zhvilluar edhe procedura prokurimi të cilat përfaqësojnë shpenzime pa efektivitet, e konkretisht:

Me urdhër shpenzimet nr. 1580, date 27.10.2014 dhe nr. 1597, date 04.12.2015 në shumën prej 918,000 lekë janë kryer pagesa në favor të shoqërisë “Pass-Programi Alternativa sociale Stimulue”, nga artikulli 602 me objekt “Trajnim të këshillit studentor në Jalë”, respektivisht nga 7 ditë për çdo vit, për mbulimin e shpenzimeve për akomodim, trajtim ushqimor dhe shpenzime transporti, për këshillat e fakulteteve vartëse të UPT. Qëllimi i kësaj shpenzimi është njohja dhe zbatimi i neneve të rregullores së këshillave të fakulteteve. Ky shpenzim konsiderohet pa afektivitet dhe të paargumentuar pasi për dy vjet rresht janë organizuar në Jalë, ndërkohë që



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

njohja dhe zbatimi i neneve të rregullores mund të bëhet gjatë vitit shkollor në ambientet e universiteteve.

Kjo kategori shpenzimi konsiderohet pa efektivitet dhe e paargumentuar, pasi njohja e rregulloreve të këshillave studentore do të ishte më efektive të bëhet gjatë vitit shkollor në ambientet e universiteteve. Gjithashtu zhvillimi i këtyre aktiviteteve në muajin Gusht në JALË, që përkon me zhvillimin e aktiviteteve rinore të disa partive politike nxit joshjen e studentëve nga partitë politike, ndërkohë që ata duhet të kenë objektiv përgatitjen cilësore dhe diplomimin e tyre. Këto veprimtari janë në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 80/2015, pika 3 ku përcaktohet se: “*Institucionet e arsimit të lartë ruajnë neutralitet politik*”.

- Inventarizimi i pronës shtetërore.

Inventarizimi i pronës shtetërore është kryer konform ligjit 10296, datë 10.07.2010 dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Inventarizimi është kryer me urdhrin e titullrit nr. 127, 128 dhe 129 datë 28.12.2015, me objekt “Kryerjen e inventarizimit në Rektoriatin e UP Tiranë” nëpërdorim dhe gjendje nëmagazinë si dhe të gjitha kategoritë e aktiveve të institucionit. Inventarizimi ka filluar në datën 10 janar 2016 dhe ka përfunduar në datën 31.01.2016

Inventarizimi është kryer për të gjitha kategoritë e aktiveve sipas personave përgjegjës për pajisjet e zyrave dhe nëmagazinë. Në përfundim të inventarëve nuk kanë rezultuar diferenca. Llogaritë sintetike të vlerave inventariale si për aktivet dhe materiet inventar janë të kuadruara me ato analitike.

6. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin 2014,2015 dhe 2016 është bërë nëmbështetje të:

Ligjit nr.9248, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,

Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,

Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin e sistemit financiar dhe kontrollin”

VKM nr.248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njërive që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998”,

Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për Përgatitjen dhe Raportimin e Llogarive Vjetore të vitit 2006, për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njërive të Menaxhim-Zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj”,

Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 14, datë 28.12.2006”

Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të bilanceve kontabël u përqëndrua në vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi si dhe parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, përgjithësisht janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në Projekt raport.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Bilanci i rektoratit dhe përmbledhës i Institucionit përgatitet si bilanc i konsoliduar i 9 njësive shpenzuese që janë në vartësi të UPT.

Auditimi u krye në dy drejtime në afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e balanceve dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit por edhe për cdo njësi shpenzuese në përbërje të këtij institucioni, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e veprimeve të ndryshme, konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të përidhës objekt auditimi në zbatim të ligjit nr. 9936, date 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, bilanci i konsoliduar është përpiluar dhe është dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë si dhe në ish MASH. Bilancet e njësive shpenzuese (fakulteteve) janë dorëzuar në Rektoratin e UPT-së brenda afatit ligjor, pasi janë miratuar nga Dega e Thesarit.

Mbi evidentimin e mallrave dhe materialeve në magazinë, kontabilizimi i tyre, mbajtja e kartelave dhe rakordimi me zyrën e financës.

Nga auditimi dokumentacionit të kryer në magazinë për periudhën objekt auditimi rezultoi se dokumentacioni i hyrjeve dhe daljeve të mallrave dhe materialeve të magazinës është plotësuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sektori i financës ka regjistruar në ditar fletë-hyrjet dhe fletë-daljet në mënyrë kronologjike, për dokumentimin e veprimeve janë çelur kartela dyfishe dhe është bërë rakordimi me magazinën në sasi e në vlerë për çdo muaj. Të gjitha hyrjet në magazinë janë shoqëruar me dokumenta justifikuese sipas neni 6, pika 1,germa dh të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar të Kontrollit” dhe sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financës nr.30, datë 27.12.2011, daljet nga magazina janë kryer me urdhër dorëzimi., por u konstatua se jo në të gjitha rastet malli bëhej hyrje në magazinë sipas kap 2 pika 42/43 të udhëzimit nr30, datë 27.12.2011 “ Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”pasi jo në të gjitha rastet kishte qënë i pranishëm komisioni i marjes në dorëzim të mallrave te ndryshëm që bëhëshin hyrje në magazinë.Pajisjet dhe mallrat e inventarit u ishin dhënë punonjësve me kartela personale.Nga auditimi dokumentacionit të kryer në magazinë për periudhën objekt auditimi rezultoi se dokumentacioni i hyrjeve dhe daljeve të mallrave dhe materialeve të magazinës është plotësuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Auditimi mbi prokurimin e fondeve publike.

Gjatë auditimit, mbi procedurat e prokurimeve të realizuara në Institucionin e Rektoratit të Universitetit Politeknik të Tiranës(UPT), përgjatë viteve, 2014, 2015, 2016 deri në 30.09.2017, në bazë të Programit të Auditimit nr.738/1prot datë 07.08.2017, me objekt auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe institucionet e varësisë”, grupi i audituesve të KLSH-së,u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore Ligjit nr.9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.1, datë 10.01.2007, “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, VKM nr.918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, Udhëzim e APP-së nr.2 datë 27.01.2015 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik”, Udhëzimin e APP-së nr.3



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Publik i UPT-së.

Për shkak të volumit të dosjeve të tenderave dhe sidomos të, atyre me vlera të vogla u përzgjedh metoda me zgjedhje rastësore, metoda e gjurmimit të dokumentacionit si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës për procesin e prokurimit të audituar. Përqëndrimi i grupit të auditimit, është mbështetur në pikat e renditura të audituara si më poshtë:

- Hartimin dhe njoftimin e regjistrimit të prokurimit publik;
- Llogaritjen e fondit limit dhe procedurat e shpalljes së prokurimit;
- Hartimi i kërkesave për kualifikim, miratimi i dokumentave standarte të tenderit;
- Paraqitja dhe shqyrtimi i ofertave;
- Vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i ofertuesve, verifikimi në sistemin prokurimit elektronik (SPE);
- Menaxhimi i procesit të ankimit, pjesëmarrësit në proces;
- Njoftimi, hartimi dhe nënshkrimi i kontratës me operatorin fitues dhe zbatimi i saj.
- Zbatimi dhe monitorimi i kontratës.

Gjatë vitit 2014, UPT ka zhvilluar 102 procedura prokurimi me një fond limit të llogaritur si shumë të fondeve publike të UPT në vlerën rreth 89,969 mijë lekë dhe janë realizuar 101 procedura prokurimi të ndara (1 procedurë te hapur, 3 me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës, 14 kërkesë për propozim dhe 83 blerje me vlerë të vogël) ku në përfundim të tyre janë shpallur fitues operatorë ekonomikë me të cilët janë lidhur kontrata me vlerë të përgjithshme rreth 69,047 mijë leke. Nga realizimi i procedurave të prokurimit është realizuar një kursim në vlerën 20,922 mijë lekë ose 23% e fondeve publike të UPT të planifikuara për këto blerje dhe shërbime.

Gjatë vitit 2015, UPT ka zhvilluar 121 procedura prokurimi me një fond limit të llogaritur si shumë të fondeve publike të UPT në vlerën rreth 156,132 mijë lekë dhe janë realizuar 119 procedura prokurimi të ndara (1 procedurë te hapur, 6 me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës, 16 kërkesë për propozim dhe 96 blerje me vlerë të vogël) ku në përfundim të tyre janë shpallur fitues operatorë ekonomikë me të cilët janë lidhur kontrata me vlerë të përgjithshme rreth 136,980 mijë leke. Nga realizimi i procedurave të prokurimit është realizuar një kursim në vlerën 19,152 mijë lekë ose 12% e fondeve publike të UPT të planifikuara për këto blerje dhe shërbime.

Gjatë vitit 2016, UPT ka zhvilluar 129 procedura prokurimi me një fond limit të llogaritur si shumë të fondeve publike të UPT në vlerën rreth 199,945 mijë lekë dhe janë realizuar 129 procedura prokurimi të ndara (8 procedurë te hapur, 1 shërbim konsulence, 6 me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës, 12 kërkesë për propozim dhe 102 blerje me vlerë të vogël) ku në përfundim të tyre janë shpallur fitues operatorë ekonomikë me të cilët janë lidhur kontrata me vlerë të përgjithshme rreth 166,905 mijë leke. Nga realizimi i procedurave të prokurimit është realizuar një kursim në vlerën 33,040 mijë lekë ose 17% e fondeve publike të UPT të planifikuara për këto blerje dhe shërbime.

Gjatë vitit 2017 (1 Janar – 31 Gusht), UPT ka zhvilluar 70 procedura prokurimi me një fond limit të llogaritur si shumë të fondeve publike të UPT në vlerën rreth 39,979 mijë lekë dhe janë realizuar 70 procedura prokurimi të ndara (3 procedura me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës, 8 kërkesë për propozim dhe 59 blerje me vlerë të vogël) ku në përfundim

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE
REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK**

të tyre janë shpallur fitues operatorë ekonomikë me të cilët janë lidhur kontrata me vlerë të përgjithshme rreth 33,982 mijë leke. Nga realizimi i procedurave të prokurimit është realizuar një kursim në vlerën 5,994 mijë lekë ose 15% e fondeve publike të UPT të planifikuara për këto blerje dhe shërbime, kjo për shkak të VKM nr.482 datë 05.07.2017 “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit, për vitin 2017”, i shfuqëzuar me VKM nr.580, datë 13.10.2017 “Për shfuqizimin e vendimit nr.482, datë 05.07.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit, për vitin 2017”.

Grupi i audituesve në total, në institucionin e UPT-sw, auditoi me zgjedhje, gjithsej **43 (dyzetetë)** procedura për vitin, 2013,2014 2015, 2016 dhe 2017, , të cilat janë përlllogaritur në vlerën prej 255,503,000 lekë pa tvsh në zërin buxhetor (602, 230 dhe 231).

**EVIDENCA E TË DHËNAVE PËR TENDERAT E ZHVILLUR DHE AUDITUAR
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**

Nr.	Procedurat e prokurimit qe ka zgjedhur autoriteti kontraktor	Procedura prokurimi gjithsej			
		Planifikuar		Realizuar	
		Sasi	Vlera pa TVSH, ne mije leke	Sasi	Vlera pa TVSH, ne mije leke
2014					
a	b	1	2	3	4
1	Procedura te hapura	1	36,649	1	24,376
2	Proc. Me negocim Me publikim paraprak te njoftimit te kontrates	-	-	-	-
3	Proc. Me negocim Pa publikim paraprak te njoftimit te kontrates	3	6,029	3	5,952
4	Proc. Kerkese per Propozim	14	35,278	14	29,933
5	Blerje me vlere te vogel	84	12,013	83	8,786
	TOTALI	102	89,969	101	69,047
2015					
a	b	1	2	3	4
1	Procedura te hapura	1	43,378	1	30,198
2	Proc. Me negocim Me publikim paraprak te njoftimit te kontrates	-	-	-	-
3	Proc. Me negocim Pa publikim paraprak te njoftimit te kontrates	6	55,417	6	54,902
4	Proc. Kerkese per Propozim	16	41,557	16	39,117
5	Blerje me vlere te vogel	98	15,780	96	12,763
	TOTALI	121	156,132	119	136,980
2016					
a	b	1	2	3	4
1	Procedura te hapura	8	133,264	8	109,860
2	Sherbim konsulence	1	8,566	1	8,326
3	Proc. Me negocim Me publikim paraprak te njoftimit te kontrates	-	-	-	-



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

4	Proc. Me negociim Pa publikim paraprak te njoftimit te kontrates	6	8,496	6	8,486
5	Proc. Kerkese per Propozim	12	33,915	12	28,507
6	Blerje me vlere te vogel	102	15,704	102	11,726
	TOTALI	129	199,945	129	166,905
2017					
a	b	1	2	3	4
1	Procedura te hapura	-	-		-
2	Proc. Me negociim Me publikim paraprak te njoftimit te kontrates	-	-		-
3	Proc. Me negociim Pa publikim paraprak te njoftimit te kontrates	3	5,014	3	4,359
4	Proc. Kerkese per Propozim	8	27,107	8	23,454
5	Blerje me vlere te vogel	59	7,855	59	6,169
	TOTALI	70	39,976	70	33,982

Në mënyrë grafike procedurat paraqiten si më poshtë:



Mangësi të përgjithshme



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Universiteti Politeknik i Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë dhe ka statusin e personit juridik publik. Ai përbëhet nga dhjetë njësi shpenzuese, nga të cilat tetë njësi kryesore (shtatë fakultete dhe një institut), një njësi administrative (Administrata e Rektoratit) dhe një njësi ndihmëse (Biblioteka Shkencore).

Që nga ndarja e tij me Universitetin e Tiranës, me VKM Nr. 215, datë 15/07/1991 “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës” deri më sot, UPT është i organizuar dhe funksionon si një strukturë e centralizuar, me buxhet unik dhe një kod buxhetor, fakt që vlen dhe për realizimin e prokurimeve publike, të cilat realizohen nga Administrata e Rektoratit.

Njësitë kryesore (fakultetet dhe instituti) në përbërje të UPT-së, pavarësisht se janë njësi shpenzuese, nuk plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për prokurimit publik, për zhvillimin e procedurave të prokurimit pasi nuk kanë strukturën dhe organikën e nevojshme me burime njerëzore, të cilat paraqiten me produktivitet të ulët në fushën e prokurimeve publike.

Nga auditimi i procedurave me zgjedhje nga grupi i audituesve, janë verëjtur këto mangësi të përgjithshme, si vijon:

1. Nga auditimi i të gjitha objekteve tenderuese për malla, shërbime dhe rikonstruksione, për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017, të përzgjedhura nga grupi i KLSH-së është konstatuar se në Universitetin Politeknik të Tiranës, si Autoritet Kontraktor, sektori i prokurimeve (sipas organigramës organizative) është caktuar si Njësi e Prokurimit, por e pa shoqëruar me Urdhërin përkatës, nga Titullari i AK.

2. Nga auditimi, u konstatua se në disa raste, anëtarët e komisioneve të posacme (kur kjo detyrë iu është ngarkuar një strukture tjetër), janë burime njerëzore të pa trajnuara pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike (APP), për pasojë janë evidentuar mangësi të elementeve të procedurave prokuruese, si në përllogaritjen e fondit limit, në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, të cilët duhet t'i paraqisin në mënyrë të hollësishme duke e argumentuar për çdo kriter të vendosur prej tyre, të cilat duhet të pasqyrohen në dokumentat e tenderit.

3. Nga auditimi, rezultoi se, në procedurat “Kërkesë për propozim” të realizuara gjatë vitit 2014, me objekt “Blerje dokumentacioni specifik”; “Blerje orendi dhe pajisje zyre”; “Shërbim për mirëmbajtjen e ndërtesave”, nga ana e Njësisë së Prokurimit, për hartimin e fondit limit është mbështetur në oferta të sjella nga operatorë ekonomikë, të cilët nuk kanë paraqitur NIPT-in, e për pasojë fondi limit del “fiktiv” si dhe janë përgatitur dhe dërguar ftesë për 5 operatorë ekonomikë, pa argumentuar arsyen e përzgjedhjes së tyre, si dhe pa e dokumentuar në proces verbal, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu VI, pika b,c.

Ndërsa, kjo e mangësi, për vitet 2015, 2016 dhe 2017, nuk është evidentuar gjatë auditimit, pasi AK ka zbatuar përputhshmërinë ligjore të realizimit të procedurave tenderuese të financiuara nga fondi i UPT-së.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

4.Nga auditimi, rezultoi se, raporti përbledhës i hartuar nga Komisionet e Vlerësimit të Ofertave dhe i miratuar nga titullari i Autoriteti Kontraktor i UPT-së, nuk përmban në mënyrë të detajuar, referencën e procedurës, përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; çmime/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesin e renditur të parin, informacionin nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrja në lidhje me to, kjo në kundërshtim me ligjin nr 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, (VKM nr. 1, datë 10/01/2017, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”) dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 68.

5.Nga auditimi, rezultoi se, të gjitha dosjet që na u vunë në dispozicion, ishin të pa inventarizuara në kundërshtim me ligjin “Për arkivat”. Plotësimi dhe administrimi i dosjeve nuk paraqitet në nivelin e kërkuar, pasi nuk janë arkivuar, nuk janë nënshkruar si marrës në dorëzim dhe nga dorëzuesi, nuk janë plotësuar sipas ligjit për arkivat, ka mungesë të dokumentacioneve shoqëruese, kryesisht mungon në dosje përlllogaritja e fondeve limit, apo dokumente të tjera të cilët pas konstatimeve të këtyre mungesave ju paraqiten grupit të auditimit, veprime në kundërshtim me Ligjin “Për Prokurimin Publik”, Kreu II, neni 12, pika 3.

6.Nga auditimi, rezultoi se, në bazë të kërkesave për mallra, shërbime ose punë, nga administrata e Rektoratit (AK) për vitet buxhetore, 2014, 2015, 2016 dhe 2017, janë përgatitur regjistri i parashikimeve, brenda datës 15 janar të çdo viti, por nga ana e KAD(Këshillit Administrues Drejtues), tashmë i emertuar Bordi i Administrimit (BA) të krijuar në bazë të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, janë miratuar, me vonesë në kohë, duke i dërguar jashtë afateve pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencisë së Prokurimeve Publike. respektivisht:

Për vitin 2014, sipas vendimit të KAD nr. 2, datë 08/04/2014 për “Miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2013 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2014”;

Për vitin 2015, sipas vendimit të KAD nr. 3, datë 05/05/2015 për “Miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2014 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2015”;

Për vitin 2016, sipas vendimit të KAD nr. 2, datë 11/02/2016 për “Miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2015 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2016”;

Për vitin 2017, sipas vendimit të BA nr. Nr. 23, datë 04/05/2017 “Miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2016 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2017”.

Ky fakt, është në kundërshtim me ligjin nr 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, (VKM nr. 1, datë 10/01/2017, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”) dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 4 dhe Udhëzimit të APP nr. 2, dt 27.01.2015.

5.Nga auditimi, rezultoi se, raporti përbledhës i hartuar nga Komisionet e Vlerësimit të Ofertave dhe i miratuar nga titullari i Autoriteti Kontraktor i UPT-së, nuk përmban në mënyrë të detajuar, referencën e procedurës, përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; çmime/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesin e renditur të parin, informacionin nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrja në lidhje me to, kjo në kundërshtim me ligjin nr 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, (VKM nr. 1, datë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

10/01/2017, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”) dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”neni 68.

6.Nga auditimi, rezultoi se, të gjitha dosjet qe na u vunë ne dispozicion, ishin te pa inventarizuara ne kundërshtim me ligjin “Për arkivat”. Plotësimi dhe administrimi i dosjeve nuk paraqitet në nivelin e kërkuar, pasi nuk janë arkivuar, nuk janë nënshkruar si marrës në dorëzim dhe nga dorëzuesi, nuk janë plotësuar sipas ligjit për arkivat, ka mungesë të dokumentacioneve shoqëruese, kryesisht mungon ne dosje përlllogaritja e fondeve limit, apo dokumente te tjera të cilët pas konstatimeve të këtyre mungesave ju paraqiten grupit të auditimit, veprime në kundërshtim me Ligjin “Për Prokurimin Publik”, Kreu II, neni 12, pika 3.

Përveç mangësive të përgjithshme, si më lart në procedurat e prokurimit të audituara u konstatuan edhe mangësi të veçanta si në hartimin e kërkesave kualifikuese ta miratuara nga NJP , në vlerësimet e bëra nga KVO-ve si dhe në zbatimin e kontratave sipas tenderave të audituar, ku në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

1.Gjithashtu, me miratimin e ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”.

Ky ligj, për herë të parë në historinë e IALP, parashikon ekzistencën e dy titullarëve, Rektorin dhe Administratorin, të cilët ushtrojnë kompetencat e tyre në fusha të ndryshme dhe pa varësi administrative nga njeri tjetri.

Konkretisht, në nenin 39 e vijues, të ligjit në fjalë, përcaktohet qartë se ***“Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare***(pritje përcjellje të delegacioneve, autoriteteve të larta shtetërore, ceremonitë zyrtare etj), ***sipas përcaktimeve të këtij ligji.***

Gjithashtu në nenin 5, të ligjit, përcaktohet qartë se ***“Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëkuptimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij ligji”.***

Nisur nga kjo ndarje me zgjedhjen e Rektorit të UPT, në fillim të marrjes së detyrës është ndjerë mbivendosje kompetencash, për shkak të interpretimeve të ndryshme të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike mes Rektorit të Universitetit dhe Administratorit në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve të autoritetit kontraktor,duke sjellë anulimin e procedurës së prokurimit objekt ***“Blerje orendi dhe pajisje zyre për nevojat të Njësive të Universitetit Politeknik të Tiranës” viti 2016.***

Më pas, me interpretimet e shkresave të shumta administrative të Ministrisë së Arsimit, Ministria e Financës, dhe me Vendimin e KPP-së, nr.530/3/2016, është zgjidhur situata e vazhdimësisë të ecurisë së prokurimeve publike, ku si Titullar i AK , është Administratori i UPT-së.

2. Nga auditimi me objekt ***“Ndërtimi i shtesës së Korpusit Kryesor të Universitetit Politeknik të Tiranës”***, rezultoi se :



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

- Nga ana e Institutit të Monumenteve të Kulturës, me shkresë, nr. 1472 prot. datë 22.09.2014, Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit , i janë drejtuar Universitetit Politeknik Tiranë, duke kërkuar hartimin dhe miratimin e projektit të shtesës së Korpusit Kryesor në Këshillin Kombëtar të Restaurimit, me qëllim unifikimin e veshjes së jashtme duke u referuar materialeve të fasadës së korpusit qendror të UPT, i shpallur Monument Kulture i kategorisë së dytë me urdhër nr. 122 prot. datë 05.03.2007, në bazë të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore", ku në thelb ka kërkuar dhe ndryshimin e fasadës së shtesës së UPT-së, duke mos e bërë eficientë projektin e mëparshëm që fondet publike të përdoren me ekonomikitet.

-Me vendimin e Ministrisë së Kulturës nr. 128 datë 11.12.2014, është miratuar projekti "Rehabilitimi dhe trajtimi i fasadave të dy shtesave anësore dhe objektit fundor të UPT-së", ku në bazë të relacionit të mbikëqyrësit të punimeve nr. 147 prot. datë 16.04.2015, është shpjeguar se, ndryshimi i projektit të fasadës, ku janë llogaritur volumet e punës, duke hartuar preventivin e rishikuar të fasadës.

-Nga auditimi, zërat e pandryshuar të cilat ishin në preventivin fillestar, ruajtën të njëjtin çmim njësi, ndërsa zërat e rinj u vendosën me negocim. Në procesverbalin e datës 20.04.2015, midis palëve , është negociuar për çmimet e reja, ku zëri "Veshje fasade me pllaka mermer traventinë 100 cm x 50 cm, trashësi 3 cm, me ngjyrë dhe teksturë si monumentet e kulturës në sheshin "Nën Tereza", e ventiluar, me strukturë mbajtëse metalike të galvanizuar, me ankorim vida inoksi, me kapëse çeliku inoksi", u propozua me 8,800 lekë/m² dhe pas negocimit u ul me 240 lekë/m², ku u miratua çmimi 8,560 lekë, ku sasia përfundimtare rezultoi 2,858.75 m², me vlerë 24,470,900 lekë pa TVSH. Ndërkohë me projekt-preventivin fillestar zëri nr. 30 "Veshje me fasadë me pllaka traventinë trashësi 3 cm, e ventiluar, me strukturë mbajtëse metalike e galvanizuar, me ankorim vida inoxi, me kapëse çelik inox", ka qenë e parashikuar në sasinë prej 451 m², me çmim të ofertuar 1,800 lekë / m². Në thelb zëri i veshjes me traventinë është në kuptimin e njëjtë të procesit të punës, por me ndryshimin e fasadës dhe përmasave të saj ka ndryshuar edhe çmimi.

Kështu, sa më sipër, nga ndryshimi i fasadës u hartua preventivi shtesë i kontratës me vlerë prej 54,401,280 lekë me TVSH, nga fondet buxhetore, për shkak të mos kordinimit të Institucioneve të nivelit qendror me UPT-në.

- Kontrata për punë publike nr. 16/42 prot. datë 28.02.2013, e lidhur midis Autoritetit Kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "I & D sh.p.k", sipas nenin 40.2 të kontratës, Garancia e punimeve prej 5 % e vlerës së kontratës e cila është 12 muaj, ku operatorit ekonomik i ka përfunduar punimet. Nga auditimi rezultoi se, në garanci janë futur zëri i punimeve dhe zëri i mallrave të inkorporuar gjatë punimeve. Kështu sa më sipër, duke u nisur nga natyra komplekse, e këtij investimi, duhej që nga AK të ishte përcaktuar që në DT, afat prej 24 muaj garanci, pasi grupi i audituesve ka verejtur, që në zonën e parkimeve ka lagështi , e cila detyrimisht do të kërkojë mirëmbajtje nga AK (për mos dëmtim objekti) si dhe pajisjet si ashensorë, sistemit kundra zjarrit etj, u konstatuan shpesh here se pajisjet kanë mosfunktionim normal të tyre, duke kërkuar shërbime të ndryshme mirëmbajtje. Pra sa më sipër, nëse do të ishte, përcaktuar koha e garancisë më e gjatë, këto shërbime dhe mirëmbajtje do të siguroheshin nga operatori ekonomik fitues.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

-Kontrata është likuiduar me 26 situacione pjesore progresive të kontratës bazë dhe 4 situacione pjesore progresive të shtesës së kontratës, të cilat nuk janë shoqëruar me librezë masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, pika 8.1 ku citon se situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasisë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës. Në disa zëra të punimeve elektrike, ngrohje etj tabela e lëvizjes së volumeve nuk pasqyron të detajuar sasinë e realizuar.

3.Nga auditimi në tenderin me objekt " *Blerje dhe instalim i sistemit të kamerave për sigurinë e objekteve të UPT* " përllogaritja e vlerës limit të kontratës, e realizuar nga grupi i studimit të tregut, i cili nuk ka vendosur ndonjë referencë mbi cilësinë, parametrat kryesorë të kamerave, në mënyrë që të përcaktonte më saktë vlerën e përllogaritur të kontratës për sistemin e survejimit, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VII, neni 59, “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës”.

Gjithashtu, në DT, nga grupi për hartimin e specifikimeve teknike dhe termave të referencës, janë vendosur indirekt parametra cilësie vetëm të një produkti të një prodhuesi të vetëm, duke orientuar operatorët ekonomik drejt këtij prodhuesi të caktuar, pasi është vendosur autorizim prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, duke favorizuar operatorë të cilët gëzojnë autorizim të prodhuesit, e për pasojë kemi ulje të konkurrencës në mënyrë të ndjeshme.

4. Nga auditimi, në lidhje mbi vlerësimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën tenderuese me objekt “*Blerje dhe instalim i sistemit të kamerave për sigurinë e objekteve të UPT, viti 2016.*”, është s'kualifikuar operatori ekonomik "F", për shkak të specifikimeve teknike dhe termave të referencave, të cilat rezultuan se i plotësonte vetëm një prodhues në treg, pasi specifikimet teknike të kamerës të markës "D", të paraqitur prej tij nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në DST markës "H".

Autoriteti kontraktor nuk duhej të kishte përcaktuar terma të referencave të produkteve të markës "H" dhe të vendoste parametra normal cilësie, duke vendosur kritere që të nxisin konkurrencën dhe duke zgjeruar tregun e produkteve, atëherë OE "Fastech" sh.p.k (me kamerat e markës “D”), do të ishte shpallur fitues me vlerë më të ulët, në të cilën asnjë kamerë apo produkt, nuk mund ti plotësojë plotësisht 100 % specifikimet teknike të DST (përveç markës “H”) dhe diferenca midis 2 ofertave të kamerave të markave të ndryshme në vlerën **1,707,332 lekë me TVSH**, përbën menaxhim pa efektivitet dhe eficensë të fondeve të UPT.

5.Nga auditimi i procedurave me objekt “*Shërbimi i informatizimit të aktivitetit dhe dokumentacionit të sekretarive mësimore*”, për vitet, 2014, 2015, 2016” rezultoi se, ky shërbim është përfutur për nevojat e UPT-së, nga njëjti operator ekonomik “B-A” shpk , për vitin 2014 me vlerë ekonomike prej 1,600,000 lekë pa TVSH , për vitin 2015 me vlera ekonomike prej 1.855,000 lekë pa TVSH dhe për vitin 1,918,800 lekë pa TVSH, pra në total në vlerë prej 5,373,000 lekë pa TVSH. Si rezultat i këtij shërbimi, është realizuar përmbushja e qëllimit mbi mundësimin e funksionimit informatik në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, emetimin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

dokumente zyrtare të provimeve si dhe ofrimi i shërbimeve më cilësore ndaj studenteve dhe pedagogëve në funksion të procesit mësimor.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se ky program dhe ky shërbim nuk do të jetë funksional, pasi UPT, po implementon dhe po ngrihet infrastruktura hardëare për instalimin lokal të sistemit UGOV, kjo në kuadër të projektit të ndërtimit të rrjetit telematik për Universitetet Shtetërore Publike, sipas ligjit nr.9704, datë 02.04.2007 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një Qendre Shërbimesh dhe të një Rrjeti Telematik për Universitetet”

Pra si konkluzion, nga ana e AK të Universitetit Politeknik të Tiranës, për tre vitet e mësipërme, nga të ardhurat dytësore, u siguroi shërbimi i informatizimit të “SEKRETARIA”, i cili tashmë, nuk do të jetë më, si pasojë e moskordinimit të UPT-së me Ministrinë e Arsimit dhe më gjërë, duke sjellë mos përdorim të fondeve publike, pa eficiencë, pa efektivitet dhe pa ekonomikitet, të viteve (2014, 2015 dhe 2016), të vlerës ekonomike në total prej 5,373,000 lekë pa TVSH, si rezultat i zëvendësimit të shërbimit të informatizimit me një shërbim tjetër të sistemit UGOV.

Më poshtë po japim në mënyrë të përmbledhur, mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të procedurave prokuruese, të financiuara në Buxheti i Shtetit dhe nga buxheti publik i UPT-së.

1.Mbi auditimin me objekt në lidhje me zbatimin e kontratës të objektit “Ndërtimi i shtesës së Korpusit Kryesor të Universitetit Politeknik të Tiranës”.

-Nga ana e Institutit të Monumenteve të Kulturës, me shkresë, nr. 1472 prot. datë 22.09.2014, dhe Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit, i janë drejtuar Universitetit Politeknik Tiranë, duke kërkuar hartimin dhe miratimin e projektit të shtesës së Korpusit Kryesor në Këshillin Kombëtar të Restaurimit, me qëllim unifikimin e veshjes së jashtme duke u referuar materialeve të fasadës së korpusit qendror të UPT, i shpallur Monument Kulture i kategorisë së dytë me urdhër nr. 122 prot. datë 05.03.2007, në bazë të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, ku në thelb ka kërkuar dhe ndryshimin e fasadës së shtesës së UPT-së, duke mos e bërë eficientë projektin e mëparshëm që fondet publike të përdoren me ekonomikitet.

-Me vendimin e Ministrisë së Kulturës nr. 128 datë 11.12.2014, është miratuar projekti “Rehabilitimi dhe trajtimi i fasadave të dy shtesave anësore dhe objektit fundor të UPT-së”, ku në bazë të relacionit të mbikëqyrësit të punimeve nr. 147 prot. datë 16.04.2015, është shpjeguar se, ndryshimi i projektit të fasadës, ku janë llogaritur volumet e punës, duke hartuar preventivin e rishikuar të fasadës.

-Nga auditimi, zërat e pandryshuar të cilat ishin në preventivin fillestar, ruajtën të njëjtin çmim njësi, ndërsa zërat e rinj u vendosën me negociim. Në procesverbalin e datës 20.04.2015, midis palëve, është negociuar për çmimet e reja, ku zëri “Veshje fasade me pllaka mermer traventinë 100 cm x 50 cm, trashësi 3 cm, me ngjyrë dhe teksturë si monumentet e kulturës në sheshin “Nën Tereza”, e ventiluar, me strukturë mbajtëse metalike të galvanizuar, me ankorim vida inoksi, me kapëse çeliku inoksi”, u propozua me 8,800 lekë/m² dhe pas negociimit u ul me 240 lekë/m², ku u miratua çmimi 8,560 lekë, ku sasia përfundimtare rezultoi 2,858.75 m², me vlerë 24,470,900 lekë pa TVSH. Ndërkohë me projekt-preventivin fillestar zëri nr. 30 “Veshje me



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

fasadë me pllaka traventinë trashësi 3 cm, e ventiluar, me strukturë mbajtëse metalike e galvanizuar, me ankorim vida inoxi, me kapëse çelik inox", ka qenë e parashikuar në sasinë prej 451 m², me çmim të ofertuar 1,800 lekë / m². Në thelb zëri i veshjes me traventinë është në kuptimin e njëjtë të procesit të punës, por me ndryshimin e fasadës dhe përmasave të saj ka ndryshuar edhe çmimi.

Kështu, sa më sipër, nga ndryshimi i fasadës u hartua preventivi shtesë i kontratës me vlerë prej 54,401,280 lekë me TVSH, nga fondet buxhetore, për shkak të mos kordinimit të Institucioneve të nivelit qendror me UPT-në.

Nga auditimi i procedurës rezultoi se:

Me vendimin e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Territorit të RSH nr. 8 datë 10.05.2013, është miratuar leja zhvillimore komplekse për ndërtimin e shtesës së Korpusit Kryesor të Universitetit Politeknik, Tiranë. Objekti “Ndërtimi i shtesës së Korpusit Kryesor të Universitetit Politeknik të Tiranës”, është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 16/42 prot. datë 28.02.2013, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, përfaqësuar nga Rektori i UPT dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "I & Dsh.p.k", përfaqësuar nga drejtuesi ligjor. Vlera e kontratës bazë është 272,013,874 lekë me TVSH. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën e preventivit njësi për secilin zë punimesh në përputhje me nenin 5 të kontratës. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore prej 24 (njëzet e katër) muaj, menjëherë me lidhjen e kontratës dhe për periudhën 22 Mars - 23 Tetor punimet do të kryhen me 2 turne.

Nga auditimi, Garancia e punimeve prej 5 % e vlerës së kontratës, e përcaktuar në nenin 40.2 të kontratës, është 12 muaj. *Duke parë natyrën e objektit i cili është kompleks, i cili ka pajisje dhe makineri si ashensorë, impiante për mbrojtjen kundra zjarrit, sisteme ngrohje-ftohje etj, të cilat mund të kenë garanci nga prodhuesit më të madhe se 12 muaj, nga autoriteti kontraktor duhejtë ishte përcaktuar periudhë më e gjatë garancie, që në dokumentet e tenderit, duke ekonomizuar shërbime për mirëmbajtjen apo defekte të ndryshme.*

-Projekti i objektit është realizuar nga shoqëria projektuese "U" sh.p.k, në Korrik të 2006.

-Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata me nr. 20/16 prot. datë 28.02.2013 të lidhur mes Universiteti Politeknik i Tiranës, përfaqësuar nga Rektori UPT-së dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "P & G sh.p.k", përfaqësuar nga drejtuesi ligjor. Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 1,920,000 lekë me TVSH.

- Me aneksin e kontratës nr. 1, nr. 20/18 prot. datë 11.03.2013, midis mbikëqyrësit të punimeve dhe investitorit, palët bien dakord që punimet fillojnë menjëherë sapo të miratohet leja e ndërtimit e objektit.

- Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është mbajtur me datë 14.06.2013, ku është konstatuar se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi merr në dorëzim sheshin e ndërtimit për realizimin e punimeve. Njoftimi i fillimit të punimeve dhe procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur me shkresën nr. 715/2 prot. datë 14.06.2013. Procesverbali i aktit të piketimit është mbajtur me datë 14.06.2013. Bazuar në kontratë, punimet duhet të përfundojnë me 14.06.2015.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

-Me shkresën e mbikëqyrësit datë 07.08.2013, drejtuar UPT për dijeni edhe shoqërisë projektuese "U" sh.p.k, konstatohet se gjatë gërmimeve, janë vërejtur zhvendosje të murit të pilotave si dhe plasaritje në strukturën ekzistuese, ku kërkohet gjetja e zgjidhjes teknike përfundimtare, ku po kryhet monitorimi i zhvendosjeve të murit të pilotave dhe godinës ekzistuese.

-Me relacionin teknik të mbikëqyrësit bazuar kërkesave për përforcimin e plasaritjeve, shoqëria projektuese "U"sh.p.k dorëzoi në AK projektin e "*Pajantimit të murit të pilotave*", ka hartuar preventivin e punimeve të nevojshme për realizimin e përforcimit.

-Me shkresën e Institutit të Monumenteve të Kulturës nr. 1472 prot. datë 22.09.2014, drejtuar Universitetit Politeknik Tiranë, kërkohet hartimi dhe miratimi i projektit të shtesës së Korpusit Kryesor në Këshillin Kombëtar të Restaurimit, me qëllim unifikimin e veshjes së jashtme duke u referuar materialeve të fasadës së korpusit qendror të UPT, i shpallur Monument Kulture i kategorisë së dytë me urdhër nr. 122 prot. datë 05.03.2007, në bazë të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 "*Për trashëgiminë kulturore*".

-Me shkresën e kancelarit të UPT, nr 1167/1 prot. datë 30.09.2014, drejtuar mbikëqyrësit të punimeve "P & G " sh.p.k, kërkohet konsultimi me kontraktorin dhe hartuesin e projektit, për të vlerësuar përputhshmërinë e projektit aktual me kërkesat e Institutit të Monumenteve të Kulturës, me qëllim miratimin e tij në Këshillin Kombëtar të Restaurimit.

-Me vendimin e Ministrisë së Kulturës nr. 128 datë 11.12.2014, miraton projektin "*Rehabilitimi dhe trajtimi i fasadave të dy shtesave anësore dhe objektit fundor të UPT-së*", me disa vërejtje, ku të vishet me traventinë kornizat vertikale, horizontale të objektit fundor të UPT, duke ngarkuar Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të pasurisë kulturore.

-Me shkresën nr. 21 prot. datë 22.01.2015 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, miraton vendimin nr. 128, me vërejtjet përkatëse.

-Me shkresën e mbikëqyrësit nr. 31 prot. datë 20.02.2015, kërkohet nga investitori miratimi i ndryshimit të projektit të fasadës, miratimi i efektit të ri financiar për projektin e ri dhe zgjatje të lejes së ndërtimit deri në 6 muaj.

-Me relacionin e mbikëqyrësit nr. 147 prot. datë 16.04.2015, shpjegohet ndryshimi i projektit të fasadës, ku pasi janë llogaritur volumet e punës është hartuar preventivi i rishikuar i fasadës. Zërat e pandryshuar të cilat ishin në preventivin fillestar, ruajtën të njëjtin çmim njësi, ndërsa zërat e rinj u vendosën me negociim. Me procesverbalin e datës 20.04.2015, midis palëve u negociuan çmimet e reja, ku zëri "*Veshje fasade me pllaka mermer traventinë 100 cm x 50 cm, trashësi 3 cm, me ngjyrë dhe teksturë si monumentet e kulturës në sheshin "Nën Tereza", e ventiluar, me strukturë mbajtëse metalike të galvanizuar, me ankorim vida inoksi, me kapëse çeliku inoksi*", u propozua me 8,800 lekë/m² dhe pas negociimit u ul me 240 lekë/m². Nga ndryshimi i fasadës u hartua preventivi shtesë i "*Ndërtimit të shtesës së Korpusit Kryesor të Universitetit Politeknik të Tiranës*", në vlerën prej 54,401,280 lekë me TVSH.

Për sa më sipër, nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit dhe nga Instituti i *Monumenteve të Kulturës, duhej të merreshin masa për bashkëpunim me njëri-tjetrin për tu rakorduar në kohën e hartimit të projektit dhe lejes së shfrytëzimit, mbi përcaktimin e fasadës në mënyrë që fondet publike të përdorëshin me ekonomicitet dhe efikasë, që në fazën e procesit të tenderimit duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomik.*



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

-Me shkresën e Universitetit Politeknik të Tiranës nr. 130/5 prot. datë 09.06.2015, drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, njoftohet kërkesa për shtyrje e lejes së ndërtimit të shtesës së godinës së Korpusit Kryesor, për periudhë 6 mujore. Shkaqet e shtyrjes së punimeve janë:

1. Punimet rehabilituese dhe ndërhyrëse që u kryen në sheshin "Nënë Tereza" nga Ministria e Kulturës dhe Bashkia Tiranë, me rastin e vizitës së Papës në muajin Qershor-Shtator 2014.
2. Në periudhën Shtator 2014-Janar 2015, në zbatim të kërkesave të IMK deri në vendimin nr. 128 datë 11.12.2014 nga KKR dhe shkresën e MAS nr. 3394/1 datë 02.06.2015, për punimet e paparashikuara në fasadën e ndryshuar të objektit u ndërpre.
3. Kushtet klimaterike me reshje dhe temperatura të ulëta në muajt Nëntor-Dhjetor 2014.

-Me procesverbalin e datës 12.06.2015 midis mbikëqyrësit, sipërmarrësit dhe investitorit, palët bihen dakord për zgjatjen e afatit të zbatimit të kontratës për një periudhë 6 (gjashtë) mujore.

-Me aneksin e kontratës nr. 2, nr. 591/1 prot. datë 12.06.2015, miratohet zgjatja e punimeve për periudhën 6 mujore, në cilën punimet duhet të përfundojnë në Dhjetor 2015, ku njoftimi i përfundimit të punimeve është realizuar në Dhjetor 2015.

-Me shkresën e mbikëqyrësit nr. 177 prot. datë 11.11.2015, drejtuar UPT, kërkohet shtesë kontratë bazuar rishikimit të projektit të rishikuar të fasadës nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe vendimi nr. 128 datë 11.12.2014, të Ministrisë së Kulturës.

Më urdhrin e prokurimit të titullarit të UPT nr. 21 prot. datë 02.12.2015, realizohet shtesa e kontratës deri në 20% të kontratës fillestare.

Procedura e prokurimit është realizuar në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik"(i ndryshuar) në nenin 33, pika 5) dhe "Rregullave të prokurimit publik" të miratuara me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014, kreu IV, neni 36 pika 2dh, ku AK mund ta përdorë procedurën me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës për punë apo shërbime shtesë, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare, por që, për shkak të rrethanave të paparashikuara, janë bërë të domosdoshme.

-Kontrata shtesë është nënshkruar me nr. 21/1 prot. datë 03.12.2015, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, përfaqësuar nga Rektori i UPT dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "I & D sh.p.k", me afat zbatimi 90 ditë. Me datë 03.12.2015 është mbajtur procesverbal i fillimit të punimeve të kontratës shtesë dhe më 03.03.2016 njoftohet përfundimi i punimeve, brenda afatit kontraktual.

-Nga verifikimi me sondazhe të zërave kryesor të objektit, librezës së masave, projektit Asbuild (elektronikisht) dhe situacionit përfundimtar nr. 26, bashkë me situacionin përfundimtar nr. 4 të shtesës së kontratës, në kapitujt e kryesorë, konstatohet përputhshmëri e projektit të realizuar "Asbuild" me librezat e masave dhe vlerës së likuiduar, me nivel materialiteti të pranueshëm bazuar kushteve teknike të zbatimit.

-Akti i kolaudimit është realizuar më datë 02.05.2016 nga Ing.

-Kontrata përbëhet prej 26 situacione pjesore progresive të kontratës bazë dhe 4 situacione pjesore progresive të shtesës së kontratës, të cilat nuk janë shoqëruar me librezat masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 "**Për zbatimin e**



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

*punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1” Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës” dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “**Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit**”, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se:*

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

Në lidhje mbi problematikën e evidentuar sa më sipër, grupi i auditimit , ka mbajtur me AK e UPT-së, Aktkonstatim nr.9 prot. 1003/10 datë 30.10.2017, për të cilën janë paraqitur observimet nr. 1361/6 prot. datë 06.11.2017, mbi pretendimet se situacionet pjesore janë administruar pranë Drejtorisë së Investimeve dhe Mirëmbajtjes, sqarojmë se gjatë auditimit të dosjes teknike të zbatimit, nuk u konstatuan se situacionet pjesore të ishin shoqëruar me librezë masash apo relacione teknike.

2.Mbi auditimin procedurës me objekt “Blerje dhe instalim i sistemit të kamerave për sigurinë e objekteve të UPT, për vitin 2016”, viti 2016.

Nga auditimi i procedurës rezultoi se:

1. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:

Nga auditimi, u verejt se, me procesverbalin e datës 25.10.2016, grupi i testimit të tregut për përllogaritjen e çmimit të kontratës i është referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VII, neni 59, “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës”pika 2 ku citohet:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); **ose/dhe**

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Grupi i testimit të tregut mori oferta nga 3 operatorë ekonomik, “E” sh.p.k, “R” sh.p.k, “S” sh.p.k, me oferta si më poshtë:

1. “E” sh.p.k 9,000,000 lekë me TVSH.
2. “R” sh.p.k 9,200,500 lekë me TVSH.
3. “ S” sh.p.k 8,992,000 lekë me TVSH, ku ka përcaktuar si fond vlerë të përlogaritur të kontratë ofertën më të ulët 8,992,000 lekë me TVSH ose 7,493,333 lekë pa TVSH. *Gjatë studimit të tregut, grupi nuk ka vendosur ndonjë referencë mbi cilësinë (parametra kryesorë) të kamerave, në mënyrë që të përcaktohej më e saktë vlera e sistemit tëurvejimit.*
 - Me Urdhërin e titullarit të AK nr. 15 prot. datë 25.10.2016, caktohet dr., me detyrë pedagog pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. Me urdhërin e titullarit të AK nr. 15/1 prot. datë 25.10.2016, ngrihet Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit.
 - Me urdhërin e titullarit të AK nr. 15/4 prot. datë 25.10.2016, ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave. Me shkresën nr. 15/5 prot. datë 26.10.2016 u dërgohet ftesë për ofertë shoqërive "B-A-" sh.p.k, "A-" sh.p.k, "Sh-" sh.p.k, "S-" sh.p.k dhe "I-" sh.p.k.

2. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi dokumentet e tenderit u konstatua se:

Mbi kriteret kualifikuese kanë pasur disa ankesa, ku dokumentet e tenderit kanë pësuar disa ndryshime. Termat e referencave të kamerave të hartuara e miratuara nga AK, janë në kundërshtim Neni 46, pika 3 e LPP citon se *“kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”*.

Në kundërshtim VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe në kundërshtim me nenin 23, specifikimet teknike.

-Në termat e referencës së parametrave të kamerave të NVR, VMS dhe kamerave janë referuar indirekt vetëm një prodhuesi caktuar në treg "H-", duke eliminuar konkurrencën dhe duke preferuar një prodhues të vetëm bashkë me operatorët ekonomik që gëzojnë autorizimin e kompanisë prodhuese.

Karakteristikat teknike të Video-Regjistrator Rrjeti 32 kanale, video regjistrator rrjeti 16 kanale, Kamera e Brendshme 4 MPX, Kameran e Jashtme 4 MPX, janë marrë njësoj me katalogun e produkteve të kompanisë "H-", duke orientuar procedurën e prokurimit drejt një prodhuesi, ku nuk është përcaktuar edhe karakteristikat **“ekuivalente”** ose në diapazone që të nxitet konkurrenca. Nga auditimi dhe kërkimi i produkteve të prodhuesve të ndryshëm, konstatohet se asnjë prodhues nuk është i përmbush **të plota 100 % specifikimet e DST (përveç markës H-)**, ku nuk ekziston asnjë produkt i ngjashëm.

-Në kërkesat për kualifikim pika **2.3.Ç**, kërkohet në mënyrë eksplicite: Ofertuesi ne rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi për mallrat e ofertuar, i cili merr përsipër të furnizojë ofertuesin me artikujt objekt prokurimi. Për plotësim e kësaj pike ofertuesi duhet te paraqesë autorizimin te përkthyer dhe noterizuar në gjuhen shqipe. Kjo kërkesë është në kundërshtim me nenet 20, 23 dhe 46 të ligjit 9643/2006, i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se Autoritetet kontraktore gjatë përcaktimit të kriterëve të veçanta duhet të shmangin çdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomik, e cila



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Por në përcaktimin apo në vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë që përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe (ii) jodiskriminues, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Gjatë përshkrimit të objektit të prokurimit publik, autoritetet kontraktore përdorin "kriterë të veçanta kualifikimi", në të cilat përfshihen specifikimet teknike, që zakonisht, kupton tërësinë e kërkesave teknike. Këto specifikime teknike përcaktojnë karakteristikat e kërkuara nga punët, mallrat ose shërbimet që plotësojnë përdorimin të cilin ato synojnë nga autoriteti kontraktor. Kërkesat/specifikimet teknike shpesh përfshijnë nivelin e cilësisë, performancës, sigurisë apo përmasave, garantimin e cilësisë, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat e testimit si dhe të paketimit, markën dhe etiketimin etj.

Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim, vendosja e specifikimeve teknike të prodhuesve dhe produkteve të vetëm, kanë orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik, është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme kanë ulur në mënyrë të ndjeshme konkurrencën duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka eliminuar konkurrencën.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "Për prokurimin publik" neni 23 "Specifikimet teknike", pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, "Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime".

- Me shkresën nr. 15/6 prot. datë 01.11.2016 të OE "S-" sh.p.k është bërë ankesë AK mbi specifikimet e kërkuara, të cilat janë marrë nga faqja e webit të H, ku përcaktohen produktet përkatëse të NVR, VMS dhe kamerave, ku operatori ekonomik ka vendosur referencat e marra nga faqja e ëëbit:

http://overseas.hikvision.com/europe/Products_accessories.aspx?c_kind=&c_kind2=1&c_kind3=2&c_kind4=154&c_kind5=158&id=8820, duke kërkuar të përdoren specifikimet standarde të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), duke vendosur kërkesa minimale teknike, në mënyrë që mos të plotësohen vetëm nga një prodhues. Gjithashtu OE "S" sh.p.k, ka konstatuar mospërputhje të specifikimeve në mënyrën e funksionimit të sistemit. Midis ankesave për kriteret kualifikuese të numrit të latë të punonjësve dhe specialistëve, kërkon të hiqet edhe certifikata **ISO 20000-1:2011** (mbi menaxhimin e shërbimeve të IT).



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

- Me shkresën nr. 15/7 prot. datë 01.11.2016 të OE "B360" sh.p.k, kërkohen ndryshime të DST, konkretisht: Kërkesa 1. Në kriteret e veçanta kualifikuese pika 2.3.f, kërkohet të hiqet fjala OE të jetë distributor i autorizuar nga kompania prodhuese, në kundërshtim me LLP neni 20, pasi kjo kërkesë favorizon vetëm distributorët zyrtarë të kompanive prodhuese ku numri i tyre është shumë i pakët në krahasim me numrin e rishitëse. Gjithashtu sqaron se në kërkesat kualifikuese është kërkuar autorizim i prodhuesit, i cili mund të lëshohet si për distributorët edhe rishitësit.

Kërkesa 2. OE "B360" sh.p.k, kërkon të hiqet nga kriteret kualifikuese dorëzimi i mostrave, në përputhje me VKM nr. 914 datë 29.12.2014, neni 6 pika a, dhe Vendimit të KPP nr. 91/2016 datë 25.02.2016, duke argumentuar se mostrat e NVR kamera Bullet dhe Kamera Dome e brendshme nuk do konstatohen ndonjë karakteristikë e veçantë përveç kontrollit vizual, ku mbi përputhjen e specifikimeve teknike AK ka kërkuar katalogë/skedën teknike, ku kryhet gjykimi i nevojshëm për karakteristikat e produkteve.

Kërkesa 3. OE "B" sh.p.k, kërkon të hiqet mirëmbajtja e shërbimit të i sistemit të sigurisë së kamerave dhe të lihet vetëm deklarata e garancisë së pajisjeve, me arsyetimin e procedura e prokurimit është "Mallra", ku nqs duhej shërbimi i mirëmbajtjes atëherë duhet të ishte procedurë prokurimi për "Shërbime".

Kërkesa 4. OE "B" sh.p.k, konstaton një mospërputhje midis të dhënave të sasive zëri 11 dhe në specifikimet teknike. Në preventiv është përcaktuar F.V TV 21" dhe në specifikime është kërkuar TV minimalisht 42", ku kërkohet saktësimi i madhësisë së TV dhe përcaktimi i sasive për zërat priza, patchpanel, patchcord.

-Me Urdhërin të titullarit nr. 15/8 prot. datë 01.11.2016, është pezulluar procedura e prokurimit.

- Me vendimin nr. 15/9 prot, datë 04.11.2016, nuk pranohet ankesa e operatorit ekonomik "Synapse ATS" sh.p.k, duke sqaruar se pretendimi nuk qëndron dhe se specifikimet teknike i plotësojnë disa prodhues, H, D, A, T, B etj, ku pretendojnë se asnjë specifikim teknik nuk janë të natyrës diskriminuese.

- Me vendimin nr. 15/10 prot. datë 04.11.2016, UPT pranon pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "B" sh.p.k.

- UPT i kthen përgjigje mbi vendimet e ankesave me shkresën nr. 15/12 prot. datë 04.11.2016 operatorit "S " sh.p.k dhe me shkresën nr. 15/13 prot. datë 04.11.2016 i kthen përgjigje operatorit "B" sh.p.k.

- Me shkresën nr. 15/5 datë 11.11.2016, përsëri operatori ekonomik "S " sh.p.k, paraqet ankesë mbi dokumentet standarde të tenderit, ku pasqyron përsëri problemin se specifikimet teknike nuk përshkruajnë specifikimet minimale, por janë marrë 100% specifikime të produkteve të caktuara të markës "H".

- UPT me shkresën e titullarit të AK nr. 15/16 prot. datë 14.11.2016, i kthen përgjigje OE "S " sh.p.k, se ankesa e paraqitur është jashtë afatit 7 ditor sipas VKM nr. 914 datë 29.12.2014, neni 78, pasi publikimi i tenderit 26.10.2016.

-OE "B" sh.p.k, i dërgon ankesë Komisionit të Prokurimit Publik mbi dokumentet e tenderit të cilat nuk u morën parasysh nga AK. Me shkresën përcjellëse të KPP nr. 1491 prot. datë 09.12.2016 drejtuar UPT, dërgohet Vendimi i KPP nr. 927/2016, ku pranon ankesën e OE "B"



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

sh.p.k, për procedurën e prokurimit dhe përcakton se AK duhet të kryejë modifikimet përkatëse sipas arsytimit të KPP.

KPP-ja në vendimin mbi ankesën, ka gjykuar se kriteri i mirëmbajtjes është i ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe objektin e kontratës, si dhe jo në përputhje me fondin limit, duke pasur konfuzion midis garancisë së produkteve për periudhë një vjeçare me shërbimin e mirëmbajtjes, që ka të bëjë me shërbimin periodik të mallrave.

Mbi këto gjykime të KPP, AK ka modifikuar dokumentet e tenderit por nuk ka hequr certifikatën ISO 20000-1:2011 (mbi menaxhimin e shërbimeve të IT), *e cila është certifikatë ndërkombëtare që synon veçanërisht Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit IT dhe shërbimeve të infrastrukturës*. Standardi ka për qëllim të përcaktojë se çfarë një shoqëri duhet të bëjë për të krijuar një strategji për përmirësimin e proceseve kyçe të tilla si raportimi i menaxhimit të niveleve të shërbimit, monitorimit dhe kontabiliteti i shërbimeve të IT, sigurinë e informacionit, furnizuesit dhe menaxhimin të ndryshimeve, e cila duhet të hiqet nga DST.

Në përfundim për sa konstatuar më sipër, me termat e referencave të cilat kanë eliminuar konkurrencën, bien në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **neni 1** ku përcaktohet: të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. **Neni 2** të LPP Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parime të përgjithshme, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe transparencë në procedurat e prokurimit. **Neni 46**, pika 3 e LPP citon se kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik. Në kundërshtim VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” **neni 61** “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”.

3. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi vlerësimin e ofertave u konstatua se:

Me relacionin përmbledhës të KVO nr. 15/19 prot. datë 04.01.2017, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik.

1. BO "A & A" sh.p.k, është s'kualifikuar pasi:

- BO A& A, nuk kanë paraqitur, diplome cv, kontratë pune për inxhinierin informatikë, përcaktuar në dokumentet e tenderit kapaciteti teknik pika 2.3 germa d);
- BO A & A, nuk kanë paraqitur shtojcën 10 (sasia dhe grafiku i lëvrimin) në DT. Tabela e paraqitur është e paplotësuar dhe nuk përmban asnjë të dhënë, siç është përcaktuar në dokumentet e tenderit kapacitetit teknik pika 2.3 germa k);
- Anëtari i BO A sh.p.k, nuk ka shlyer detyrimet e maturuara të energjisë elektrike për muajin Shtator 2016.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

-Anëtari i BO A sh.p.k, nuk ka paraqitur kontratë të ngjashme të realizuar gjatë tre viteve të fundit në përputhje me përqindjen e përcaktuar në aktmarrëveshjen e bashkimit të OE, përcaktuar në dokumentet e tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 2.3;
-Anëtari i BO A sh.p.k, nuk ka paraqitur licencën profesionale të shoqërisë për kategoritë përkatëse të përcaktuar në dokumentet e tenderit, kapaciteti teknik pika 2.3 germa b);
-Anëtari BO A sh.p.k, nuk ka paraqitur certifikatat ISO të përcaktuar në dokumentet e tenderit kapaciteti teknik,pika 2.3 germa c), si dhe:

Nga të dhënat teknike të katalogut që ka paraqitur OE, rezulton se specifikimet teknike të pajisjeve nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

a) Modeli i kamerave i ofruar, nuk ka parametra teknike për video bit rate, ndërkohe që në DST kërkohet video bit rate 32kbps-16mbps;

b) Në DST, për kamerat është kërkuar Netëork Storage: NAS(Support NFS,SMB/CIFS, ndërsa modeli i kamerave i paraqitur, nuk e ofron NAS,

c) Në DST, pajisja NVR Decoding është kërkuar Live vieë / Playback: 12MP / 8MP 6MP 5MP 4MP 3MP 1080p UXGA /720p/ VGA4CIF /DCIF/ 2CIF/ CIF/ QCIF dhe Capability: 4-ch@ 8MP, 16ch @1080P, ndërsa modeli i paraqitur nuk i ofron këto parametra;

ç) Në DST, për kamerat e brendshme kërkohet Poëer Consumption: Max. 5W dhe për kamerat e jashtme Poëer Consumption: I3: Max. 6W; I5: Max. 7.5Ë; I8: Max. 10.5W, ndërsa modeli i paraqitur nuk ka të dhëna teknike për këto parametra.

d) Në DST, për kamerat e brendshme kërkohet opsioni Ëireless, ndërsa modeli i paraqitur nuk e plotëson këtë kërkesë.

2. OE "F" sh.p.k ", është s'kualifikuar pasi:

Nga të dhënat teknike të katalogut që ka paraqitur OE, rezulton se specifikimet teknike të pajisjeve nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

a) Sipas të dhënave teknike të katalogut për kamerat e brendshme 4 MPX, parametrat e video bit rate janë më të ulëta se ato të kërkuara në DST. Në DST kërkohet bit rate 32k-16mpbs, ndërsa në katalogun e paraqitur shënohet bit rate 32kbps-10mbps;

b) Në DST, për kamerat është kërkuar Netëork Storage: NAS (Support NFS,SMB/CIFS, ndërsa modeli i kamerave i paraqitur, nuk e ofron NAS;

c) Në DST, pajisja NVR Decoding është kërkuar Live vieë /Playback:12MP /8MP 6MP 5MP 4MP 3MP 1080p UXGA /720p/ VGA4CIF /DCIF/ 2CIF/ CIF/ QCIF dhe Capability:4-ch@ 8MP,16ch@ 1080P, ndërsa modeli i paraqitur nuk i ofron këto parametra;

ç) Në DST, për kamerat e jashtme është kërkuar lens -13: 4.6 mm 15:4.6,12mm 18: 6,12 16 mm F 2.0, ndërsa modeli i ofruar: 3.6 mm deri 6 mm, ka parametra më të ulët;

d) Në DST, për kamerat është kërkuar video compression: H26/MJPEG/H 264+, ndërsa të modeli i paraqitur mungon H264+;

e) Në DST, për kamerat e brendshme kërkohet Power Consumption: Max.5Ë, ndërsa modeli i paraqitur Power Consumption: Max 10W, ka vlera teknike më të larta, që tejkalojnë maksimumin e konsumit të energjisë të përcaktuar në DST;

f) Në DST, për kamerat e brendshme kërkohet opsioni Ëireless, ndërsa modeli i paraqitur nuk e plotëson këtë kërkesë.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Në zbatim të **nenit 53**, pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”. Po kështu në nenin 53 pika 5 ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit...*” Në Dokumentet Standarde të Tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” përcaktohet: “*Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme*”.

- Me shkresën nr. 15/20 prot. datë 04.01.2017, miratohet procedura nga Titullari i AK dhe me shkresën nr. 15/21 prot. datë 04.01.2017, shpallet fitues operatori ekonomik, "E" sh.p.k me vlerë 7,377,777 lekë pa TVSH. Kontrata e shit-blerjes lidhet me nr. 15/23 prot. datë 10.01.2017 midis Universitetit Politeknik të Tiranës, përfaqësuar nga titullari i AK dhe OE "E" sh.p.k, me vlerë të kontratës 8,853,332 lekë me TVSH dhe me afat realizimi prej 20 ditësh.

- Sa më sipër, sikurse nga ankesat e paraqitura "S" sh.p.k, mbi dokumentet e tenderit, operatori ekonomik "F" sh.p.k është s'kualifikuar pikërisht pasi kamera e paraqitur prej tij e markës "D", rezultoi se specifikimet teknike të pajisjeve të ofruara nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në DST markës "H".

Pra nëse autoriteti kontraktor nuk do kishte përcaktuar termat e referencave të produkteve të markës "H" dhe të vendoste parametra normal cilësie, duke vendosur kritere që të nxisin konkurrencën dhe duke zgjeruar tregun e produkteve, atëherë OE "F" sh.p.k, do të ishte shpallur fitues me vlerë më të ulët.

Siç është përshkruar edhe më sipër, në termat e referencës të DST, asnjë kamerë apo produkt, nuk mund ti plotësojë plotësisht **100 %** specifikimet teknike të DST dhe diferenca midis 2 ofertave të kamerave të markave të ndryshme në vlerën **1,707,332 lekë me TVSH, përbën menaxhim jo me efektivitet dhe eficensë të fondeve të UPT.**

Në lidhje mbi problematikën e evidentuar sa më sipër, grupi i auditimit , ka mbajtur me AK e UPT-së, Aktkonstatim nr.10 prot.1003/11 datë 30.10.2017, për të cilën janë paraqitur observimet nr. 1361/3 prot. datë 06.11.2017, ku pretendohet se në dokumentet e tenderit nuk është dhënë ndonjë karakteristikë teknike që orienton prodhues të caktuar, nuk merret në konsideratë pasi të gjitha markat e paraqitura në observacion nuk i plotëson plotësisht karakteristikat teknike të kërkuara në DT.

3. Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të procedurës me objekt “Blerje dhe instalim gjeneratorësh për nevoja të UPT-së, për vitin 2016”

Nga auditimi i procedurës rezultoi se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

1. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nga auditimi u konstatua se:

- Me Urdhërin e titullarit të AK nr. 17 prot. datë 24.10.2016, është caktuar Dr. Ing. (pedagog pranë UPT-së), me cilësinë e ekspertit për hartimin e termave të referencës, i cili ka përcaktuar fondin limit në vlerën 9,988,171 lekë pa TVSH, pa e mbështetur dokumentacion me ofertat të marra nga tregu ose ndonjë kontratë të ngjajshme, *kjo në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VII, neni 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” pika 2*, ndërsa për punimet ndërtimore çmimet janë referuar, në përputhje me, VKM nr. 629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve tëknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.
- Me Urdhërin e titullarit të AK nr. 17/1 prot. datë 27.10.2016, “Për ngritjen e njësisë së prokurimit dhe hartimit të dokumenteve të tenderit”.
- Me Urdhërin e titullarit të AK nr. 17/4 prot. datë 27.10.2016, është ngritur, komisioni i vlerësimit të ofertave.

2. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi dokumentet e tenderit u konstatua se:

Nga auditimi, rezultoi se, mbi kriteret kualifikuese, ka pasur ankesë nga operatori ekonomik "F" sh.p.k me shkresën nr. 17/5 prot. datë 04.11.2016, i cili është njohur nga faqe zyrtare app.gov.al, ku ankohet, se *“specifikimeve teknike janë ekstremisht shumë specifike, për pasojë mund të sjellë kushtëzimin e konkurrencën dhe ka kërkuar nga, AK-ja, të rishikojë të gjitha specifikimet teknike në mënyrë që të rritet pjesëmarrja operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit”*. Mbi specifikimet teknike operatori ekonomik "Fat Group" sh.p.k, ka rekomanduar hollësisht kërkesat të cilat duhet të plotësojë gjeneratori si struktura mbështetëse, struktura e bazamentit, struktura e grupit, etj.

Gjithashtu OE"F" sh.p.k, ka sqaruar se në specifikimet teknike është kërkuar, shprehimisht: *“Sistemi ajrimit / aspirimit: turbo mbasftohjes ajer/ajer, Aspirimi i thate me filter ajri, Mbulesa e volantit: SA3, Kushtet e punes: Temperatura: $\leq 40^{\circ}\text{C}$, Sistemi i ftohjes: 50% uje + 50% paraflu 11, Lubrifikimi: Karakteristikat e vajit lubrifikues: E3/E5, Konsumi i vajit për lubrifikim: $< 0,1\%$ e lendes djegëse, Furnizimi me lëndë djegëse: Karakteristikat e lendes djegëse: EN 590*

Kapaciteti i baterive te ndezjes: 1x 100 Ah, Tensioni i alternatorit: 14 V, Rryma e karikimit të alternatorit:90 Amp, Sensorë PTC në pështjellët e gjeneratorit për mbrojtje kundër mbingarkesës”, duke pyetur AK nëse ofertohej një produkt me temperaturë pune $>40^{\circ}\text{C}$ do pranohej ose jo dhe nëse do pranohet nëse ofertohej bateri me kapacitet të ndezjes më të madh se 1x100Ah!!!!!!

Nisur nga këto kushte, AK, ka pezulluar procedurën, me Urdhërin e pezullimit nr. 17/6 prot. datë 07.11.2016, dhe ka ngarkuar anëtarët KVO për shqyrtimin e ankesave.

- Me vendimin nr. 17/7 prot. datë 07.11.2016, komisioni i shqyrtimit të ankesave nuk pranon ankesën e operatorit ekonomik "F" sh.p.k, ku sqaron se kërkesat teknike janë vendosur në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "Për prokurimin publik" neni 23 "Specifikimet teknike", pika 4 ku citon në mënyrë eksplicite:

Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.

Gjithashtu, nga auditimi operatori ekonomik "F" sh.p.k, mbasi ka marrë përgjigje negative nga AK, nuk e ka vazhduar ankimimin në Komisionin e Prokurimit Publik si dhe vlen të theksohet nuk është bërë pjesëmarrës në procedurën tenderuese.

Nga auditimi, i përgjigjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) argumenton se:

- Struktura mbështetëse. Cilësia S235JR, është standard botëror për llojin e çelikut. AK, ka kërkuar një produkt që të plotësojë një standard të njohur ndërkombëtar. Edhe për pjesët e tjera të specifikimit si bulloneria antivibruese me gomë, është një karakteristikë shumë e rëndësishme që lidhet me performancën e pajisjeve dhe si e tillë një produkt cilësor duhet ta ketë të inkorporuar. Në lidhje me ngjyrën e jashtme të gjeneratorit është përcaktuar në përputhje me LPP.

- Struktura e bazamentit. AK sqaron se është kërkesë e cila mund të realizohet nga çdo prodhues.

- Kërkesa për strukturën e grupit dhe asemblimit, janë përcaktuar qartë dhe përgjigjen se mund të realizohet nga çdo prodhues.

- Të gjitha sistemet, AK, arsyeton se parametrat e përcaktuara jepen në kufijtë minimal të pranueshëm dhe nuk përjashtojnë produkte me parametra teknikë të njëjtë apo më të lartë që mund të ofrohen nga operatorët ekonomik që operojnë në fushën e gjeneratorëve.

Për sa më sipër AK ka arsyetuar se ankesa është e pabazuar dhe nuk pranohet, duke i kthyer përgjigje OE "Fat Group" sh.p.k me shkresën nr. 17/9 prot. datë 07.11.2016.

3. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi vlerësimin e ofertave u konstatua se:

Në bazë të relacionit përmbledhës të KVO nr. 17/11 prot. datë 15.12.2016, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomikë si më poshtë:

1. "R&R ", është s'kualifikuar pasi:

Me shkresën e KVO nr. 17/10 prot. datë 30.11.2016, drejtuar operatorit ekonomik "R&R " sh.p.k, dërgohet kërkesa për konfirmimin e korigjimit të gabimeve aritmetike, pasi në ofertën ekonomike zëri B "Tub PVC me dopio izolim 75", ka diferencë vlere më pak në shumën 525 lekë. Oferta e paraqitur është 8,663,797 lekë, kur ndërkohë duhet të jetë 8,664,322 lekë pa TVSH. UPT i kërkon operatorit ekonomik të plotësojë kërkesën deri më datë 02.12.2016, ku njoftojnë se në rast të kundërt oferta do të refuzohet.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezultoi ndonjë përgjigje nga operatori ekonomik. OE nuk paraqiti brenda afatit të caktuar nga KVO, konfirmimin se pranon



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

korrigjimin e gabimit aritmetik, të konstatuar në ofertën ekonomike, sipas vlerës se rillogaritur nga KVO, në mbështetje të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, neni 66, pika 4, ku përcaktohet *“Nëse pas kërkesës së komisionit të vlerësimit të ofertave, ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë”*.

2. OE "A" sh.p.k, është s'kualifikuar pasi:

- Nuk ka paraqitur vërtetim nga një ose me shumë banka, ku provohet se disponon shumën më të madhe ose të barabarte me vlerën e fondit limit, përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2, germa c. Nuk ka paraqitur bilancin për vitin 2013, të konfirmuar nga administrata tatimore, përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2 germa a. Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në DST, pika 2.2, germa a, pasi nuk ka paraqitur vërtetimin e xhiros vjetore për vitin 2013. Në vërtetimin e paraqitur, nuk plotëson xhiron vjetore për vitin 2014, e cila është më pak se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet, konkretisht xhiro e vitit 2014 është 735,675 mijë lekë, ndërkohë që fondi limit është 9.988.171 lekë. Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në DST, pika 2.3, germa c, pasi inxhinieri mekanik për cilin ka paraqitur dokumentacion shoqërues, nuk figuron si drejtues teknik në licencën e shoqërisë.

3. OE "E " sh.p.k, është s'kualifikuar pasi:

-Nuk ka plotësuar kriterin e veçante të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3, germa c, pasi inxhinieret mekanik, për të cilët ka paraqitur dokumentacion, nuk figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në kriteret e kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3, germa e, pasi nuk ka paraqitur certifikatat ISO OHAS 18001:2007 dhe EN ISO 14001:2004.

4. OE "F " sh.p.k, është s'kualifikuar pasi:

-Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në, kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2, germa c, pasi sipas vërtetimi të lëshuar nga banka, në datën 17.11.2016, gjendja e llogarisë bankare është me e vogël se 10% fondit limit të kontratës që prokurohet, konkretisht gjendja e llogarisë është 605.000 lekë, ndërkohë që duhet të ishte 998.817 lekë. Vërtetimi tjetër bankar që mban datën 15.11.2016, është lëshuar më parë se 5 ditë, nga data e hapjes së ofertave, ndryshe përcaktimit në DST. Nuk plotëson kriterin e kapaciteti teknik, pika 2.3, germa b, pasi nuk ka paraqitur licencën e shoqërisë me kategoritë përkatëse. Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në kapacitetin teknik, pika 2.3, germa c, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin për inxhinierin mekanik. Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3, germa d, pasi nuk ka paraqitur vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar, mesatarisht 10 punonjës. Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në kapaciteti teknik, pika 2.3, germa e, pasi nuk ka paraqitur certifikatën ISO OHAS 18001:2007.

5, 6. "W " sh.p.k , "B360" sh.p.k janë s'kualifikuar pasi nuk ka paraqitur ofertë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Nga auditimi, rezultoi se skualifikimi i operatorëve ekonomikë është bërë në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve, nga ana e KVO-së si dhe asnjë prej operatorëve të skualifikuar nuk ka paraqitur ankesë pranë AK.

7. Nga verifikimi i OE fitues "S " sh.p.k, konstatohet se është kualifikuar në përputhje me DST dhe ligjin e LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, *por kanë disa sekueca të paqarta, si katalogët / skedat teknike / apo skicat e produkteve.*

4. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi dorëzimin e mallrave:

-Kontrata e shit-blerjes është nënshkruar me nr. 17/15 prot. datë 19.12.2016 midis AK i përfaqësuar nga Titullari i AK, dhe operatorit ekonomik "S ", me afat lëvrimi të mallit 30 ditë. Me urdhrin nr. 107 prot. datë 20.12.2016, ngrihet komisioni i marrjes në dorëzim dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim të mbajtur në 30.12.2016, konstatohet se janë furnizuar dhe vendosur gjeneratorët në afatet e përcaktuar të kontratës. Gjeneratorët dhe aksesoret e tjerë nuk shoqërohen me dokumentacione shtesë, kataloge apo skeda teknike, që të konfirmohen të gjitha parametrat teknikë të kërkuara nga AK dhe nëse është arritur qëllimi i blerjes dhe instalimit të mallit.

-Për pasojë, Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, nuk mund të jepte opinion e tij, për plotësimin e të gjithë karakteristikave teknike të gjeneratorëve, ku nga AK duhet të merren masa për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përjashtuar ata që kanë marrë pjesë në marrjen në dorëzim), të cilët të kryejnë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojnë parametrat e gjeneratorëve të kërkuara në DST, të cilat nuk pasqyrohen në katalogë, si dhe të konfirmohet që këto gjeneratorë arrijnë të plotësojnë qëllimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje mbi problematikën e evidentuar sa më sipër, grupi i auditimit , ka mbajtur me AK e UPT-së, Aktkonstatimi nr.7 prot.1003/8 datë 30.10.2017, për të cilën janë paraqitur observimet nr. 1361/2 prot. datë 06.11.2017, ku pretendohet se furnizimi i gjeneratorëve është realizuar sipas karakteristikave teknike, sqarojmë se detajet për përcjellësat, kabllot, niveli akustik apo sistemi i shkarkimit të gazeve, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk konfirmoheshin apo paraqiteshin në kataloge, për rrejdhojë observacioni nuk merret në konsideratë.

4. Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të procedurës me objekt “Blerje pajisje kompjuterike e servera për nevojat e UPT-së, i ndarë në 3 Lote, për vitin 2016”

Nga auditimi i procedurës rezultoi se:

1. Hartimi, specifikimet teknike, kriteret kualifikuese dhe hartimi i fondit limit.

Nga auditimi rezultoi se, specifikimet teknike janë përpiluar bazuar në kërkesat e njëjësive, normativat e projektimit, standartet europiane. Vlera e përlllogaritur e kontratës është hartuar me studim të tregut në bazë të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VII, neni 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

- LOT I, "Pajisje kompjuterike dhe videoprojektorë" ,
- LOT II, "Pajisje për infrastrukturën hardëare për instalimin lokal të sistemit U-GOV".
- LOT III, "Blerje pajisje kompjuterike për fakultetin gjeologji-miniera".

Mbi kriteret kualifikuese të LOT II "Pajisje për infrastrukturën hardëare për instalimin lokal të sistemit U-GOV", ka pasur ankesë nga operatori ekonomik "B "sh.p.k me shkresën nr. 19/5 prot. datë 08.11.2016, në lidhje mbi kriteret kualifikuese, ku shprehet, se “kriteret kualifikuese të vendosura nga AK, konkretisht operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi për shitjen dhe suportin e platformës VMware për territorin e Shqipërisë, kërkesa e mësipërme është cilësuar nga OE "B " sh.p.k, se kufizon konkurrencën në ofrimin e produkteve të VMware, duke marrë parasysh se ekzistojnë kompani prodhuese ndërkombëtare që ofrojnë produkte ekuivalente ose superiore në bazë të konfigurimit dhe kërkon informacion se përse duhet të jetë autorizuar nga VMware dhe jo nga Microsoft, Citrix, etj. Kriteri kualifikues tjetër është se nga AK kërkohet që operatori ekonomik duhet të zotërojë status partneriteti Enterprise si Solution Provider me prodhuesin e platformës së virtualizimit, duke pretenduar se një nivel partneriteti të tillë e sigurojnë vetëm 2 kompani, për pasojë mund të sjellë kushtëzimin e konkurrencën dhe ka kërkuar nga, AK-ja, të rishikojë të gjitha specifikimet teknike në mënyrë që të rritet pjesëmarrja operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit”.(Nga auditimi rezultoi se standarti i formatit të ankesës nuk është i saktë).

-Nisur nga këto kushtë, me shkresën titullarit të AK-së, nr. 19/6 prot. datë 09.11.2016, njofton operatorin "B "sh.p.k, i shprehet se nuk është përdorur standardi i formatit të ankesës dhe ka pasaktësi në përmbajtje të ankesës pasi i drejtohet Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe ka mangësi në referencën ligjore. Me shkresën nr. 19/7 prot. datë 10.11.2016, operatori ekonomik korrigjon pasaktësitë në ankesën e tij.

- Me Urdhërin e titullarit nr. 19/8 prot, datë 10.11.2016 pezullohet procedura e LOT II, deri në shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik dhe me rekomandimin e specialistit të IT, me shkresë nr. 19/9 prot, datë 14.11.2016, është vlerësuar se ankesa është jashtë afateve ligjore në përputhje me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 4, pasi publikimi i tenderit është realizuar më 01.11.2016 dhe me shkresën e titullarit të AK-së, nr. 19/10 prot, datë 14.04.2016, nuk është pranuar ankesa dhe është vazhduar procedura e prokurimit. Me shkresën e titullarit nr. 19/11 prot. datë 14.11.2016, i kthehet përgjigje OE "B " sh.p.k, mbi ankesën e tij për dokumentet standarde të tenderit.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se, AK me nismën e vetë , ka ndryshuar dokumentet e tenderit, kjo në përputhje ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 42, pika 2, ku ndryshimi është paraqitur në DST pranë app.gov.al si dhe me shkresën nr. 19/12 prot. datë 14.11.2016, për LOTIN II "Pajisje për infrastrukturën hardëare për instalimin lokal të sistemit U-GOV" si më poshtë :

-Pika i) ishte “Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesit respektive për shitjen e licencave Oracle dhe Microsoft për territorin e Shqipërisë.” Bëhet “Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesit ose distributor i autorizuar respektivisht për shitjen e licencave Red Hat dhe Microsoft për territorin e Shqipërisë.”



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

-Pika 3/k ishte “Të paktën 2 specialiste të certifikuar për pajisjen Storage që do të ofertohej.” Bëhet “Te paktën 2 specialiste të certifikuar te nivelit arkitekt për zgjidhjet bazuar mbi pajisjen Storage që do te ofertohej.”

-Pika 4/k ishte “Të paktën 2 specialiste të certifikuar për pajisjet server.” Bëhet “Të paktën 2 specialiste të certifikuar, ku njeri të jetë i nivelit arkitekt per zgjidhjet bazuar mbi pajisjet server që do të ofertohej dhe tjetri të ketë aftësi profesionale teknike për zgjidhjet në pajisjet server.”

-Pika l) ishte “Operatori ekonomik duhet të përfshijë në stafin e angazhuar në projekt të paktën një administrator projekti, me eksperience të paktën 5 vjeçare ne menaxhimin e projekteve, të vërtetuar nëpërmjet CV-së.” Bëhet “Operatori ekonomik duhet të përfshijë në stafin e angazhuar në projekt të paktën një administrator projekti, me eksperience të paktën 5 vjeçare në menaxhimin e projekteve, të vërtetuara nëpërmjet CV-së si dhe certifikatave të lëshuar nga organizmat ndërkombëtare të njohur në këtë fushë.

Shtohet pika q) “Operatori ekonomik për artikujt pajisje që oferton, duhet të paraqesë katalogët ose broshurat me të dhënat teknike ku të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt pajisje që oferton sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST.

Nga auditimi, u vërejt se, Kriteret kualifikuese të ndryshuara nuk janë argumentuara plotësisht, por vetëm me thënien “ishte” dhe “bëhet”, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2 ku citohet “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

2. Zhvillimi i procedurës tenderuese.

a) LOT I, me raportin përmbledhës nr. 19/30 prot. datë 10.01.2017, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik si më poshtë vijon:

1. "B " sh.p.k është s'kualifikuar pasi:

Nga KVO-ja, me shkresën nr. 19/13 prot, datë 07.12.2016, është kërkuar sqarime të dokumentacionit të dorëzuar mbi përputhshmërinë e produkteve të objektit prokurimit për LOT I dhe LOT III, ku rezultoi se specifikimet teknike të pajisjeve nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në DST. Nuk plotëson modelin e ekranit të projektimit, pasi modeli është "Tripod Standard 150", i cili nuk është në përputhje me specifikimet e modelit të kërkuar në DT, pasi është kërkuar ekran projektimi që vendoset në mur dhe elektrik.

Modeli i paraqitur nga OE "B " sh.p.k është Tripod Standard 150, i cili nuk vendoset ne mur por vendoset në këmbalec dhe nuk është me motor elektrik por është manual. Gjithashtu nuk plotëson faktorin e fuqisë Poëer factor për ups infosec 1000 va, pasi ne dokumentet e tenderit është kërkuar 0.8 pf ndërkohe që OE ka paraqitur 0.5pf, d.m.th me parametër me te vogël.

2. "S " sh.p.k është s'kualifikuar pasi:

-Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të kapaciteti teknik. AK me shkresën nr. 19/14 prot. datë 07.12.2016 kërkon sqarime të dokumentacionit të dorëzuar mbi përputhshmërinë e



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

produkteve. OE "S " sh.p.k pas kërkesës për sqarim të KVO, mungon modeli i perdes së projektimit në dokumentacionin e paraqitur.

3. "P " sh.p.k është s'kualifikuar pasi:

1. Modeli i perdes së projektimit Acer M87-S01MË, sipas katalogut të paraqitur është manual, pra hapja dhe mbyllja e ekranit bëhet me dorë në mënyre manuale dhe jo nëpërmjet motorit elektrik, siç është kërkuar në specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit.

Nga verifikimet mbi çmimet e perdeve në ëeb, konstatohet se çmimi i perdes elektrike është minimalish dyfishi i çmimit të perdes manuale dhe nga KVO nuk mund të konsiderohej si devijim i vogël në përputhje me LPP.

2. Printer Lexmark MS415dn nuk plotëson specifikimin teknik të shpejtësisë së printimit, pasi sipas katalogut, shpejtësia e printimit është 38 faqe për minute dhe jo 40 faqe për minute siç është kërkuar në specifikimet teknike të DT, por kjo nga KVO mund të konsiderohej si devijim i vogël.

3. workstation HP z 240 Tower, nuk plotëson specifikimin teknik “Speakers”, pasi nuk është as “internal” dhe as “Built-in Monitor”, siç kërkohet në specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit.

4. Monitori HP P222va si pjese integrale e njësisë qendrore të kompjuterit desktop tipi 1 HP ProDesk 400 G3, nuk plotëson specifikimin teknik “Koha e Rifreskimit “Response Time”. Ky specifikim teknik në monitorin HP P222va është “8ms” nga “5ms” të kërkuar në specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit.

5. Monitori HP P222va si pjese integrale e njësisë qendrore të kompjuterit desktop tipi 2 HP 280G2, nuk plotëson specifikimin teknik “Koha e Rifreskimit “Response Time”. Ky specifikim teknik në monitorin HP P222va është “8ms” nga “5ms” të kërkuar në specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit.

- Mbi vlerësimin e ofertave është bërë ankesë në AK nga operatori "P " sh.p.k me shkresën nr. 19/24 prot, datë 20.12.2016, ku pretendon se s'kualifikimi është i padrejtë, ku pretendon se disa nga pikat e s'kualifikimit janë devijime të vogla (monitorët) dhe në pikat e tjera pretendon se ndodhen në katalogët përkatës dhe në magazinën e tij, duke kërkuar kualifikimin e ofertës dhe të shpallet fitues.

Me shkresën e titullarit të UPT nr. 19/25 prot. datë 20.12.2016, pezullohet procedura për shqyrtimin e ankesës. Me shkresën nr. 19/26 prot. datë 23.12.2016 të përgjegjëses të Dep. Juridik, për shqyrtimin e ofertës, rekomandon titullarit të AK të mos pranohet ankesa pasi pretendimet e OE "P " sh.p.k, nuk qëndrojnë dhe në përputhje me LPP nuk mund të vlerësojë argumentimin se produktet ekzistojnë në treg dhe në magazinën e operatorit. Me urdhrin e titullarit të AK nr. 19/27 prot, datë 23.12.2016, hiqet pezullimi i procedurës dhe me shkresën nr. 19/28 prot. datë 23.12.2016 i kthehet përgjigje operatorit ekonomik mbi mospranimin e ankesës. Nga auditimi, rezultoi se skualifikimi i operatorëve ekonomikë është bërë në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve, nga ana e KVO-së dhe nuk ka pasur ankesa të tjera, pranë AK.

- Në përfundim Komisioni i vlerësimit të ofertave, i propozon titullarit të AK të shpall fitues operatorin ekonomik "I " sh.p.k me shkresën nr. 19/29 prot. datë 10.01.2017 dhe procedura e prokurimit miratohet me shkresën 19/31 prot. datë 10.01.2017.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

- Kontrata lidhet me nr. 19/38 prot. datë 24.01.2017 midis Universitetit Politeknik të Tiranës, përfaqësuar nga titullari i AK dhe OE "I " sh.p.k, me vlerë të kontratës 11,369,856 lekë me TVSH dhe me afat realizimi prej 45 ditë.

- Me urdhër shpenzimi nr. 562 datë 04.05.2017 realizohet pagesa prej 11,313,007 me TVSH. Dorëzimi i fundit i implementimit është më datë 09.03.2017 brenda afateve kontraktuale.

b) LOT II, me raportin përmbledhës nr. 19/8 prot. datë 12.12.2016, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik .

Në përfundim Komisioni i vlerësimit të ofertave, i propozon titullarit të AK të shpall fitues operatorin ekonomik "I " sh.p.k dhe me shkresën nr. 19/19 prot. datë 12.12.2016 miratohet procedura e prokurimit.

- Kontrata lidhet me nr. 19/22 prot. datë 28.12.2016 midis Universitetit Politeknik të Tiranës, përfaqësuar nga titullari i AK dhe OE "I " sh.p.k, me vlerë të kontratës 25,585,488 lekë me TVSH dhe me afat realizimi prej 120 ditësh të implementimit dhe 1 vit të shërbimit të mirëmbajtjes.

- Me urdhër shpenzimi nr. 561 datë 04.05.2017 realizohet pagesa prej 22,388,486 me TVSH, duke zbritur shërbimin e mirëmbajtjes. Dorëzimi i fundit i implementimit është më datë 20.04.2017 brenda afateve kontraktuale dhe vazhdon shërbimi i mirëmbajtjes.

c) LOT III, me raportin përmbledhës nr. 19/35 prot. datë 09.01.2017, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik si më poshtë vijon:

Në përfundim Komisioni i vlerësimit të ofertave, i propozon titullarit të AK të anulojë procedurën dhe me urdhrin nr. 19/36 prot. datë 09.01.2017 anulohet procedura e prokurimit, për shkaqe si më poshtë vijon:

1. Operatorët "S " sh.p.k dhe "E " sh.p.k, janë s'kualifikuar pasi nuk kanë paraqitur ofertë ekonomike.

2. Operatori "B " sh.p.k është s'kualifikuar pasi nuk plotëson specifikimet teknike për modelin e ekranit të projektimit, pasi modeli i propozuar nga ana e operatorit ekonomik është i tipit Tripod Standard 150, në përgjigje të shkresës të AK nr. 19/13 prot. datë 07.12.2016. Modeli i ekranit të projektimit nuk është në përputhje me specifikimet e modelit të kërkuar në dokumentet e tenderit, pasi është kërkuar ekran projektimi që vendoset në mur dhe elektrik. Ndërkohë, modeli Tripod Standard 150 nuk vendoset në mur por vendoset në këmbalec dhe gjithashtu, ai nuk është elektrik me motor por është manual.

Me shkresën e titullarit nr. 19/37 prot. datë 09.01.2017, njofton Agjencinë e Prokurimit Publik mbi anulimin e procedurës së tenderit LOT III *"Blerje pajisje kompjuterike për fakultetin gjeologji-miniera"*, pasi asnjë ofertë ekonomike nuk është e suksesshme.

Procedura e tenderimit të LOT III, nuk është përsëritur dhe nuk ka filluar ekzekutimin e një procedure të re, duke mos argumentuar realizimin e qëllimit të prokurimit për blerjen e pajisjeve kompjuterike për fakultetin e Gjeologji-Miniera. Në përputhje me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VIII, neni 73, pika 2 ku citohet :



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Autoriteti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës dhe i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës.

Në lidhje mbi problematikën e evidentuar sa më sipër, grupi i auditimit, ka mbajtur me AK e UPT-së, Aktkonstatimi nr.8 prot. 1003/9 datë 30.10.2017, për të cilën janë paraqitur observimet nr. 136/5 prot. datë 06.11.2017, ku pretendohet se kriteret kualifikuese janë në përputhje me dispozitat ligjore, sqarojmë si më poshtë:

Në lotin e II, ku kërkohet se operatori ekonomik të jetë i autorizuar nga prodhuesi për shitjen dhe suportin e platformës VMware për territorin e Shqipërisë, kufizon konkurrencën në ofrimin e produkteve të VMware, duke marrë parasysh se ekzistojnë kompani prodhuese ndërkombëtare që ofrojnë produkte ekuivalente ose superiore në bazë të konfigurimit. Kriteri kualifikues i zotërimit të statusit partneriteti Enterprise Solution Provider me prodhuesin e platformës së virtualizimit, në tregun Shqiptar ekzistojnë shumë pak kompani, duke krijuar oligopol të konkurrencës dhe në këtë këndvështrim observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

5.Auditimi mbi procedurën me objekt “Blerje orendi dhe pajisje zyre për nevojat të Njësive të Universitetit Politeknik të Tiranës” (Procedurë e hapur) viti 2016.

1.Hartimi, specifikimet teknike dhe hartimi i fondit limit.

Specifikimet teknike janë përpiluar bazuar në kërkesat e njësive, normativat e projektimit, standartet europiane. Këto specifikimet teknike janë përpiluar posaçërisht për mobilimin dhe kompletimin e ambjenteve mësimore, zyrave apo sallave të secilës njësi kryesore të UPT, i cili ka funksionin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe përfshijnë specifikimet për mobilimin, jo vetëm të Njësive Kryesore të Universitetit politeknik të Tiranës, bazuar në kërkesat e secilës prej këtyre njësive, por edhe për të gjithë ambientet në shërbim të zhvillimit të procesit mësimor të objektit të ri universitar “Shtesë e Korpusit Qëndror të Universitetit Politeknik të Tiranës”. Secili ambient në këtë objekt të arsimit të lartë, është projektuar në përputhje me funksionin (Objekti është ndërtuar me Leje Zhvillimore Komplekse).

Mobilimi i secilit prej këtyre ambienteve, është dizenuar në mënyrë të veçantë, në përputhje me përmasat, formën dhe destinacionin e ambjentit, qoftë ky sallë leksionesh, klasë, laborator, sallë mbledhjesh, zyrë punonjësish apo zyrë ekzekutive. Kërkesat për mobilim të secilës njësi kryesore të UPT, janë bazuar në nevojat për kompletim të ambienteve ekzistence mësimore, me qëllim zëvendësimin e mobiljeve që nuk mund të riparohen, si dhe modernizimin, apo përmirësimin e cilësisë infrastrukture të ambienteve në shërbim të zhvillimit të procesit mësimor. Mobilimi i ambjenteve arsimore bazohet në Normativat Specifike të Projektimit dhe Standarteve Europiane të Mobilimit të Ambienteve Arsimore, duke zgjedhur numrin, përmasat dhe format e mobiljeve në përputhje me formën dhe përmasat e hapësirës së ambientit mësimor dhe llogaritjeve të maksimumit të numrit të studentëve në ambient.

Përmasat dhe forma e secilës mobilje duhet të përputhen me skicat shoqëruese dhe këta parametra në asnjë rast nuk duhet të jenë më të vegjel se minimumet e përcaktuara në Standartet Europiane, ndërkohë që disa nga këta parametra në standarte janë taksative dhe fikse, prandaj dhe duhet të zbatohen detyrimisht.

2.Zhvillimi i procedurës tenderuese.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Në datën 07.05.2016 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “procedurë e Hapur” me objekt “Blerje orendi dhe pajisje zyra për UPT”, me nr.REF-36922-05-07-2016 , procedurë e parashikuar për tu zhvilluar në datën 01.06.2016 nga autoriteti kontraktor Universiteti Politeknik Tiranë.

Në datën 01.06.2016 Rektori i UPT dhe jo titullari i AK, me anë të shkresës nr.702.prot datë 01.06.2016 vendosi “Anulimin e procedurës së prokurimit të mësipërme. Të ndodhur në këto, operatori ekonomik “E”shpk ka paraqitur fillimisht kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e këtij të fundit për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi si dhe duke kërkuar informacion mbi anulimin e procedurës.Në ankesën drejtuar , pala ankimuese kundërshton vendimin e paraqitur në SPE, pasi, janë hapur ofertat, përfaqësuesit e OE, u informuan se procedura e prokurimit anulohet për një arsye që lidheshin me DST, ndërsa në SPE është dhënë arsyetimi për “rishikim të preventivit”. Kjo ankesë është trajtuar dhe nga KPP , i cili është shprehur me Vendimin nr.530/2016.

Gjatë auditimit, rezultoi se, edhe grupi i audituesve është me të njëjtin arsyetim të Vendimit të KPP-së, të cilin po e parashtrijmë si më poshtë vijon:

Kjo situatë është krijuar për shkak të interpretimeve të ndryshme të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike mes rektorit të Universitetit dhe Administratorit në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve të autoritetit kontraktor në drejtim të anulimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, por intepreton parashikimet ligjore të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar. Në rastin konkret pretendimi i ngritur nga autoriteti kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit me argumentin se “për disa ndryshime në preventive” nuk është një shkak që del jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit me argumentimin se “për disa ndryshime në preventive” nuk është një shkak që del jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe i pa parashikueshëm në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, pasi është përgjegjës vetë autoriteti kontraktor, për hartimin e Urdhërit të prokurimit dhe përllogaritjes së sasisë së saktë të mallrave/shërbimeve/punëve objekt i kontratës së prokurimit.

Gjithashtu, njoftimi i anulimit të procedurës dhe dërgimi i njoftimit në APP është kryer në kundërshtim të ligjit për prokurimin publik, pasi autoriteti kontraktor duhet të respektonte afatet e ankimimit prej 7 ditë në autoritetin kontraktor dhe më pas prej 10 ditë që ligji i njej të drejtë operatorit ekonomik ankimues për të ushtruar të drejtën e ankimimit pranë KPP-së. Në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar , neni 63, pika 6, përcaktohet se: *“nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë,ankimuesi mund të paraqesë një ankesë brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 diteve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”*. Kështu, sa më lart, autoriteti kontraktor në procedurat e ardhshme të prokurimit të respektojë afatet e ankimimit të parashikuara në ligjin e prokurimit publik.

3.Lidhja dhe monitorimi i kontratës me objekt “Blerje orendi dhe pajisje zyra për UPT”.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Në datën 15.08.2016 nga ana e KPP-së është dërguar vendimi nr.530/3/2016 për heqjen e pezullimit të procedurës dhe vazhdimin e saj, për pasojë dhe titullari i AK-së, me urdhërin nr.9/8prot, datë 16.08.2016, u hoq pezullimi dhe vazhdoi në fazën në të cilën ndodhej, atë të hapjes së ofertave.

Tenderi u hap në datën 16.08.2016, KVO ka evidentuar se janë paraqitur 7 (shtatë) operatorë ekonomikë, nga të cilët janë skualifikuar 5 (pesë) OE. Nga auditimi, nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, rezultoi se, skualifikimi i tyre është bërë në përputhje me nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se “AK, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”, më konkretisht:

1.E shpk, nuk ka plotësuar kriterinnë pikën 2.2, germa c, kapaciteti ekonomik dhe financiar, nuk ka plotësuar pikën 8, kapacitetin teknik, kriteret e veçanta të kualifikimit.

2.B shpk, nuk ka paraqitur dokumentacionin e përgjithshëm të kualifikimit, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1, germa a,b,c, nuk ka paraqitur dokumentacionin për kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2, germat a,b,c, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3, pika 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12; nuk ka paraqitur ditën e hapjes së tenderit mostrat fizike për artikujt e kërkuar nga AK në DST; nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

3.B shpk; nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kërkuar në kriteret e përgjithshme; nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1, germa a,b,c, nuk ka paraqitur dokumentacionin për kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2, germat a,b,c, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3, pika 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12; nuk ka paraqitur ditën e hapjes së tenderit mostrat fizike për artikujt e kërkuar nga AK në DST; nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

4.M shpk; nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kërkuar në kriteret e përgjithshme; nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1, germa a,b,c, nuk ka paraqitur dokumentacionin për kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2, germat a,b,c, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3, pika 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12; nuk ka paraqitur ditën e hapjes së tenderit mostrat fizike për artikujt e kërkuar nga AK në DST; nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

5.P shpk; nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kërkuar në kriteret e përgjithshme; nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1, germa a,b,c, nuk ka paraqitur dokumentacionin për kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2, germat a,b,c, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3, pika 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12; nuk ka paraqitur ditën e hapjes së tenderit mostrat fizike për artikujt e kërkuar nga AK në DST; nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Pasi ka mbaruar afati ligjor për paraqitjen e ankesave të cilat nuk ka pasur, kështu nisur në këto kushte autoriteti kontraktor, ka shpallur fituesin me vendimin nr.9/12 prot datë 09.09.2016 me



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

operatorin ekonomik “Erzeni” shpk me vlerë të ofertës prej 36,900,040 lekë pa tvsh, duke lidhur lidhur kontratën nr.9/14 prot datë 26.09.2016.

Në zbatim të kontratës së mësipërme, është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave , me Urdhërin nr.83, datë 25.10.2016, i cili ka verifikuar në bazë të proces-verbalit të datës 17.11.2016, duke konstatuar se UPT është furnizuar me mallrat për “Blerje orendi dhe pajisje zyre për nevoja të UPT”, sipas kërkesave, specifikimeve teknike me sasinë, cilësinë e kërkuar , të përcaktuara në kontratën e furnizimit dhe dokumentat e tenderit.

Pagesa është realizuar me Urdhër-shpenzimi nr.1801 datë 29.12.2016, në bazë të faturave tatimore të lëshuara nga operatori ekonomik, nr.761, datë 17.11.2016; nr.759 datë 17.11.2016; nr.762 datë 20.11.2016; nr.764 datë 20.11.2016, nr.766 datë 19.11.2016; nr.768 datë 19.11.2016; nr.769 datë 20.11.2016; nr.770 datë 20.11.2016; nr.771 datë 21.11.2016; nr.773 datë 22.11.2016; nr.774 datë 22.11.2016; nr.775 datë 22.11.2016; nr.778 datë 23.11.2016; nr.777 datë 23.11.2016; nr.788 datë 24.11.2016; nr.789 datë 24.11.2016 dhe nr.787 datë 24.11.2016.

6. Mbi auditimin mbi procedurën me objekt “Vlerësimi strukturor dhe rikualifikimi i ndërtesave të Universitetit Politeknik të Tiranës”,(procedura Shërbim Konsulence), viti 2016.

Kjo procedurë është iniciuar në mbështetje të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, VKM nr.704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” si dhe bazuar në rekomandimin e grupit të punës të ngritur me Urdhërin nr.49, datë 10.09.2013 me qëllim hartimin e detyrës së projektimit për projektin “Vlerësimi strukturor dhe rikualifikimi i ndërtesave të Universitetit Politeknik të Tiranës, PBA 2016-2018”.

Me Urdhër nr.29 datë 04.03.2016 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e detyrës së projektimit për projektin “Vlerësimi strukturor dhe rikualifikimi i ndërtesave të Universitetit Politeknik”, të cilët kanë paraqitur AK, detyrë Projektimi, ku qëllimi kryesor është, vlerësimi strukturor i ndërtesave të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe marrja e masave të nevojshme inxhinierike për plotësimin e normave dhe standarteve vendase dhe europiane për siguri strukturore dhe mirëfunksionimin e tyre. Krahas qëllimit kryesor synohet përgatitja e një metodologjisë, e cila duhet ndjekur përmbushjen e kërkesave të caktuara nga kjo detyrë projektimi.

Nga auditimi i detyrës së projektimit, gjithashtu rezultoi se, ekzistojnë Detyra e projektimit realizuar në mars 2016 dhe Shtojcë e detyrës së projektimit realizuar në tetor 2016.

Në Detyrën e projektimit të mars 2016, është parashikuar që ndarja e projektit në Lote si më poshtë:

Lot 1). Ndërtesa e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit.

Lot 2). Ndërtesa e Korpusit Qëndror të UPT (dy ndërtesat në pjesën e pasme).

Lot 3). Ndërtesa e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike.

Lot 4). Ndërtesa e Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

Ndërsa , në Shtojcë e detyrës së projektimit realizuar në tetor 2016, është argumentuar se, për arsye të kufizuar , në këtë fazë, objekti i shërbimit të kërkuar nga Konsulenti janë vetëm tre lotet e parë, të cilët përfaqësojnë objektet që kanë nevojë më emergjente për ndërhyrje. Konsulenti



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

duhet të ofrojë vetëm shërbimin e kërkuar nga Autoriteti kontraktor(UPT), ku secili zë i shërbimeve të kërkuara do të përpilohet në përputhje me nenin 25 të Manualit të Tarifave dhe Shërbimeve në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kalaudim të miratuar me VKM nr.354 datë 11.05.2016.

Nga auditimi rezultoi se, nga Titullari i AK (Administratori), janë përfshirë në komisionin e vlerësimit të ofertave me të cilët është hartuar Kontratë me kohe të pjeshme, me nr.16/4 prot datë 27.10.2016 dhe nr.16/5 prot datë 27.10.2016, për aktivizimin e përkohshëm të tyre si ekspertitë të jashtëm në fushën e prokurimit publik në komisionet e vlerësimit të ofertave , në bazë të profesioneve si inxh.ndërtimi dhe arkitekt , duke mos paraqitur asnjë dokumentacion për të vertetuar faktin që janë eksperte te fushës, kjo në kundërshtim ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 58.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se, është hartuar Raporti Përmbledhës, me shkresë nr.16/11prot datë 04.01.2016, i cili në përmbajtje, nuk kanë përshkruar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “E”shpk, të cilat janë paraqitur vetëm në procesverbalin e datës 14.11.2016 nga KVO, pra nuk është hartuar në përputhje me nenin 68 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga auditimi me REF-55384-10-27-2016, në sistemin elektronik të prokurimit rezultoi se nga ana e AK, skualifikimi dhe kualifikimi i pjesëmarrësve në tender është bërë në përputhje me nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Në zbatim të Kontrata për “Projekt për vlerësimin strukturor dhe rehabilitimin e ndërtesave të Universitetit Politeknik të Tiranës” nr.16/16 prot , datë 09.01.2017, është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të projektit , me Urdhërin nr.19, datë 09.03.2017,në mbështetje të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin e ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, kapitulli 2, pika 42.Komisioni ka kryer verifikimin e përputhshmërinë së shërbimit në fushën e projektimit,ku operatori ekonomik ka dorëzuar projektet dhe preventivat korrespondente për secilin objekt, në përputhje me kontratën dhe dokumentat e tenderit.

Pagesa është realizuar me Urdhër-shpenzimi nr.916 datë 04.07.2017, sipas faturës tatimore nr.9 datë 09.04.2017, me vlerën prej 9,991,200 lekë me TVSH.

Grupi i auditimit, evidentoi se deri në momentin e hartimit të këtij materiali, nga UPT nuk është siguruar burimi i financimit, për të realizuar investimin, në lidhje me shërbimin e projektimit të mësipërm.

7. Mbi auditimin mbi procedurën me objekt “Blerje dokumentacioni specifik” (procedura Kërkesë për propozim), viti 2014.

Kjo procedurë është iniciuar, në bazë të kërkesave të ardhura nga njësitë shpenzuese fakultetteve, për të pajisur në kohë për studentët me diploma Bachelor, Diploma shkencore, kapak diplome, librezë studenti etj.

Nga auditimi rezultoi se, nga njësia e Prokurimit, e ngritur në fillim të vitit 2014 me Urdhër të Titullarit, përllogaritet e fondit limit e kanë mbështetur në ofertat e marra në treg, të cilat janë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

marrë nga këto operatorë ekonomikë (Shtëpia Botuese Shtypshkronja I; II dhe D), të cilët në ofertat e dorëzuar pranë UPT, nuk kanë të pasqyruar në vulën e tyre NIPT-in. *Ky fakt nuk të jep mundësinë për të parë nga grupi i KLSH-së, aktivitetin , objektin e operatorëve në fushën e prodhimit të matërialiave (karton dilpome, kapak diplome, libreza studenti etj), i cili është në kundërshtim me ligjin e prokurimeve dhe me bazën ligjore të sistemit të tatim-taksa, për operimin e subjekteve që kanë paraqitur ofertat.*

-Me shkresën nr.10/4 prot datë 27.05.2014 NjP, ka përgatitur ftesën për 5 operatorë ekonomikë,në bazë të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” , kreu VI, pika b,c (Kërkesa për propozime) , ku thuhet se “...Gjatë veprimtarisë (përgatitja e kërkesës dhe vlerësimi i propozimeve) duhet të mbahet procesverbal i prokurimit...”, gjë e cila për kërkesën e berë drejt 5 operatorëve ekonomikë Njësia e prokurimit nuk e ka relatuar në dosjen fizike.

8.Mbi auditimin e procedurës me objekt “Blerje orendi dhe pajisje zyre” (procedurë “Kërkesë për propozime” viti 2014.

-Nga auditimi, i përllogaritjes së fondit limit, rezultoi se AK, ka marrë ofertat pranë operatorëve ekonomikë që operojnë në tregun shqiptar, por operatorët si “E” (import-export-prodhim), “E”shpk dhe “B”shpk, të cilët në ofertat e dorëzuar pranë UPT, nuk kanë të pasqyruar në vulën e tyre NIPT-in. *Ky fakt nuk të jep mundësinë për të parë nga grupi i KLSH-së, aktivitetin , objektin e operatorëve në fushën e prodhimit të matërialiave (karton dilpome, kapak diplome, libreza studenti etj), i cili është në kundërshtim me ligjin e prokurimeve dhe me bazën ligjore të sistemit të tatim-taksa, për operimin e subjekteve që kanë paraqitur ofertat.*

-Nga auditim rezulton se pranë Ak, është depozituar ankesa me nr. 1469 datë 06.11.2014, nga operatori ekonomik “H”shpk, me objekt ankesë, ndryshimin e vlerësimit të KVO-së, për skualifikimin e saj, si dhe shpalljen fituese të operatorit ekonomik pasi vlera ekonomike është më e ulta.

Nga auditimi në faqen zyrtare të app-së,dhe nga përgjigja, e cila është formuluar në zbatim të urdhërit nr.1/6 prot, datë 06.11.2014, është shqyrtuar ankesa,me përgjigje korrekte dhe bazuar në bazën ligjore të prokurimit publik, pasi:

Oferta e operatorit ekonomik “H” shpk, është skualifikuar nga procedura e prokurimit në përputhje me ligjin “Për prokurimet publike”, për mosplotësim të kriterëve të vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika8, 7 dhe kapaciteti ekonomik dhe financiar, gërma a, si më poshtë:

-Nuk ka paraqitur listëpagesat për periudhën Janar-gusht 2014; nuk ka paraqitur vërtetimin nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën janar-korrik 2014; referuar vërtetimin e lëshuar nga administrata tatimore për numrin e punonësve të siguruara për muajin Gusht 2014, rezulton se numri i punonjësve të siguruar është më i vogël se ai i kërkuar; xhiroja vjetore për vitin 2013 është më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Kështu nisur në zbatim të nenit 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar , parashikohet shprehimisht:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurim publik” i ndryshuar, parashkohet se:

“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”.

- Me shkresën nr.18/5 prot datë 09.10.2014 NjP, ka përgatitur ftesën për 5 operatorë ekonomikë (E”shpk; “B”shpk; “W.”shpk; “R”shpk dhe “Sh”shpk), në bazë të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu VI, pika b,c (Kërkesa për propozime), ku thuhet se *“...Gjatë veprimtarisë (përgatitja e kërkesës dhe vlerësimi i propozimeve) duhet të mbahet procesverbal i prokurimit....”*, gjë e cila për kërkesën e berë drejt 5 operatorëve ekonomikë Njësia e prokurimit nuk e ka relatuar në dosjen fizike.

-nga auditimi i zbatimit të kontratës shitje-blerje nr.18/15 prot datë 04.12.2014, rezultoi se;

Në dokumentat e financës për pageësën ndaj operatorit ekonomik, konkretisht nga magazina është paraqitur flete-hyrja nr.48 datë 26.12.2014, ndërsa nga AK, komisioni për marrjen në dorëzim të mallit është ngritur më datë 05.01.2015 dhe marrja e mallit është realizuar më datë 07.01.2015, pa arsyetuar vonesën e ngritjes së komisionit dhe marrjen e mallit me 15 ditë me vonesë, nga ajo e parashikuar në kontratën e mësipërme neni 4 (afati dhe kushtet e lëvrimit) *“....20 ditë pas datës së lidhjes së kontratës....”* si dhe duke mos dalë që kjo vonesë është për shkak të OE apo AK.

Gjithashtu, sipas neni 14 (Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar) ku thuhet shprehimisht se “Dëmi i likuiduar për dorëzimin e vonuar do të llogaritet me tarifën e mëposhtme ditore;

Tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar ose pa u paguar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”.

9.Mbi auditimin e procedurës me objekt “Shërbim për mirëmbajtjen e ndërtesave” (procedurë “Kërkesë për propozime” viti 2014.

-Nga auditimi, rezultoi se, për hartimin e fondit limit, në bazë të kërkesave nga njësitet e fakulteteve, në lidhje me mirëmbajtjen e amjenteve të tyre, Njësia e Hartimit të Dokumentave mbështetur në VKM nr.514, datë 15.08.2007 “Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe Manualin e Çmimeve të Punimeve miratuar nga MPPT të vitit 2013, llogariti fondin limit së bashku me termat e referencës, kjo sipas proces-verbalit të datës 03.06.2014.

- Me shkresën nr.11/4 prot datë 05.06.2014 NjP, ka përgatitur ftesën për 5 operatorë ekonomikë (“M”shpk; “M”shpk; “A”shpk; “U”shpk dhe “E”shpk), në bazë të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu VI, pika b,c (Kërkesa për propozime), ku thuhet se *“...Gjatë veprimtarisë*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

(përgatitja e kërkesës dhe vlerësimi i propozimeve) duhet të mbahet procesverbal i prokurimit....”, gjë e cila për kërkesën e berë drejt 5 operatorëve ekonomikë Njësia e prokurimit nuk e ka relatuar në dosjen fizike.

-Nga auditimi i hapjeve të ofertave në 16 .06.2014, pranë sistemit elektronik të app.gov.al, rezultoi se, KVO ka hapur dhe lexuar ofertat si dhe ka realizuar procesin e vlerësimit, verifikimin, të dokumentacionit, ku ka rezultuar se pjesëmarrës janë paraqitur 5 (pesë) operatorë ekonomikë, të cilat janë kualifikuar të pestë, në përputhje me nenin 52 të LPP si dhe Kreu V pika 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave” i VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”.

Në datë 24.06.2014, në përfundim kemi këtë renditje:

- 1.K shpk &V –E shpk, me vlerë oferte prej 2,829,800 lekë pa TVSH
- 2.C shpk, me vlerë oferte prej 2,904,920lekë pa TVSH
- 3.N shpk, me vlerë oferte prej 3,003,961 lekë pa TVSH
- 4.Mshpk &Xh shpk, me vlerë oferte prej 3,144,460 lekë pa TVSH
- 5.Sh shpk, me vlerë oferte prej 3,306,400 lekë pa TVSH.

Në bazë të vlerës së oferte më të ulët, është shpallur fitues K shpk &V –E shpk, me vlerë oferte prej 2,829,800 lekë pa TVSH.

10.Mbi auditimin e procedurës me objekt “Rikonstruktion i nyjeve sanitare të Korpusit Qëndror të UPT”, viti 2015.

-Hartimi i fondit limit dhe hartimi i projektit, termave të referencës, specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit, është realizuar , në bazë të Urdhërit nr.15, datë 01.07.2015, duke përcaktuar dy përfaqësues nga bota akademike që japin mësim dhënie në FIN dhe FAU.

Gjithashtu,nga auditimi, rezultoi se, për hartimin e fondit limit, në bazë të kërkesave nga njësitet e fakulteteve, në lidhje me mirëmbajtjen e amjenteve të tyre, Njësia e Hartimit të Dokumentave mbështetur në VKM nr.514, datë 15.08.2007 “Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe Manualin e Çmimeve të Punimeve miratuar nga MPPT të vitit 2013, llogariti fondin limit së bashku me termat e referencës, kjo sipas proces-verbalit të datës 05.08.2015.

-Nga AK, nuk është aplikuar pranë Bashkisë Tiranë, për pajisjen me leje ndërtimi, kjo në bazë ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe të VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Titulli II (Dokumentet dhe Procedurat e Kontrollit të zhvillimit), Kreu I (Dispozita të Përgjithshme) neni 6 (Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi), ku shprehimisht thuhet “...Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi...pika ii) ndërhyrje të brëndshme, iii)ndërhyrje në impiante higjeno-sanitare (..veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjeno-sanitare dhe riparimet e impiantit).

-Nga ana e AK, është përgatitur ftesa për ofertë (kerkesë për propozim) me nr.15/5prot datë 06.08.2015, drejtuar pesë operatorëve ekonomikë , konkretisht “C”shpk; “A”shpk; “K K”shpk; “K” shpk dhe “Sh”shpk, ku vihet re se nga ana e NjP, ndryshe nga viti 2014, është bërë dhe arsyetimi,pse pikërisht janë përzgjedhur këto operatorë, për shkak se janë të njohur në fushën e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

tyre, kane marrë pjesë në procedura të mëparshme dhe veprimtaria e tyre përputhet me objektin e prokurimit, kjo në përputhje me LLP neni 34 dhe VKM nr .914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39, pika 4 (...në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë). -Nga auditimi në sistemin elektronik të app.gov.al, rezultoi se, në datën 28.08.2015, nga ana e KVO-së, me përfundimin e verifikimit, e dokumentacionit ligjor, teknik dhe ekonomiko-financiar, nga paraqitja e 12 ofertave ekonomike, janë skualifikuar 5 operatorë ekonomikë, në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 46 pika 1 shprehimisht “operatorët ekonomikë për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme.....” neni 53pika 3 shprehimisht “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”, neni 74pika 3 përcaktohet “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje...”. Kështu nisur për sa më sipër, arsyet e skualifikimeve janë si më poshtë:

1.BO/ “C &N” shpk, nuk ka paraqitur certifikatën e gjendjes financiare nga një ose më shumë banka, ku të provohet se disponon një shumë të barabartë ose më të madhe me përqindjen e pjesëmarrjes në punë të përcaktuar në aktmarrëveshjen e bashkimit të BO.

2. “K”sha, nuk ka paraqitur kopje të vërtetuar nga Administrata tatimore të bilancit të vitit 2014, përcaktuar në Dokumentat e Tenderit, Kriteret e vecanta e kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, 2.2, germa b; nuk ka paraqitur dokumentacion, ku të provoj se ka të punësuar në stafn e saj inh. Ndërtimi, përcaktuar në dokumentat e tenderit, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti, 2.3 pika3.

3.BO/ “A & C, vertetimi për gjendjen bankare, paraqitur nga anëtari i BO “C”shpk, nuk është lëshuar brenda pesë ditëve nga data e hapjes së ofertave sic përcaktohet në dokumentat e tenderit; anëtari i BO “A”shpk nuk plotëson vlerën për punime të ngjajshme në raport me përqindjen e pjesëmarrjen dhe zërat e punimeve të përcaktuara në aktmarrëveshjen e bashkimit.

4. “B”shpk, nuk ka paraqitur vertetimin e OSHEE për likuidimin e detyrimit të maturuar të energjisë për muajin Qershor 2015.vërtetimi i debisë i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik mban datën 09.07.2015 dhe nuk përfshin pagesën e faturës koherente të muajit qershor 2015.

5. “B”shpk, nuk plotëson kriterin e përcaktuar në Dokumentatet e Tenderit, Kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, 2.3, pika 5, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur, numri mesator i fuqisë punëtare për periudhën janar-qershor 2015, është më i vogël se 40 punonjës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:

Objekti "Rikonstruksioni i nyjeve sanitare të korpusit qendror të UPT" është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 15/11 prot. datë 22.09.2015 të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Universitetit Politeknik të Tiranës, përfaqësuar nga Rektori i UPT dhe operatorit ekonomik "N" sh.p.k, përfaqësuar nga drejtuesit ligjor. Vlera e kontratës është 5,463,168 lekë pa TVSH ose 6,555,802 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore prej 42



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës. Preventivi i kontratës është me çmim njësie, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën e preventivit njësi për secilin zë punimesh në përputhje me nenin 5 të kontratës.

-Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata me nr. 67/1 prot. datë 22.09.2015 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Universitetit Politeknik të Tiranës, përfaqësuar nga Rektori i UPT dhe operatorit ekonomik "P " sh.p.k, përfaqësuar nga drejtuesit ligjor. Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 22,800 me TVSH.

- Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është mbajtur më datë 22.09.2015, ku është konstatuar se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi merr në dorëzim sheshin e ndërtimit për realizimin e punimeve. Me shkresën nr. 1069 prot. 22.09.2015 nga mbikëqyrësi i punimeve njoftohet fillimi i punimeve dhe procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur më 22.09.2015.

Me shkresën e mbikëqyrësit nr. 1243 prot. datë 23.10.2015, drejtuar Investitorit kërkohet të shtyhet afati i përfundimit të punimeve për shkak se tualetet janë liruuar pjesërisht pasi ka qenë periudhë mësimore dhe nuk është mundur të punohet njëkohësisht në anët e tyre, ku kërkohet shtyrje për periudhë 35 ditore, në të cilën parashikohet se punimet duhet të përfundojnë më 07.12.2015. Përfundimi i punimeve është njoftuar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve me protokoll extra datë 07.12.2015, ku është mbajtur procesverbali i përfundimit të punimeve midis palëve.

-Akti i kolaudimit është realizuar më datë 28.12.2015 nga person fizik me përfaqësues Ing. Spartak Shehu dhe certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim është realizuar më 28.12.2015, nga specialistët e UPT.

Nga verifikimi i librezës së masave, tabelës së lëvizjes së volumeve dhe situacionit përfundimtar, konstatohen ndryshime nga preventivi i punimeve, duke mos u argumentuar saktë në projektin e azhurnuar (Asbuild), në kundërshtim me ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, konkretisht neni 7 ku përcaktohet se: Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit dhe Udhëzimi Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 ku përkatesisht përcaktohet se:

“3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion.

11.Mbi aditimn e procedurës me objekt “Shërbimi i informatizimit të aktivitetit dhe dokumentacionit të sekretarive mësimore” viti 2016.

1.Hartimi i termave të referencës dhe hartimi i fondit limit.

Institucionet e varësisë Fakultetet e Universitetit Politeknik të Tiranës ushtrojnë aktivitetin e tyre mësimor në përputhje me Kartën e Bolonjës. Sekretaria mësimore është enti kryesor që merret më përgatitjen e dokumentacionit të provimeve dhe arkivimin e tij. Rritja e numrit të studentëve dhe shtimi i volumit të punës ka nxjerrë si domosdoshmëri informatizimin e aktivitetit dhe dokumentacionit të sekretarive mësimore si dhe automatizimin e shërbimeve ndaj studentëve dhe pedagogëve.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Qëllimi i këtij shërbimi është mundësimi i funksionimit informatik të sekretarisë mësimore në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, emetimin e dokumenteve zyrtare të provimeve si dhe ofrimi i shërbimeve më cilësore ndaj studenteve dhe pedagogëve në funksion të procesit mësimor.

Kështu nisur nga sa më sipër AK i Universitetit Politeknik i Tiranës, me Urdhër nr.10 prot datë 12.05.2016 “Për caktim punonjësi për hartimin e termave të referencës të procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi i informatizimit të aktivitetit dhe dokumentacionit të sekretarive mësimore të UPT”, duke e finalizuar me materialin e përgjithshëm si dhe detyrat specifike të do realizojë sistemi, backup-et për sistemin e sekretarive, etj në ndërthyrje me termat e referencës.

Me Urdhër nr.10/1prot datë 12.05.2016 “Për ngritjen e njësisë së hartimit të dokumentave të tenderit dhe fondit limit”.

-Njësia e prokurimit, në bazë të kërkesave të fakulteteve (FIN, FAU,FIM&IF, FTI, FIE, FIM dhe FGJM) për vashdimin normal të shërbimit të mësipërm, ka realizuar llogaritjen e fondit limit për periudhën 01qershor -31dhjetor 2016 (7 muaj), duke u shprehur se janë mbështetur në kontratën e vitit të kaluar, të cilën nuk e kanë reklamuar në dosjen fizike, kjo në kundërshtim me LPP.

-Nga ana e AK,sipas Proces-verbalit datë 12.05.2016, është përgatitur ftesa për ofertë, e cila është dërguar (kerkesë për propozim) me nr.10/5prot datë 13.05.2016, pesë operatorëve ekonomikë , konkretisht “B”shpk; “A”shpk; “Shpresa”shpk; “S” shpk dhe “I”shpk, ku vihet re se nga ana e NjP, ndryshe nga viti 2014, është bërë dhe arsyetimi,pse pikërisht janë përzgjedhur këto operatorë, për shkak se janë të njohur në fushën e tyre, kane marrë pjesë në procedurë të mëparshme dhe veprimtaria e tyre përputhet me objektin e prokurimit, kjo në përputhje me LLP neni 34 dhe VKM nr .914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39, pika 4 (...në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë).

-Gjatë auditimit, rezultoi se me Urdhër nr.10/6 prot datë 16.05.2016 “Për ndryshimin e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave për procedurën kërkesë për propozim me objekt “Shërbimi i informatizimit të aktivitetit dhe dokumentacionit të sekretarive mësimore të UPT”, është realizuar ndryshimi i anëtarit të KVO-së, me një anëtar tjetër, duke mos e dhënë arsyetimin pse, ka ndodhur ndryshimi, kjo në kundërshtim me LPP-në.

2.Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Nga auditimi i procedurës në faqen elektronike të app.gov.al, rezultoi se mbas hapjes së ofertave , në datë 23.05.2016, janë paraqitur dy operatorë ekonomikë si më poshtë:

“B”shpk me vlerë oferte prej 1,599,000 lekë pa TVSH, kualifikuar

“S” shpk me vlerë oferte prej 1,290,000 lekë pa TVSH, skualifikuar.

Nga auditimi rezultoi, se skualifikimi i operatorit ekonomik “S” shpk, është pasi se nuk kanë paraqitur çertifikatën e autorësisë (Copyright) për origjinën e softit, përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2;për mosplotësim të specifikimeve teknike, objekti, qëllimi dhe afatet e realizimit që përshkruan në materialin teknik të dorëzuar, me emetimin “Sistemi i sekretare dhe studentit”, nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe termave të referencës, etj.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Kështu, nisur nga këto kushte, KVO në zbatim të nenit 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”.

Nisur, nga skualifikimi OE “S” shpk, ka paraqitur ankesë pranë Ak më datë 01.06.2016, me nr.10/7 datë 01.06.2016, për të cilën Titullari i AK me Urdhër Pezullimi, me shkresë nr.10/8 prot datë 01.06.2016, duke ngarkuar personin, për shqyrtimin e ankesës dhe përgatitjen e rekomandimit, e cila është përgatitur 08.06.2016.

Nga auditimi, rezultoi se, pas firmosjes nga ana e Administratorit, në cilësinë e Titullarit të AK me shkresë “Kthim përgjigje” i’u është përcjellë zyrës së protokollit për protokollimin e shkresës, vulosjes dhe dërgimit pranë operatorit ekonomik të interesuar.

Nga ana e protokollit nuk është pranuar të vulosej dhe të protokollohej shkresa me argumentimin “kam urdhër verbal nga Rektori UPT” me cilësinë e AK, që shkresat të dërgohen pranë tij përpara se të nisen. Për sa më sipër nuk ka qënë e mundur dërgimi pranë personit të interesuar të shkresës. Për këtë situatë janë mbajtur Memo të datës 08.06.2016 dhe 13.06.2016, nga NjP, duke njoftuar Titullarin AK (Administratorin), se shkresa nuk është protokolluar, vulosur dhe dërguar OE, duke kaluar të gjitha afatet ligjore që parashikon LPP dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 74 (ankesa pranë autoritetit kontraktor). Shkresa e firmosur është depozituar pranë NjP pa vulën e protokollit e cila është e administruar në dosjen fizike të procedurës së mësipërme.

Grupi i auditimit, në lidhje mbi këtë situatë vlerëson se në këtë procedurë, me zgjedhjen e Rektorit të ri Prof.Dr., në fillim të marrjes së detyrës është ndjerë mbivendosje kompetencash, për shkak të interpretimeve të ndryshme të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike mes Rektorit të Universitetit dhe Administratorit në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve të autoritetit kontraktor, duke sjellë vonesën e procedurës së prokurimit objekt me objekt “Shërbimi i informatizimit të aktivitetit dhe dokumentacionit të sekretarive mësimore të UPT”, me fond limit 1,618,750 lekë pa tvsh.

Gjithashtu, pas kalimit të afateve të përcaktuara në ligjin për prokurimin publik, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, për ankesat rezultoi se operatori ekonomik “S” shpk, nuk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe me përfundimin e afatit të ankimit, komisioni i Vlerësimit të ofertave, i mbedhur me datë 24.06.2016, ka propozuar fituesin Titullarit të AK, ofertën e OE “B”shpk.

3.Lidhja dhe monitorimi i kontratës.

Autoriteti kontraktor ka lidhur Kontratë nr.10/17 prot datë 19.07.2016, me “B”shpk me vlerë totale të ofertës 1,599,000 lekë pa TVSH dhe me TVSH 1,918,800 lekë.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se ky shërbim është përfutur për nevojat e UPT-së, dhe për vitet 2014, 2015, me vlera ekonomike prej për 1,600,000 për 2014 dhe me vlerë 1.855,000 lekë pa tvsh për vitin 2015, dhe për vitin 1,918,800 lekë me TVSH, nga njëjt operator ekonomik “B”shpk, i cili ka përfutur nga autori i veprës program kompjuterik me titull “SEKRETAR”



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

nga, në bazë të Çertifikatë Rregjistrimi të Drejtë Autori(Nr.47 RDA/20.10.2010), duke i dhënë ekskluzitevit të plotë shoqërisë “B”shpk.

Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin e app.gov.al, rezultoi se në ekstraktin e regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit nga QKR (2014), rezultoi se, ishte krijuesi i shoqërisë më datë 03.10.2005 dhe më pas në datë 04.04.2014 del si ortak shoqërisë dhe në 13.05.2014 ka dhuruar të gjithë gjitha pjesët e ortakësisë me Kontratë dhurimi, L K, administratore e vetme që shoqërisë “B”shpk, dmth R T, nuk ka asnjë detyrim juridik dhe financiar në lidhje me këtë shoqërisë, por ndërkohë është realizuar Kontrata për dhënie ekskluzitevit të plotë shoqërisë “B”shpk me autorin R.T më datë 25.10.2014 ku thuhet detyrimet e palëve si më poshtë vijon: “R.T i jep të drejta të pakufizuara për shfrytëzimin e veprës “SEKRETAR”, kompanisë “B”shpk për një kohë 5 vjecare, duke filluar nga nënshkrimi i kontratës me të tretët.

R.T do të jetë në dispozicion të kompanisë , për të bërë ndërhyrjet e duhura në program sa herë, që shfaqet nevoja me kërkesë nga tretët.

B shpk, ka detyrim të njoftojë autorin R.T për çdo kontratë që lodh me të tretet për shfrytëzimin e programit kompjuterik “SEKRETAR”.

B ka detyrim ti paguaj autorit 15% të vlerës së kontratës në momentin e lidhjes së saj me të tretë dhe 5% në përfundim të kontratës.”

Pra si më sipër, ndonëse autori dhe ish administratori i “B”,i cili i ka dhuruar kompaninë, përsëri është marrëdhënie kontraktuale financiare më operatorin fitues që operon në shërbimin , ndërkohë, autori “SEKRETAR”, është më cilesinë e pedagogut të brëndshme pranë UPT-së. (Konflik interesi, ndonëse është deklaruar nuk kanë konflik intersi nga kompania “B” shpk).

Kështu nisur sa më sipër, nga AK fillimisht duhet të realizohet procedura e blerjes se programit kompjuterik me qëllimin e ofrimit të shërbimit të cilin është krijuar “SEKRETAR”, duke përfshirë në hartimin e vlerës së fondit limit dhe vlerën për trajnimin nga operatori fitues të sfafit të IT të Rektoratit të UPT-së, dhe jo të vazhdojë pafundësisht ky shërbim, duke bërë të mundur përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet te fondve publike të UPT-së, dhe jo të kthehet në monopol.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se ky program dhe ky shërbim nuk do të jetë funksional, pasi UPT, po implementon dhe po ngrihet infrastruktura hardëare për instalimin lokal të sistemit UGOV, kjo në kuadër të projektit të ndërtimit të rrjetit telematik për Universitet Shtetërorë Publike, sipas ligjit nr.9704, datë 02.04.2007 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një Qendre Shërbimesh dhe të një Rrjeti Telematik për Universitetet”.

Pra si konkluzion, nga ana e AK të Universitetit Politekinik të Tiranës, për tre vitet e mësipërme, nga të ardhurat dytësore, u siguroi shërbimi i informatizimit të “SEKRETARIA”, i cili tashmë, nuk do të jetë më, si pasojë e moskordinimi i UPT-së me Ministrinë e Arsimit dhe më gjërë,duke sjellë mos përdorim të fondeve publike, pa efikasitet,pa efektivitet dhe pa ekonomicitet, të viteve (2014, 2015 dhe 2016), të vlerës ekonomike në total prej 5,373,000 lekë pa TVSH.si rezultat i zëvendësimit të shërbimit të informatizimit me një shërbim tjetër të sistemit UGOV.

12.Mbi adutimin e procedurës me objekt “Blerje materiale pastrimi” viti 2016.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

1.Hartimi i termave të referencës dhe hartimi i fondit limit.

Nga njësitë dhe Rektorati, janë paraqitur kërkesat dhe sasisë për blerjen e materialeve të pastrimit për vitin 2016, komisioni i ngritur me Urdhër nr.7 prot datë 27.04.2016 “Për ngritjen e njësisë së hartimit të termave të referencës dhe fondit limit”, janë mbështetur në çmimet e tregut, duke marrë tre oferta nga operatorë të cilët tregtojnë këto mallra, konkretisht nga “E”shpk me vlerë oferte 1,234,170 leke, personit fizik me vlerë oferte 1,130,880 lekë dhe “F” shpk me vlerë 1,260,485 lekë, duke e përlogaritur fondin limit të barasvleshëm me vlerë prej 1,130,880 (një milion e njëqind e tridhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, duke përcaktuar dhe llojin e procedurës “Kërkesë për propozim”, sipas Urdhër prokurimi nr.7/1 prot datë 27.04.2016.

-Nga ana e AK,sipas Proces-verbalit datë 27.04.2016, është përgatitur ftesa për ofertë, e cila është dërguar (kerkesë për propozim) me nr.7/4prot datë 28.04.2016, pesë operatorëve ekonomikë , konkretisht “Ht”shpk; “A”shpk; “D”shpk; “A” shpk dhe “O-”shpk, ku vihet re se nga **ana e NjP, ndryshe nga viti 2014, është bërë dhe arsyetimi**, pse pikërisht janë përzgjedhur këto operatorë, për shkak se janë të njohur në fushën e tyre, kane marrë pjesë në procedura të mëparshme dhe veprimtaria e tyre përputhet me objektin e prokurimit, kjo në përputhje me LLP neni 34 dhe VKM nr .914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39, pika 4 (...në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë).

2.Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Nga auditimi i procedurës në faqen elektronike të app.gov.al, rezultoi se mbas hapjes së ofertave , në datë 09.05.2016, janë paraqitur katër operatorë ekonomikë si më poshtë:

- 1.“A”shpk me vlerë oferte prej 975,000 lekë pa TVSH, kualifikuar.
- 2.“P” shpk me vlerë oferte prej 0 lekë pa TVSH, skualifikuar.
3. “O” shpk me vlerë oferte prej 1,123,035 lekë pa TVSH,skualifikuar.
4. “W.Center” shpk me vlerë oferte prej 904,516 lekë pa TVSH, kualifikuar.

Nga auditimi rezultoi, se skualifikimi i operatorëve ekonomikë :

1.“P” shpk, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme të kualifikimit, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1, gërmat a, b,c,ç dhe d; nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2, gërmat a,bdhe c;nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik;nuk ka paraqitur në ditën e hapjes së tenderit, mostrat fizike për artikujt e kërkuar nga AK, në DST.

2. “O”, nuk ka paraqitur vertetim nga administrata tatimore për xhiron vjetore të tre viteve të fundit (2013, 2014, 2015) përcaktuar në dokumentet e tenderit, Kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2, gërma c, pasi referuar vertetimit bankar të paraqitur, gjendja e llogarisë bankare është më e vogël se 10% e vlerës së fondit limit Kështu, nisur nga këto kushte, KVO në zbatim të nenit 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...” dhe në zbatim të nenit 46, pika 1, “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme...”

Nisur, nga skualifikimet, nga AK, pasi është kaluar afati ligjor për paraqitjen e ankesave dhe nuk u është paraqitur asnjë e tillë, bazuar në bazën ligjore të prokurimeve, KVO në datën 30.05.2016, ka vendosur të propozojë fituesin titullit të AK, ofertën e operatorit ekonomikë “W” me vlerë totale të ofertës 904,516 (nëntëqind e katër mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga auditimi, rezultoi se, vendimi për shpalljen e fituesit, dhe miratimi i procedurës, të datës 31.05.2016, rezultojnë të pavulosura nga zyra e protokollit, me justifikimin, nuk është pranuar të vulosej dhe të protokollohej shkresa me argumentimin “kam urdhër verbal nga Rektori Prof.Dr” me cilësinë e titullarit të UPT-së, që shkresat të dërgohen pranë tij përpara se të nisen.

Grupi i auditimit , në lidhje mbi këtë situatë vlerëson se në këtë procedurë, me zgjedhjen e Rektorit të ri Prof.Dr., në fillim të marrjes së detyrës është ndjerë mbivendosje kompetencash, për shkak të interpretimeve të ndryshme të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike mes Rektorit të Universitetit dhe Administratorit në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve të autoritetit kontraktor.

3.Lidhja dhe monitorimi i kontratës.

Autoriteti Kontraktor, me operatorin ekonomik fitues “W.”, është lidhur Kontratë shit-blerje nr.7/10 prot, datë 04.07.2016. Nga auditimi, rezultoi se të dyja palët kanë respektuar detyrimet kontraktore në përmbushje të kontratës si dhe të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr .914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kështu, me Urdhër nr.65 datë 18.07.2016 “Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim”, i cili ka mbajtur proces-verbalin e marrjes në dorëzim më datë 19.07.2016, për kontrollin dhe marrjen në dorëzim të mallrave “Blerje materiale pastrimi”, ku është konstatuar që furnizimi me mallra, është furnizuar nga operatori ekonomik, sipas kërkesave, specifikimeve teknike, me cilësinë e kërkuar nga AK të paraqitura në DST.

8. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli në Universitetin Politeknik të Tiranës është konsideruar si një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike. Ky sistem i vendosur, është përditësuar rregullisht nga titullari i njësisë dhe është vënë në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë do të arrihen nëpërmjet veprimtarive efektive në pajtueshmëri me legjislacionin dhe me aktet e brendshme, kryerjen e informacioneve operative e financiare të plota dhe të besueshme.

Në drejtimin të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Universitetin Politeknik të Tiranës, janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmin e objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike për të gjithë komponentët si vijon:

- Mjedisi i kontrollit.
- Menaxhimi i riskut
- Aktivitetet e kontrollit
- Informimi dhe komunikimi

- **Monitorimi**

Gjatë procesit të auditimit janë kryer teste mbi procedura pune, pjesë të aktivitetit të UPT, për të vlerësuar përputhshmërinë me përgjigjet e pyetësorit të hartuar nga njësia si dhe për të verifikuar funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në lidhje me implementimin e Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” rezultoi se, në Universitetin Politeknik të Tiranës janë implementuar procedurat në lidhje me zbatimin e këtij ligji. Nga Administratori i Përgjithshëm i UPT-së është hartuar Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, kjo në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, 17.09.2015. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se, në mënyrë periodike çdo vit nga UPT është plotësuar dhe përcjellë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit “Pyetësi i vetëvlerësimit”, përkatësisht me shkresën nr. 118/1 prot., datë 31.01.2015; nr. 65/1 prot., datë 29.01.2016; nr.87/1 prot., datë 27.02.2017.

Në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, njësia ka hartuar rregjistrin të shoqëruar me raportin e përgjithshëm i risqeve, ku nëpunësi autorizues ka kryer njëkohësisht dhe funksionin e kordinatorit të riskut.

Në drejtim të Mjedisit të Kontrollit

Për vitin 2014 dhe 2015, në zbatim të nenit 16 pika a, të ligjit nr. 9741 datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Administrimit ka miratuar rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin, kodin e etikës, konfliktin e interesit, marrëdhëniet midis menaxherëve dhe punonjësve të çdo niveli hierarkie, apo marrëdhëniet me të tretët. Njësia ka hartuar Statutin e UPT-së, të miratuar nga senati më datë 25.06.2008, statut i cili deri më tani nuk është rinovuar me ndryshimet që ka pësuar ligji mbi arsimin e lartë.

Në drejtimin të përcaktimit të strukturës organizative (2014, 2015) në funksion të objektivave të institucionit rezultoi se, struktura organizative është miratuar me vendimin nr. 3, datë 08.04.2014, nr. 2, datë 05.05.2015, të Këshillit të Administrimit të Universitetit Politeknik Tiranë, dhe plotëson funksionet në zbatim të ligjit nr. 9741 datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë”. Për këtë periudhë njësia ka funksionuar me Rregullore e Administratës së Rektoratit, miratuar me urdhrin nr. 71. datë 27.12.2013.

Për vitin 2016 dhe 2017, në kundërshtim me ligjin 80/2015 datë 17.09.2015, neni 38 pika ç, senati nuk ka hartuar strukturën e përgjithshme të institucionit, për rrjedhojë institucioni në këtë periudhë ka funksionuar me strukturën e miratuar me vendimin nr. 2, datë 05.05.2015, “Për miratimin e strukturës dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet për vitin 2015”, të Këshillit të Administrimit si dhe rregulloren e miratuar me urdhrin nr. 60, datë 26.06.2015.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Në lidhje me objektivat strategjike/prioritetet e institucionit, është hartuar dhe miratuar Strategjia për vitin 2016-2017 me vendimin nr. 6, datë 19.07.2016, të Senatit, por kjo strategji nuk është miratuar në Bordin e Administrimit në përputhje me kërkesat e nenit 49, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 80/2015 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Mjedisi i kontrollit është konsideruar nga njësia si një element i rëndësishëm i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, etikën personale dhe profesionale si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të UPT-së.

Në drejtim të Menaxhimit të Riskut

Në këtë kuadër, u konstatua se është hartuar strategjia e riskut si dhe regjistri i riskut për periudhën 2015-2017, në funksion të së cilës është ngritur Grupi për Menaxhimit Strategjik me urdhrin nr. 4, datë 03.02.2014 “Për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik në UPT” i ndryshuar me urdhrin nr. 4/1, datë 19.12.2014. Sipas përgjigjeve të pyetësorit ky pozicion mbahet nga Nënpunësi Autorizues i cili është Administratori i Përgjithshëm i UPT-së, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë si dhe të mënyrës së organizimit e funksionimit të UPT-së.

Menaxherët janë të informuar për përgjegjësitë që kanë në lidhje me zbatimin e këtij ligji, por duhet dhe është e nevojshme të zhvillohen trajnime në këtë drejtim, në mënyrë që të azhurnohen më tej me konceptet e ligjit të MFK-së.

Menaxhimi i riskut ka realizuar identifikimin dhe analizën e risqeve, që kanë rëndësi për arritjen e objektivave dhe përcaktimin e një përgjigje të përshtatshme ndaj këtyre risqeve. Sa më sipër në institucionin e Universitetit Politeknik i Tiranës është i qartë administrimi i riskut sipas fushave të veprimtarisë.

Në Drejtim të Aktiviteteve të Kontrollit

Në lidhje me aktivitetet e kontrollit, i është kushtuar rëndësi një ndarje të përshtatshme të detyrave, në mënyrë që i njëjti person/strukturë të mos përfshihet njëherësh në zbatimin e dy ose më shumë detyrave që lidhen me: miratimin, zbatimin dhe rregjistrimin e operacioneve, vendosja e rregullave të brendshme mbi kontrollin para faktit ose paraprak të ligjshmërisë, veprime të përshtatshme kontrolli për sistemet e TI-së, etj. Në lidhje me procedurat e punës të shkruara, për proceset kryesore operacionale dhe financiare, përfshirë dhe qarkullimin e dokumentacionit dhe të informacionit, hallkat e vendim-marrjes dhe kontrollet e brendshme, janë të përfshira në Statutin e UPT-së i miratuar në vitin 2008 por i pa rinovuar, rregulloret e brendshme të njësive dhe rregulloren e administratës së Rektoratit, njëkohësisht zbatohen drejtëpërdrejt udhëzimet dhe manualët e ministrisë së Financave. Në këtë institucion është realizuar ndarja e detyrave, strukturat janë të ndara në drejtori dhe sektorë. Mbi parashikimin e veprimeve të përshtatshme kontrolli për sistemet e TI-së (teknologjisë së informacionit), ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit të IT-së, megjithse ka ende vend për përmirësim.

Aktivitetet e kontrollit kanë përcaktuar politikat dhe procedurat e vendosura për të adresuar risqet dhe për të arritur objektivat e institucionit. Ato kanë përfshirë një gamë veprimesh kontrolluese me karakter parandalues dhe zbulues.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Në Drejtim të Informimit dhe Komunikimit

Informimi dhe komunikimi janë konsideruar thelbësorë për zbatimin e të gjithë objektivave të kontrollit të brendshëm. Në kuadrin e ekzistencës së udhëzimeve e rregulloreve të shkujtara, mbi mënyrën e komunikimit brenda institucionit (komunikimi me shkrim, elektronik ose verbal), mundësia që u jepet punonjësve nga sistemi aktual i komunikimit, marrja e informacioneve të duhura për zbatimin e detyrave të tyre, rezultoi se në Universitetin Politeknik të Tiranës shkëmbimin e informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë mirë sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike, sipas rregullores së brendshme të institucionit.

Drejtoria ekonomike si dhe administratori janë strukturat përgjegjëse që sigurojnë informacionin për të informuar instancat mbi shpenzimet aktuale, krahasuar me buxhetin e planifikuar në total dhe për çdo program për të cilin ata kanë përgjegjësi. Këto struktura informohen vazhdimisht nëpërmjet raportimeve nga njësitë e vartësisë gjatë veprimtarisë së përditshme dhe sa herë që kërkohet informacion mbi mbledhjet e diskutimet që zhvillohen në fakultete Komunikimi me subjektet e jashtme përveç formës shkresore kryhet edhe në formë elektronike. Në lidhje me raportimin e parregullsive dhe problemeve nga punonjësit, pamvarësisht se në rregulloren e brendshme të miratuar me urdhrin nr. 60, datë 26.06.2015, janë përcaktuar përsëkrimet e punës, ato duhet të rishikohen në përputhje të kërkesat e ligjit 80/2015 të LAL.

Në drejtim të Monitorimit dhe Verifikimit

Monitorimi është krye nëpërmjet një procesi monitorimi në vazhdimësi, nëpërmjet vlerësimeve të shkëputura apo duke i kombinuar të dyja. Monitorimi i aktiviteteve të kontrollit të brendshëm dallohet qartë nga verifikimi dhe monitorimi i operacioneve të institucionit. Rektori dhe Administratori i Përgjithshëm marrin informacion të vazhdueshëm sipas fushës së kompetencës mbi aktivitetin e drejtorive në rektorat. Drejtuesit e njësive kryesore raportojnë në kohë për çështje konkrete. Struktura e sektorit të auditimit të brendshëm nuk është e plotësuar në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ajo funksionon me një përgjegjës sektori në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 23.07.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe VKM nr.474, datë 16.6.2011, “Për përcaktimin e Standarteve të Procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”, pika 20 ku citohet: “Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e vecantë kur në të jenë të paktën një pozicion shef sektori dhe dy vartës.....”. Nga auditimi i kryer si dhe nga përgjigjet e dhena nga pyetësi rezultoi se, në UPT drejtuesit e njësive raportojnë sa herë kërkohet informacion për çështje konkrete. Për aktivitetin financiar administratori i përgjithshëm thërret në raport në mënyrë të shpeshtë administratorët e njësive. Gjithashtu, monitorohen rregullisht nga titullari, drejtuesit e njësive për arritjen e objektivave ku raportohet në mbledhje dhe analizën vjetore që bëjnë organet ekzekutive si Senati dhe Bordi i Administrimit.

9. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli në Universitetin Politeknik të Tiranës është konsideruar si një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike. Ky sistem i vendosur, është përditësuar rregullisht nga titullari i njësive dhe është vënë në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësive do të arrihen nëpërmjet veprimtarive efektive në pajtueshmëri me legjislacionin dhe me aktet e brendshme, kryerjen e informacioneve operative e financiare të plota dhe të besueshme.

10.Mbi auditimin e përputhshmërisë “Vlerësimi i funksionimit të auditit të brendshëm”.

Gjatë auditimit, grupi i KLSH-së, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, me ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, me ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, me Urdhërit të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.89, datë 28.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike”.

Në vëmendjen e audituesve, u përmbajtëm, në pikat e mëposhtme:

- Organizimi dhe funksionimi i auditimit të brendshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- Hartimi i planeve të auditimit të brendshëm të brendshëm.Përgatitja dhe hartimi i programeve të auditimit, llojet e auditimit.
- Zbatimi i planeve të auditimit të brendshëm,hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit.
- Hartimi i Raportit Final të Auditimit dhe sigurimi i cilësisë. Rekomandimi i masave për përmirësimin e gjendjes, mbështetja ligjore për rekomandimet e dhëna.
- Evidenca e zbulimeve për auditimet e kryera.
- Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna.Zbatimi i rekomandimeve nga subjekti i audituar.
- Evadimi i materialeve të auditimit. Arkivimi i dosjes.

Kështu, nga auditimi, rezultoi se, Universiteti Politeknik i Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë dhe ka statusin e personit juridik publik. Ai përbëhet nga dhjetë njësi shpenzuese, nga te cilat tetë njësi kryesore (shtatë fakultete dhe nje institut), një njësi administrative (Administrata e Rektoratit) dhe një njësi ndihmëse (Biblioteka Shkencore). Nga auditimi rezultoi se, në administratën e Rektoratit të UPT-së, ende nuk është plotësuar njësia e auditimit të brendshëm, rekomandim i lënë në auditimin e mëparshëm të KLSH-së, sipas Raportit Përfundimtar me shkresë nr.850/7 prot datë 05.05.2014.

Në strukturën organike aktuale (e cila ende nuk është e miratuar dhe vazhdon të jetë në një proces të tejzgjatur për pozicionimin e saj), ekziston “struktura” me 1 përgjegjes sektori dhe 1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

specialist (vakand), ku vetëm përgjegjësi i sektorit është i punësuar, kjo në kundërshtim me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin public” i ndryshuar.

Nga ana e titullarëve të UPT-së, nuk është përmbushur detyrimi ligjor dhe administrative, për plotësimin e vendeve vakande në sektorin e auditit, strukturë organizative nuk plotëson kërkesat e minimumit ligjor, 1 drejtues dhe 2 specialistë, gjendje e cila vazhdon edhe me momentin e miratimit të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, ku tashmë vendim marrja nuk është e titullarit (rektorit) por e strukturës kolegjiale (Bordi i Administrimit).

Gjithsesi, ndonëse me strukturë të mangët me burime njërëzore audituese, për vitin 2015, nga personi i vetëm përgjese e sektorit të auditimit, janë realizuar 3 (tre) auditime pranë fakulteteve (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM), Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE) si dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI), të miratuara nga titullari Rektor Akademi Jorgo Kaçani, ku janë evidentuar mungesa të rregulloreve të brendshme, të cilat nuk janë rishikuar për tu përshtatur kërkesave të kuadrit ligjor, si dhe këto njësi shpenzuese nuk kanë identifikuar dhe krijuar regjistrin e riskut, vlerësimin e kontrollit.

Gjithashtu është evidentuar se, komisionet e inventarizimit nuk janë në dijeni të përgjegjësisë që kanë, përgjegjësi e cila është e përcaktuar në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pavarësisht se nga ana e Rektorit, ju janë dërguar në të gjitha njësitë e UPT shkresa me nr.1670/1, datë 23.12.2014 me lëndë “Për inventarizimin e aktiveve”. Pra si konkluzion, auditimi i berë ka qënë i zbehtë pa dalë me fakte dhe përgjegjësi konkrete, kjo edhe si pasojë e kufizimeve të sektorit të auditimit të brendshëm në UPT, i cili nuk ka qënë i aftë për sigurimin e cilësisë.

Për vitin 2016, kështu në bazë të Planit vjetor të miratuar nga Rektor i UPT-së, me shkresën nr.1121/2 prot, datë 14.10.2015, i ndryshuar me shkresën nr.1149 prot, datë 04.10.2016, me strukturë jo të plotë, janë realizuar 4(katër) auditime përputhshmërie si dhe 3(tre) auditime për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Nga auditimi, i gjetjeve të evidentuara nga S.Gushali, sipas Raportit vjetor për veprimtarinë e njësive të auditimit të brendshëm për periudhën janar-dhjetor 2016, kanë të bëjnë me sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar, sistemin e pagave dhe sistemin e krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore, ku edhe këtu evidentohet fenomeni, por nuk del qartësisht se nga cilat kanë ardhur këto mangësi, duke mos dale me fakte konkrete dhe përgjegjësitë respektive.

Kështu, referuar gjetjeve dhe rekomandimeve, është vlerësuar se sistemi i kontrollit të brendshëm ka paraqitur dobësi në drejtim të mjedisit të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit, mjedisi i kontrollit të brendshëm duhet të përmirësohet nëpërmjet miratimit të rregulloreve të rishikuara dhe një sërë rregullave e procedurave specifike.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Në drejtim të aktiviteteve të kontrollit, nga gjetjet e konstatuara rezulton se kanë munguar si kontrollet parandaluese, kontrollet zbuluese dhe kontrollet drejtuese.

Dobësitë e konstatuara në këto komponente të kontrollit, nga gjetjet e konstatuara rezulton se kanë munguar si kontrollet parandaluese, kontrollet zbuluese dhe kontrollet drejtuese, si rrjedhojë edhe monitorimi, nuk ka funksionuar në mënyrën e duhur dhe nuk ka garantuar se aktivitetet e kontrollit të kenë funksionuar sipas qëllimit për të cilin janë krijuar.

Grupi i audituesve të KLSH-së, në refererim të raporteve të mësipërme, vlerëson se ndonesë me strukturë të jo të plotë, është punuar deri diku, por kjo punë audituese nuk e justifikon qëllimin dhe misionin që duhet të këtë struktura audituese e brendshme e njësisë publike, duke hartuar thjesht disa “letra pune”, të cilat nuk kanë marrë përmirësimin e gjendjes dhe sigurimin e cilësisë, kjo për shkak të mos funksionimit të strukturës audituese.

Pra, mënyra e funksionimit të kësaj strukture, është në kundërshtim edhe me ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, për vitet 2014, 2015 deri në daljen e ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, duke mos justifikuar objektin kryesor të auditimit të brendshëm, i cili duhet të vlerësojë dhe të japë rekomandime të vlefshme për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike, pra e auditimi i gjithë veprimtarisë si akademike ashtu edhe administrative.

Gjithashtu, me miratimin e ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”.

Ky ligj, për herë të parë në historinë e IALP, parashikon ekzistencën e dy titullarëve, Rektorin dhe Administratorin, të cilët ushtrojnë kompetencat e tyre në fusha të ndryshme dhe pa varësi administrative nga njeri tjetri.

Konkretisht, në nenin 39 e vijues, të ligjit në fjalë, përcaktohet qartë se **“Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare**(prirje përcjellje të delegacioneve, autoriteteve të larta shtetërore, ceremonitë zyrtare etj), **sipas përcaktimeve të këtij ligji.**

Gjithashtu në nenin 5, të ligjit, përcaktohet qartë se **“Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëkuptimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij ligji”.**

Nisur nga kjo ndarje me zgjedhjen e Rektorit, në fillim të marrjes së detyrës është ndjerë mbivendosje kompetencash, për shkak të interpretimeve të ndryshme të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike mes Rektorit të Universitetit dhe Administratorit në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve të në lidhje me auditimin e brendshëm, për shkak të mungesës së akteve nënligjore në zbatimin të ligjit të mësipër, të arsimit të lartë, duke mos u bërë e mundur vazhdimi i detyrës funksionale të auditimit për shkak të mungesës së personelit si dhe të “drejtën” se cili nga dy titullarët kishte të drejtën e kompetencës për ecurinë e aktivitetit auditues të brendshëm.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Nisur nga këto kushte, nga ana e Rektorit të UPT-së, me shkresë nr.791, datë 20.06.2016 “Kërkesë për interpretim”, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të kontrollit të Brendshëm financiar publik, pranë Ministrisë së Financave, e cila në përgjigjen e saj me shkresën nr.8764/1prot datë 23.06.2016, citohet se “...në pikën 19 të nenit 4 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, titullari i njësisë publike është kreu i organit qendror të njësisë publike. Në kuptim të këtij ligji, titullari i njësisë publike që drejtohet me organ vendim marrës kolegjal, por që nuk organizohet si shoqëri tregtare, konsiderohet ky organ”.

Marrë shkak nga kjo përgjigje, grupi i auditimit të KLSH-së, vlerëson se, lidhur me varësinë e njësisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm, si sektor në varësi të Rektorit, për shkak të cilësisë së tij si kryetar i Rektoratit si organ kolegjal, është i pasaktë nga interpretimi i MF, pasi Rektorati si organ kolegjal vendimmarrës ka status tjetër ligjor dhe nuk mund të njëhesohet me administratën e rektoratit, në përbërje të cilës përfshihet Sektori i Auditimit të Brendshëm.

Ky interpretim ligjor, për të qartësuar se cili është autoriteti i institucionit të arsimit të lartë publik, i cili plotëson kushtet për të qënë titullar i njësisë publike sipas ligjit nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, pa rënë ndesh me përcaktimet e ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, është e qartë se Rektori nuk ka kompetenca dhe përgjegjësi, për çështjet administrative dhe financiare, e për rrjedhojë nuk mund të marrë cilësinë e titullarit të njësisë publike për këto çështje, duke miratuar planin e punës së sektorit të auditit të brendshëm për të audituar veprimtarinë administrative financiare të institucionit, gjithashtu edhe për rrjedhojë Administratori, është në non sens ligjor dhe logjik, të ngarkojë sektorin e auditit të brendshëm të auditojë aktet administrative të nxjerra prej tij.

Kështu, nisur nga këto rrethana, me inicim të zgjedhjes se Administratorit të ri në detyrë, i është kërkuar përsëri Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të kontrollit të Brendshëm financiar publik, pranë Ministrisë së Financave, e cila në përgjigjen e saj me shkresën nr.1335/1prot datë 06.02.2017, e cila është më e bazuar shprehet si më poshtë “...Referuar ligjit nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se IAL drejtohen nga dy organe kryesore kolegiale, që janë Senati Akademik dhe Bordi i administrimit. Duke analizuar kompetencat e këtyre dy organeve konkludojmë se Bordi i Administrimit mban përgjegjësi për garantimin e përmbushjes së misionit të institucionit të arsimit të lartë”.

Për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë këtë interpretim të MF si dhe parashikimet e ligjit të fushës së auditimit të brendshëm, gjykojmë se njësia e auditimit të brendshëm në UPT, duhet të raportojë në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek Bordi i Administrimit. Kështu, të gjitha detyrimet ligjore të njësisë së auditimit të IAL-ve (të tilla si karta e auditimit, plani strategjik dhe vjetor, raporti i cdo angazhimi auditimi etj), duhet të miratohen nga Bordi i Administrimit. Në çdo rast, Bordi i Administrimit, duhet të marrë paraprakisht miratimin nga Senati Akademik, për sa i përket çështjeve që lidhen me fushën akademike dhe gjithashtu Senati Akademik duhet të informohet mbi auditimet e kryera në këtë fushë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Nisur, nga ky interpretim, Bordi i Administrimit me shkresë nr.7 prot datë 08.02.2017, në përbushje të detyrave dhe përgjegjësi të tij ligjore, ka vlerësuar se është e domosdoshme që veprimtaria e njësisë së auditimit të brëndshëm, të pezullohet deri në shqyrtimin dhe marrjen e një vendimi për veprimtarinë e sektorit në fjalë.

Deri në momentin e hartimit të këtij aktkonstatimi veprimtaria e auditimit të brëndshëm është i pezulluar, për rrjedhojë që nga muaji shkurt të vitit 2017 e në vazhdim, pranë UPT-së, ndonëse me nje strukturë të paplotë nuk realizohet qëllimi i misionit të auditimit, gjë që e ngarkon me përgjegjësi Bordin e Administrimit.

Në lidhje mbi problematikat e mësipërme, grupi i auditimit të KLSH-së, ka mbajtur Aktkonstatimin nr.6 prot.1003/2 datë 30.10.2017 me Bordin e Administrimit dhe Silvana Gushali, përgjeshen e sektorit të Auditit të Brëndshëm, e cila ka bërë obesrvimet me nr.1361/7 datë 10.11.2017. Grupi i auditimit mbasi i shqyrtoi me vemendje, nuk i merr parasysh , me argumentimet si më poshtë vijon:

-Në faqen nr.3 paragrafi 1 thuhet “Referuar nenit 2, 5, 6 të ligjit nr.114 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brëndshëm në sektorin publik”, përkufizimi, misioni dhe roli i auditit të brëndshëm përcaktojnë se auditimi i brëndshëm jep siguri objektive, të arsyeshme si dhe mbështetje titullarit të njesisë publike për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brëndshëm.

Pra, sërisht auditimi i brëndshëm është i orientuar dhe fokusuar drejt sistemit dhe jo drejt personave/individë. Është inspektimi financiar publik i cili është fokusuar drejt shkeljeve të akteve normative, zbulimit të parregullsive dhe identifikimit të individëve përgjegjes dhe të kërkojë marrjen e masave zhdëmtuese, administrative apo disiplinore, sipas shkallës apo llojit të përgjegjësisë. Një ndër veprimtaritë e veta inspektimi financiar publik ka identifikimin e individëve përgjegjës për shkeljet e kryera (neni 7 –veprimtaria e inspektimit financiar publik, pika 1 e Ligjit nr.112/2015 “Për inspektim financiar publik”.

-Nisur nga ky këndvështrim, zj.... i jep më shumë përparësi Ligjit nr.112/2015 “Për inspektim financiar publik”, dhe jo ligjit bazë nr.114 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brëndshëm në sektorin publik”, neni 2, ku citohet se, “auditimi i brëndshëm, është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njesisë publike. Auditimi i brëndshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtaria të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit të qeverisjes”.

- Nga ana e titullarëve të UPT-së, nuk është përmbushur detyrimi ligjor dhe administrative, për plotësimin e vendeve vakande në sektorin e auditit, strukturë organizative nuk plotëson kërkesat e minimumit ligjor, 1 drejtues dhe 2 specialistë, gjendje e cila vazhdon edhe me momentin e miratimit të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, ku tashmë vendim marrja nuk është e titullarit (rektorit) por e strukturës kolegjiale (Bordi i Administrimit).

-Kështu nisur sa më sipër, nga përfaqësuesja e sektorit të auditit të brëndshëm, duhej të ishin orientuar drejt dhe saktë, mbi mënyrën e organizimit të shërbimit të auditit të brëndshëm, duke



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

zbatuar ligjit nr.114 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10 dhe vecanërisht pika c ku thuhet se “Në rastet kur anjë nga opsionet e parashikuara në shkrorat “a” dhe “b”, të këtij neni, nuk është i mundur të realizohet, shërbimi i auditimit të brendshëm kryhet nga njësia e auditimit të brendshëm e një njesie publike përkatëse. Marrëveshja miratohet paraprakisht nga Ministri i Financave”.

-Për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë interpretim të MF si dhe parashikimet e ligjit të fushës së auditimit të brendshëm, gjykojmë se përfaqësuesja e sektorit të auditit të brendshëm në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, deri në momentin e plotësimit të strukturës, duhej të kishin bashkëpunuar për të zbatuar bazën ligjore të mësipërme, dhe jo pezullimin e njësive të auditimit të brendshëm si dhe duhej në bashkëpunim të kishin miratuar (karta e auditimit, plani strategjik dhe vjetor, raporti i cdo angazhimi auditimi etj), të cilat dërgohen për raportim pranë MF, kjo në bazë të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2017 “Për auditimin e brendshëm në sektorin Publik”, i ndryshuar neni 18, pika 2 është dërguar në DHAB “Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm të UPT-së, periudha 2017 – 2020”.

Nga auditimi rezultoi se, në administratën e Rektoratit të UPT-së, ende nuk është plotësuar njësia e auditimit të brendshëm, rekomandim i lënë në auditimin e mëparshëm të KLSH-së, sipas Raportit Përfundimtar me shkresë nr.850/7 prot datë 05.05.2014.

Në strukturën organike aktuale (e cila ende nuk është e miratuar dhe vazhdon të jetë në një proces të tejzgjatur për pozicionimin e saj), ekziston “struktura” me 1 përgjegjes sektori dhe 1 specialist (vakand), ku vetëm përgjegjësi i sektorit është i punësuar, kjo në kundërshtim me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.

Nga ana e titullarëve të UPT-së, nuk është përmbushur detyrimi ligjor dhe administrative, për plotësimin e vendeve vakande në sektorin e auditit, strukturë organizative nuk plotëson kërkesat e minimumit ligjor, 1 drejtues dhe 2 specialistë, gjendje e cila vazhdon edhe me momentin e miratimit të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, ku tashmë vendim marrja nuk është e titullarit (Rektorit) por e strukturës kolegjiale (Bordi i Administrimit).

Kështu, nga BA, me shkresë nr.7 prot datë 08.02.2017, ka vlerësuar se është e domosdoshme që veprimtaria e njësive të auditimit të brendshëm, të pezullohet deri në shqyrtimin dhe marrjen e një vendimi për veprimtarinë e sektorit në fjalë, kjo në kundërshtim të detyrave dhe përgjegjësi të tij ligjore, e për rrjedhojë që nga muaji shkurt të vitit 2017 e në vazhdim, pranë UPT-së, ndonëse me një strukturë të paplotë nuk realizohet qëllimi i misionit të auditimit, gjë që e ngarkon me përgjegjësi Bordin e Administrimit.

Gjithsesi, ndonëse me strukturë të mangët me burime njëreze audituese, për vitin 2015, për vitin 2016 dhe për vitin 2017, nga auditimi, rezultoi se, ndonëse me strukturë të jo të plotë, është punuar deri diku, por kjo punë audituese nuk e justifikon qëllimin dhe misionin që duhet të këtë struktura audituese e brendshme e njësive publike.

11. Të tjera probleme të dala gjatë auditimit.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Mbi auditimin e ushtruar në Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT), në bazë të Programit të Auditimit , nr.738/1prot datë 07.08.2017 dhe shtesës së tij, me shkresën nr. 738/2 datë 10.11.2017 me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe institucionet e varësisë”, nga grupi i auditimit, u auditua në lidhje me objektin “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ligjore për rikthimin në detyrë të z.I*”, ku rezultoi si vijon;

z.I mban titullin “Profesor”, i cili ka qënë në marrëdhënie pune pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, deri në datën 06.09.2009, me detyrë punonjës kërkimor –shkencor (personel akademik) në departamentin e teknologjisë të Gjeoinformacionit, pranë ish Institutit të Gjeoshkencave, i krijuar me VKM nr.561 datë 22.08.2007 “Për bashkimin e disa institutive dhe njërive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare” pika 9 “Për periudhën kalimtare, Ministri i Arsimit dhe shkencës emëron dhe shkarkon drejtorin, në bazë të propozimit të bërë nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës. Nëndrejtori emërohet dhe shkarkohet nga drejtori i IGJEO-s. Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga rektori i UPT-së, në bazë të propozimit të këshillit drejtues”.

Në zbatim të pikës së mësipërme, është miratuar Urdhër të Ministrit të Arsimit nr.371, datë 28.07.2011 “Për krijimin e Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) pranë Universitetit Politeknik të Tiranës” si edhe me VKM nr.490, datë 06.07.2011 “Për shfuqizimin e vendimeve nr.560 e nr.561, datë 22.08.2007 të Këshillit të Ministrave “Për bashkimin e disa institutive dhe njërive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare” dhe “Për bashkimin e disa instituteve dhe njërive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare”, vendime që sollën mbylljen e Institutit të Gjeoshkencave, e për pasojë vend i punës është i suprimuar.

Në periudhën nga data 07.09.2009 deri në datën 08.09.2013, z.I ka ushtruar funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë, referuar vertetimit nr.24 prot, datë 24.11.2014 të Kuvendit të Shqipërisë. Me mbarimin e mandatit të deputetit, z.I i është drejtuar UPT-së me kërkesë nr.1106 prot, datë 24.09.2013, duke kërkuar rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, si pedagog dhe jo si punonjës kërkimor –shkencor (personel akademik) në departamentin e teknologjisë të Gjeoinformacionit, pranë ish Institutit të Gjeoshkencave.

Me shkresën nr.46 prot, datë 10.01.2014 “Kthim përgjigje” Universiteti Politeknik i Tiranës, i ka kthyer, z. I duke refuzuar kërkesën për kthimin në detyrën e mëparshme, për shkak se, pika 7 e nenit 50 të ligjit “Për arsimin e lartë” e cila parashikon këtë të drejtë, ka hyrë në fuqi me ndryshimet e bëra me ligjin nr.10307, datë 22.07.2010, pra pas largimit nga detyra, e po ashtu nuk rezultoi që midis palëve të ketë ndonjë marrëveshje të shkruar për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës në përfundim të detyres së funksionarit publik, pasi nga ana e Departamentit, për të plotësuar nevojat e veprimtarisë mësimore në këtë departament, është punësuar sipas procedurave përkatëse personel akademik me kohë të plotë.

Kështu nisur nga këto kushte, z.I , në muajin tetor 2014, ka konkuruar për një vend të shpallur vakant në Departamentin e Gjologjisë së Zbatuar, Mjedisit dhe Gjeoinformatikës, në Fakultetin e Gjologjisë dhe Minierave dhe nuk ka rezultuar fitues, për shkak se nuk plotësonte kriteret e



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

vendosura nga vetë departamenti në të cilin z.I ka qënë anëtar deri përpara emërimit të tij, në detyrën e Drejtorit të Institutit të Gjoshkencave. Këtë veprim e ka ndërmarrë, meqënëse personeli akademik gëzon status të veçantë, të ndryshëm nga ai që gëzojnë nëpunësit e administratës publike, e vetmja mundësi për rikthimin tuaj në detyrën e mëparshme është konkurrimi public sipas procedurës.

Ndërkohë, mbas ankimit që ka bërë pranë Ministrit të Arsimit dhe Sportit, vetë Ministri me shkresë nr.6280/1 prot, datë 19.09.2014, drejtuar rektorit të UPT-së, Akademik z., i ka rekomanduar UPT-së, që të mundësohet rikthimi i z.I në vendin e mëparshëm të punës.

Nisur sa më sipër, UPT-ja ka dërguar shkresë nr.1595/1prot, datë 27.11.2014 pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, ku nga ana e dekanit Prof.Dr., thuhet se “Nga shqyrtimi i dosjeve për vendin vakant, rezoltoi se z.I nuk është diplomuar as në profilin Gjeonformatikë, as në Informatikë dhe as në Inxhinieri Kompiuterash, ku departamenti ka nevojë, e për rrjedhojë nuk është fitues”.

Për sa më sipër, nga z.I, janë regjistruar dy ankimime në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë datë 13.05.2015 dhe Gjykatës Administrative të Apelit datë 25.06.2015, ku nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, është marrë vendimi nr.2300 (80-2015-974), datë 29.04.2015 ka vendosur “*Pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin e palës së paditur Universitetit Politeknik të Tiranës që të kthejë paditësin në detyrë në vendin e mëparshëm të punës në pozicionin personel akademik, rrezimin e padisë për kërkimet e tjera*”. Kundër këtij vendimi të mësipërm ka paraqitur përsëri ankesë z.I, pranë Gjykatës Administrative të Apelit në datën 25.06.2015, i cili ka riparashtruar këto pretendime:

-Vendimi i gjykatës është i pabazuar në ligj e në prova dhe si tillë duhet të ndryshohet duke pranuar plotësisht kërkesë padia.

-Gjykata ka gabuar në rrëzimin e pikës së dytë të kërimit, pasi paga është një e drejtë e garantuar për shërbimin e kryer.

-në rastin konkret paditësi ka mundësuar ofrimin e shërbimit kundrejt të paditurit që në datën 15.01.2014, por ka qënë ky i fundit që e ka refuzuar. Pala e paditur ka detyrimin ligor që të rikthejë atë në vendin e mëparshëm të punës ose t’i ofrojë, brenda një viti nga koha e mbarimit të mandatit, një vend tjetër pune të ngjashëm ose të përafërt me atë të mëparshmin.

-Në rastin konkret kemi të bëjmë me mungesë vullneti të palës së paditur për të zbatuar ligjin dhe detyrimi për të paguar paditësin nga momenti që ai ka kërkuar rikthimin në vendin e punës është në vetvete edhe një shpërblim që i bëhet paditësit për periudhën e mbetur pa punë.

-Gjatë kësaj periudhe që paditësi nuk ka mundur të rikthehet në vendin e punës, krahas pagesës mujore ka pësuar dëm edhe duke mos njohur kjo periudhë si vjetërsi pune dhe duke mos qënë në gjendje për të paguar sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore.

-Rikthimi në vendin e punës nuk krijon vetëm dëm financia por edhe dëme të tjera që lidhen dhe që vijnë si pasojë e marrëdhënieve të punës.

Nisur nga më sipër, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.2331(2421) datë 25.05.2017, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, nr.2300 (80-2015-974), datë 29.04.2015, pra rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, në pozicionin punonjës kërkimor-shkencor, personel akademik, ndërsa pretendimet e tjera nuk janë marrë në konsideratë. Gjithsesi, ndonëse në process gjyqësor midis z.I dhe UPT-së, me zgjedhjen e Rektorit Prof.Dr., me Vendimin nr.50 datë 28.07.2016, është vendosur që Prof.Dr.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

I, rikthehet në detyrë e mëparshme si personel akademik me kohë të plotë në Institutin e Gjeoshkencave Energjisë Ujit dhe Mjedisit, duke filluar marrëdhënie financiare në të njëjtën datë me vendimin e mësipërm.

Si përfundim, grupi i audituesve vlerëson se, në bazë të nenit 22 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Status i deputetit” i ndryshuar është parashikuar se: *“Institucionet e administratës publike, në të cilat deputetët kanë qënë të punësuar, pas mbarimit të mandatit të deputetit dhe nëse nuk kanë arritur moshën e pensionit, janë të detyruar ta rikthejnë atë në vendin e mëparshëm të punës”* si dhe duke respektuar autonominë dhe lirinë akademike të Universitetit Politeknik të Tiranës, si dhe në bazë të ligjit nr. 80/2015 datë 19.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH”, i njihet e drejta e rikthimit në detyrë, duke interpretuar ligjin me frymën pozitive për individin. Për sa më sipër rekomandojmë që të mundësohet nga ana Juaj rikthimi i z.I si personel akademik pranë UPT-së.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A.GJETJE DHE MASA PËR PËRMIRËSIME LIGJORE

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMBUSHJE LIGJORE

Nga auditimi për funksionimin e veprimtarisë së Universitetit Politeknik Tiranë u konstatuan mangësi në plotësimin e kuadrit ligjor, pas daljes së Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, pasi ndonëse kanë kaluar mbi 2 vjet nga miratimi i këtij ligji Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, nuk kanë hartuar dhe miratuar një pjesë e rëndësishme e akteve nënligjore (VKM dhe Udhëzime) si derivate të ligjit të mësipërm, pasi mos miratimi i tyre ka krijuar një ngërç në funksionimin e institucionit, në aspektin organizativ, e konkretisht:

1. Nga auditimi në Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT), në bazë të Programit të Auditimit nr.738/1prot, datë 07.08.2017, me objekt auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare në Universitetin Politeknik Tiranë dhe institucionet e varësisë”, konstatohet se, Universiteti Politeknik Tiranë është institucion publik i arsimit të lartë i llojit universitet dhe ka statusin e personit juridik publik. Ai përbëhet nga dhjetë njësi shpenzuese, nga të cilat tetë njësi kryesore (shtatë fakultete dhe një institut), një njësi administrative (Administrata e Rektoratit) dhe një njësi ndihmëse (Biblioteka Shkencore).

Nga ndarja e tij me Universitetin e Tiranës, me VKM Nr. 215, datë 15/07/1991 “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës” deri më sot, UPT është i organizuar dhe funksionon si një strukturë e centralizuar, me buxhet unik dhe një kod buxhetor.

Gjithashtu, me miratimi i ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, është konstatuar, mbivendosje kompetencash, për shkak të interpretimeve të ndryshme të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike midis Rektorit të Universitetit dhe Administratorit në drejtim të ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe veprimeve administrative. Kështu, për pasojë, mjaft praktika, administrative, financiare dhe realizimi i prokurimeve, në disa raste kanë rezultuar me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

probleme, si rezultat i mos zbatimit të nenit 141, e Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH”, **(miratimi e akteve nënligjore brenda 9 muajve nga hyrja më fuqi e ligjit)**. Nga auditimi konstatohet se:

a. Në ligjin e arsimit të lartë, neni 39 “Rektorin” përcaktohet se, **“Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare sipas përcaktimeve të këtij ligji.....”** dhe Administratori (neni 51) **“Administratori është autoriteti më i lartë administrative dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative sipas përcaktimeve të këtij ligji....”** Edhe për organet e tjera kolegjiale Senati (neni 37 dhe 38), Bordi i Administrimit (neni 47, 48 dhe 49), funksionet nuk janë të përcaktuara plotësisht në mënyrë të detajuar, duke ja lënë akteve e brendshme rregullatore (Statuti dhe Rregullore e UPT, janë ende të pamiratuara), të cilat duhej të ishin miratuar brenda dy viteve të parë akademike, sipas nenin 129 të ligjit.

b. Në ligj përcaktohet se, “Institucionet e arsimit të lartë” janë persona juridikë që vetëfinancohen, financohen nga Buxheti i Shtetit ose nga burime të tjera të ligjshme dhe ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në interpretim të këtij paragrafi “Institucionet e arsimit të lartë” që shpenzojnë fonde publike duhet t’i nënshtrohen Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore, në zbatim të tij. Në nenin 56 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, përcaktohet se **“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit...”**

...Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. **Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.**

Pra, sipas ligjit specifik, që është ai arsimit të lartë, Administratori mund të jetë Titullari i njësisë publike dhe njëkohësisht Titullar i Autoritetit Kontraktor, në kuptim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore, në zbatim të tij.

c. Sipas nenit 4/22, të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, “Titullar i njësisë publike” është kreu i organit qendror të njësisë publike. Në kuptim të këtij ligji, titullar i njësisë publike, që drejtohen **me organe vendimmarrëse kolegjiale**, por që nuk organizohen si shoqëri tregtare, **konsiderohet ky organ.**

...Titullarët e njësive publike, përgjigjen **për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike**, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet **si dhe cakton nëpunësin autorizues dhe**



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

njofton nëpunësin e parë autorizues në Ministrinë e Financës.

Titullari i njësive publike është përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit që përmban politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Ndërsa “Nëpunës autorizues” sipas Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, si dhe Ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit në njësine publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tyre.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme dhe funksionet që ligji i arsimit të lartë i ka caktuar Bordit të Administrimit dhe Administratorit, titullar i njësive publike duhet të jetë Bordi i Administrimit ndërsa “Nëpunës Autorizues”, Administratori i institucionit.

Por ky konkluzion, mbetet i paqartë për sa kohë, Bordi nuk është i vetmi organ kolegjal drejtues në njësine publike (IAL), si dhe për sa kohë në nenin 51, pika 1, të ligjit të arsimit të lartë përcaktohet se Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit.

d. Zbatimi efektiv i ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor është përfshirë në procesin e hartimit të një numri të gjerë aktesh nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij, që janë parashikuar të miratohen si vendime të Këshillit të Ministrave. Ministria e Arsimit ka përgjegjësinë e propozimit të akteve nënligjore për nenet e ligjit si më poshtë:

-Nuk janë hartuar dhe miratuar 10 VKM, dhe janë në proces të draftimi 6 VKM, (Bashkëlidhur lista në Aneks nr.1).

-Nuk janë hartuar dhe miratuar nga Ministri i Arsimit Sportit dhe Rinisë 13 Udhëzime dhe janë në proces draftimi 2 Udhëzime, (Bashkëlidhur lista në Aneks nr.1).

Për këtë rekomandojmë:

Ministria Arsimit Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim dhe koordinim me Universitet Publike, në mënyrë të përsheptuar, duhet të hartojnë dhe miratojnë kornizën ligjore të cilat, bëjnë të mundur garantimin dhe funksionimin e ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, në përmbushje të qëllimit të tij, të lirisë akademike dhe autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë.

Menjëherë

2.Nga auditimi rezultoi se, për Akreditimin e UPT, me urdhrin nr.1564,datë 28.12.2016 nënshkruar nga administratori është ngritur Grupi i Vetëvlerësimit individual (GVI) me 28 punonjës të cilët kanë funksione përdagogjike dhe për kryerjen e vetëvlerësimit individual me objekt vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, janë paguar sipas urdhër shpenzimeve nr. 1792, dhe 1793, datë 30.12.2016 në vlerën prej 1,507,886 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Urdhri nga Administratori është mbështetur në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i shfuqizuar, si dhe në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, nr.29/1, datë 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”. Ky veprim financiar është realizuar në zbatim të ligjit të mëparshëm i cili aktualisht është shfuqizuar me daljen e ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH” datë 22.07.2015, **fakt që tregon se kjo pagesë është mbështetur në një udhëzim të nxjerrë mbi bazën e një ligji të shfuqizuar.**

Për këtë rekomandoj:

Universiteti Politeknik i Tiranës në bashkëpunim dhe koordinim me Ministrinë e Arsimit dhe më gjerë me institucione të nivelit të lartë të qeverisjes, të marrin masa për shfuqizimin e akteve nënligjore, të cilat kanë buruar nga ligji i mëparshëm, duke u rifreskuar me kornizën e re ligjore që përftohet nga ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH” datë 22.07.2015, si dhe të kërkojnë miratimin e dispozitave të tjera nënligjore për përcaktimin e tarifave të reja për procesin e akreditimit, pasi ky proces përsëritet nga 1 deri në 3 vjet.

Menjëherë

B. REKOMANDIME PËR MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2013, 2014, 2015, 2016, dhe 2017 pranë ish strukturës organizative dhe strukturës faktike organizative të Rektoratit të UPT-së, funksionojnë 4 drejtori (Drejtoria e Kurikulave, Drejtoria e Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Marrëdhënive me Jashtë, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë), të cilat janë drejtuar nga personel akademik, me pagë sipas ligjit nr.9471, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në bazë të Vendimit Këshillit Administrativ, të UPT-së, nr.5, datë 17.07.2012, ku thuhet se, “Personeli akademik efektiv dhe ai administrativ teknik i UPT që caktohet në veprimtari të tjera dytësore jashtë funksionit të tyre organik kanë të drejtën e përfitimit financiar në masën deri në dy paga mujore në vit, sipas përkatësive. Masa e pagesës përcaktohet me urdhër të veçantë të miratuar nga rektori i UPT-së dhe përballohet nga fondi i të ardhurave të kushtëzuara të Universitetit”. Punësimi i personelit të brendshëm akademik, në funksione drejtuese administrative, jo vetëm që është në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e vecantë të personelit akademik”, por gjithashtu ka sjellë si pasojë kryerjen e kësaj detyre me kohë të pjesshme, si dhe funksionimin e drejtorive me mangësi në burime njerëzore. Në këto kushte, struktura organizative e Rektoratit të UPT-së ka qenë dhe vazhdon të jetë e paplotësuar.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se, për Akreditimin e UPT, sipas urdhrit nr.1564, datë 28.12.2016 nënshkruar nga administratori është ngritur Grupi i Vetëvlerësimit individual (GVI) me 28 punonjës të cilët kanë funksione akademike dhe për kryerjen e vetëvlerësimit individual me objekt vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, janë paguar sipas urdhër shpenzimeve nr. 1792, dhe 1793, datë 30.12.2016 në vlerën prej 1,507,886 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Grupi i audituesve, vlerëson dhe mendon se, mos funksionimi me kapacitet me kohë të plotë të Drejtuesve dhe personelit të Drejtorisë së Kurikulave, Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ka sjellë që ky grup pune i krijuar, deri diku ka bërë detyrat funksionale të drejtorive respektive. Kjo mangësi vjen dhe për faktin që nga ana e Senatit të UPT-së, ende nuk janë miratuar Draft Statuti dhe Draft Rregullore e funksionimit të Universitetit Politeknik i Tiranës.

Tashmë, jemi në kushte të funksionit të ligjit të ri Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH” dhe të VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” pika 16, ku citohet se, “*Personeli akademik, me kohë të plotë apo të pjesshme, nuk mund të ushtrojë asnjë funksion administrimi në institucionin e arsimit të lartë ku është punësuar, me përjashtim të zgjedhjes anëtar në Bordin e Administrimit*”, i cili i përjashton mundësinë e punësimit të personelit akademik si me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, pra nga drejtuesi i UPT-së (Rektori dhe Senati) duhet të përzgjidhen drejtues të drejtorive të mësipërme, të cilët duhet të mos jene pjesë akademike me kohë të plotë ose të pjesshme, pranë UPT-së, në mënyrë që të ushtrojnë detyrën administrative dhe akademike, në respekt të bazës ligjore.

Këshilli Administrav dhe Rektori i UPT, mbajnë përgjegjësi për mosfunksionimin e drejtorive të mësipërme me kapacitet të plotë dhe në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe për kryerjen e shpenzimeve pa efektivitet të fondeve publike për total shumë 822,892 lekë (si pasojë e përfitimit të shpërblimit prej 2 paga mujore /vit, për të 4 pozicionet drejtuese).

Për këtë rekomandojmë

Senati i UPT-së dhe Këshilli Administrav të marrin masa për plotësimin e organikës për Drejtorinë e Kurikulave, Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në mënyrë që kryerja e detyrave nga stafi drejtues, të jetë plotësisht e pavarur nga stafi akademik.

Menjëherë

2. Universiteti Politeknik i Tiranës, për periudhën prej daljes së ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë e në vijim, *nuk ka marrë asnjë masë për të përditësuar Statutin dhe rregulloret e funksionimit me ndryshimet ligjore që ka pësuar kuadri ligjor mbi arsimin e lartë, konkretisht ligji*”. UPT ka vijuar të funksionojë me Statutin e miratuar nga Senati në datën 25.06.2008, si dhe Rregulloren e Brendshme, miratuar me urdhrin nr. 60, datë 26.06.2015, të Rektorit të UPT. Për rrjedhojë, detyrat dhe të drejtat e personelit të institucioneve të arsimit të lartë nuk janë përcaktuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njëkohësisht edhe procedura e punësimit të personelit akademik pranë departamenteve të UPT është hartuar nga Rektorati në Tetor 2010, procedurë e cila nuk është rishikuar pas ndryshimeve që ka pësuar Ligji për Arsimin e Lartë. Kështu edhe kriteret për punësim për çdo kategori të personelit akademik dhe administrativ duhet të përcaktohen në përputhje me legjislacionin në statutin e institucionit dhe rregulloren e brendshme.

Për këtë rekomandoj:

Universiteti Politeknik i Tiranës, në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

marrë masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin e Statutit si dhe të rregulloreve mbi funksionimin e institucionit në nivel qendror dhe njësitë e vartësisë, si dhe të miratojë strukturën e përgjithshme të institucionit dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet në përputhje me përcaktimet e VKM nr.474, datë 16.6.2011.

Menjëherë

3. UPT për periudhën 05.05.2015, e në vijim, ka funksionuar me strukturën organike të miratuar në Këshillin Administrativ me vendimin nr. 2, datë 05.05.2015 “Për miratimin e strukturës dhe numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet”. Krijimi i drejtorive si Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike Drejtoria e Investimeve dhe Mirëmbajtjes nuk janë organizuar në përputhje me kërkesat e Vendimit nr.474, datë 16.6.2011, pika 21 ku citohet: “*Një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë të drejtuar nga një shef ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës*”. Për periudhën 05.05.2015 e në vijim, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ka në përbërje 2 punonjës (1 drejtor + 1 specialist), Drejtoria Juridike 3 punonjës (1 drejtor +1 përgjegjeës sektori + 1specialist), Drejtoria Ekonomike 4 punonjës (1 drejtor + 2 specialist+magaziner), Drejtoria e investimeve dhe mirëmbajtjes 2 punonjës (1 drejtor + 1 përgjegjeës sektori). Sektori i Auditit të Brendshëm si njësi organizative e veçantë, ka në përbërje 1 punonjës, në pozicionin përgjegjësit të sektorit. Ky sektor ka funksionuar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.474, datë 16.6.2011, “*Për përcaktimin e Standarteve të Procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike*”, pika 20 ku citohet: “*Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e vecantë kur në të jenë të paktën një pozicion shef sektori dhe dy vartës.....*”.

Për këtë rekomandojmë:

Senati i Universiteti Politeknik të Tiranës, në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” të hartojë strukturën e përgjithshme të institucionit dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet në përputhje me përcaktimet e VKM nr.474, datë 16.6.2011.

Menjëherë

4. Struktura Organike e UPT, nuk ka të plotësuar dhe as tejkaluar numrin e miratuar të punonjësve si për Rektoratin ashtu dhe në total me njësitë e vartësisë. Për vitin 2014 numri i punonjësve efektivë të miratuar nga ish KAD është gjithsej 744 dhe në fakt janë të punësuar 599 ose më pak 145 punonjës akademikë. Konstatohet, edhe pse numri i punonjësve akademikë efektivë nuk është realizuar, numri i punonjësve akademikë me kontratë është 471. Po i njëjti fenomen konstatohet edhe për vitet në vijim. Për vitin 2015 numri i punonjësve akademikë me kontratë është 378, dhe vendet vakant në stafin akademik janë 136 punonjës, për vitin 2016 numri i punonjësve akademikë me kontratë është 378 dhe vendet vakant në stafin akademik janë 157 punonjës, për tetë mujorin e vitit 2017 numri i punonjësve akademikë me kontratë është 330 dhe vendet vakant në stafin akademik janë 158 punonjës.

Për këtë rekomandojmë:



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Rektori i Universitetit Politeknik i Tiranës, në përmbushjen e misionit, arritjen e objektivave, rregullat e krijimit, organizimit, drejtimit dhe administrimit, të rishikojë ngarkesën mësimore të stafit akademik, në të gjitha nivelet e mësimdhënies si, një masë e rëndësishme për ngarkesën mësimore që lidhet me pakësimin e punonjësve akademikë të jashtëm me efekte pozitive në fondin e pagave, si dhe marrjen e masave për plotësimin e vendeve vakant, në strukturën organike të rektoratit si dhe të njësive të vartësisë.

Menjëherë

5. Dosjet e materialeve mbi procedurat e punësimit të personelit akademik janë arkivuar, por duke mos përmbushur plotësisht kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe të manualit mbi arkivimin e dokumentave. Dosjet nuk janë administruar me indeks të veçantë, sipas kërkesave të Kapitullit V, Formatit Standard nr. 17, ku evidentohen shkresat e fashikujt në veçanti si dhe pasqyrimi kronologjik i numrit të fletëve në dosje.

Për këtë rekomandoj:

Universiteti Politeknik i Tiranës, të marrë masa për arkivimin e të gjitha dosjeve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe të manualit “Mbi arkivimin e dokumenteve”.

Menjëherë

6. Nga auditimi i kryer me objekt programimin dhe realizimin e të ardhurave kryesore që krijon Universiteti Politeknik Tiranë, konstatohet se, njësitë vartëse (fakultetet) paraqiten me mosrealizim të të ardhurave, kështu për vitin akademik 2016-2017 nga 14,039 studentë të regjistruar, 36 % e tyre ose 5,166 studentë nuk kanë paguar tarifën e regjistrimit, ose më pak për shumën prej 122,341 mijë lekë, duke sjellë si pasojë që të ardhurat nga 522,236 mijë lekë të realizohen 316,266 mijë lekë ose 62 %. Ky mosrealizim vjen si pasojë e studentëve ngelës të paregjistruar në vitin pasardhës, e cila përbën një burim potencial i konsiderueshëm të ardhurash.

Për këtë rekomandoj:

Marrjen e masave për krijimin e një database të veçantë, që në zbatim të nenit 90, të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” të evidentohen të gjithë kategoritë e studentëve të ngelur ose që kanë pezulluar studimet me ligjin e vjetër, në mënyrë që koha për përfundimin e programeve mësimore sipas ligjit nr.80/2015 të mos jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programime qëllim për rrualtjen e vijueshmërisë së programeve studimore për rritjen e nivelit cilësor të studentëve të diplomuar

Menjëherë

7. Me miratimin e ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, konstatohet se, për herë të parë në historinë e IALP, ky ligj parashikon ekzistencën e dy titullarëve, Rektorin dhe Administratorin,



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

të cilët ushtrojnë kompetencat e tyre në fusha të ndryshme dhe pa varësi administrative nga njeri tjetri.

Konkretisht, në nenin 39 e vijues, të ligjit në fjalë, përcaktohet qartë se **“Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare**(pritje përcjellje të delegacioneve, autoriteteve të larta shtetërore, ceremonitë zyrtare etj), sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Gjithashtu në nenin 5, të ligjit, përcaktohet qartë se **“Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëkuptimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij ligji”**.

Nga auditimi konstatohet se, pas marrjes së detyrës nga Rektori i UPT, dhe interpretimeve të gabuara të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike midis Rektorit të Universitetit dhe Administratorit në drejtim të ushtrimit të detyrave funksionale të Autoritetit Kontraktor, nga Rektori është pretenduar se i takon këtij të fundit (rektorit) vendimmarrja në lidhje mbi procedurat tenderuese, kjo mënyrë veprimi ka sjellë si pasojë mbivendosje kompetencash dhe anulimin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje orendi dhe pajisje zyre për nevojat të Njërive të Universitetit Politeknik të Tiranës” me fond limit 37,600 mijë lekë**. Kështu në datën 01.06.2016, pikërisht ditën e hapjes së tenderit, Rektori, me shkresën nr.702, datë 01.06.2016 drejtuar APP-së, ka vendosur “Anullimin e procedurës së prokurimit të mësipërme, me argumentimin “për disa ndryshime në preventive”, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Nisur në këto kushte, nga operatorë ekonomikë ka pasur ankesa për sqarime pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e anulimit. Kjo situatë është krijuar për shkak se.

Anulimi i këtij tenderi, nga Rektori i UPT-së, ditën që do hapej procedura përbën tejkalim të kompetencave, veprim i cili është në kundërshtim me ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH”, ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” duke sjellë në këtë mënyrë të tejzgjatje të kësaj procedure deri në datën 09.09.2016, me 3 muaj vonesë.

Kjo situatë është zgjidhur, në bazë të interpretimeve shkresore, të kërkuara nga Administratori të UPT-së, me, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Financës, dhe me Vendimin e KPP-së, nr.530/3/2016, nëpërmjet të cilave Rektori i UPT-së, ka njohur pozicionin e vet.

Për këtë rekomandoj:

a. Në kushtet kur tejzgjatja e procedurave përtej afateve të parashikuara mbart risqe në mosrealizimin e objektivave dhe si pasojë risqe që lidhen me menaxhimin joefektiv të fondeve publike, nevojitet që nga ana e titullarit Akademik (Rektori) dhe titullarit të Autoritetit Kontraktor (Administratorit), ne vijim të merren masa që të bashkëpunohet, pa mbivendosje kompetencash me qëllim moscënimin e punës dhe arritjen e objektivave institucionale, në respekt të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në RSH” dhe ligjit për “prokurimin publik” dhe çdo bazë ligjore që lidhen me to.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR "MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Vazhdimisht

8. Nga auditimi me objekt "Ndërtimi i shtesës së Korpusit Kryesor të Universitetit Politeknik të Tiranës", rezultoi se :

- Nga ana e Institutit të Monumenteve të Kulturës, me shkresë, nr. 1472 prot. datë 22.09.2014, Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit , i janë drejtuar Universitetit Politeknik Tiranë, është kërkuar hartimi dhe miratimi i projektit të shtesës së Korpusit Kryesor në Këshillin Kombëtar të Restaurimit, me qëllim unifikimin e veshjes së jashtme duke u referuar materialeve të fasadës së korpusit qendror të UPT, i shpallur Monument Kulture i kategorisë së dytë me urdhër nr. 122 prot. datë 05.03.2007, në bazë të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore", ku në thelb është kërkuar dhe ndryshimi i fasadës së shtesës së UPT-së, duke mos e bërë eficiente projektin e mëparshëm që fondet publike të përdoren me ekonomicitet.

-Me vendimin e Ministrisë së Kulturës nr. 128, datë 11.12.2014, është miratuar projekti "Rehabilitimi dhe trajtimi i fasadave të dy shtesave anësore dhe objektit fundor të UPT-së", ku në bazë të relacionit të mbikëqyrësit të punimeve nr. 147 prot. datë 16.04.2015, është shpjeguar se, ndryshimi i projektit të fasadës, ku janë llogaritur volumet e punës, duke hartuar preventivin e rishikuar të fasadës.

-Nga auditimi, zërat e pandryshuar të cilat ishin në preventivin fillestar, ruajtën të njëjtin çmim njësi, ndërsa zërat e rinj u vendosën me negocim. Në procesverbalin e datës 20.04.2015, midis palëve, është negociuar për çmimet e reja, ku zëri "Veshje fasade me pllaka mermer traventinë 100 cm x 50 cm, trashësi 3 cm, me ngjyrë dhe teksturë si monumentet e kulturës në sheshin "Nën Tereza", e ventiluar, me strukturë mbajtëse metalike të galvanizuar, me ankorim vida inoksi, me kapëse çeliku inoksi", u propozua me 8,800 lekë/m² dhe pas negocimit u ul me 240 lekë/m², ku u miratua çmimi 8,560 lekë, ku sasia përfundimtare rezultoi 2,858.75 m², me vlerë 24,470,900 lekë pa TVSH. Ndërkohë me projekt-preventivin fillestar zëri nr. 30 "Veshje me fasadë me pllaka traventinë trashësi 3 cm, e ventiluar, me strukturë mbajtëse metalike e galvanizuar, me ankorim vida inoxi, me kapëse çelik inox", ka qenë e parashikuar në sasinë prej 451 m², me çmim të ofertuar 1,800 lekë/m². Në thelb zëri i veshjes me traventinë është në kuptimin e njëjtë të procesit të punës, por me ndryshimin e fasadës dhe përmasave të saj ka ndryshuar edhe çmimi.

Përsa më sipër, ndryshimi i fasadës u shoqërua edhe me ndryshim preventivi shtesë i kontratës me vlerë prej 54,401,280 lekë me TVSH, me financim buxheti i shtetit. Ky ndryshim vjen si rrjedhojë e mos koordinimit të Institucioneve të nivelit qendror me UPT-në, duke sjellë si pasojë rritjen e vlerës së kontratës dhe koston e objektit, si dhe përdorim jo efektiv i fondeve publike të akorduara shtesë nga buxheti i shtetit, për shkak të ndryshimit të projektit fillestar.

- Kontrata për punë publike nr. 16/42 prot. datë 28.02.2013, e lidhur midis Autoritetit Kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, dhe bashkimit të operatorëve ekonomik " & D sh.p.k", sipas nenin 40.2 të kontratës, Garancia e punimeve prej 5 % të vlerës së kontratës e cila është përcaktuar 12 muaj pas përfundimit të punimeve nga operatori ekonomik. Nga auditimi rezultoi se, në garanci janë futur zëri i punimeve dhe zëri i mallrave të inkuorporuar në objekt gjatë punimeve. Kështu, duke u nisur nga natyra komplekse, e këtij investimi, duhej që nga AK të kishte përcaktuar qysh në fillim në DT, afatin prej 24 muaj garanci punimesh, pasi grupi i audituesve ka konstatuar, që në zonën e parkimeve ka lagështi, e cila detyrimisht do të kërkojë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

mirëmbajtje nga AK (për mos dëmtim objekti). Po kështu edhe pajisjet si, ashensorë, sistemit kundra zjarrit etj, u konstatuan mosfunksionime normale të tyre, duke kërkuar shërbime dhe mirëmbajtje të ndryshme. Për sa më sipër, përcaktimi i një garancie kohore me të gjatë nga sa është parashikuar, mirëmbajtja dhe difektet e ndryshme do të bëheshin nga operatori ekonomik fitues dhe jo nga Autoriteti Kontraktor sikurse ndodh në fakt.

-Kontrata është likuiduar me 26 situacione pjesore progresive dhe 4 situacione pjesore progresive të shtesës së kontratës, të cilat nuk janë shoqëruar me librezë masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, pika 8.1 ku citohet se, “*situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori*”. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës. Në disa zëra të punimeve elektrike, ngrohje etj, tabela e lëvizjes së volumeve nuk pasqyron të detajuar sasinë e realizuar në fakt.

Për këtë rekomandoj:

-Nga Autoriteti Kontraktor në të ardhmen mbi investimet komplekse, duhet përcaktuar periudhë më e gjatë garancie qysh në hartimin e dokumenteve të tenderit, duke ekonomizuar shërbime për mirëmbajtjen apo defekte të ndryshme. Për pajisjet, të kërkojë certifikatë origjine dhe certifikatën e garancisë, në mënyrë që të planifikohet saktë shërbimi për mirëmbajtjen e tyre.

-Nga Autoriteti Kontraktor të ngrihet një grup teknik i specializuar mbi verifikimet përfundimtare të objektit, në zërat të cilat nuk janë argumentuar me librezë masash, duke realizuar bilancin total përfundimtar të vlerës së investimit.

Menjëherë në vazhdimësi

9.Nga auditimi në tenderin me objekt " *Blerje dhe instalim i sistemit të kamerave për sigurinë e objekteve të UPT* ", përllogaritja e vlerës limit të kontratës, nga grupi i studimit të tregut, *nuk rezulton të jetë vendosur ndonjë referencë* mbi cilësinë, parametrat kryesorë të kamerave, në mënyrë që të përcaktohej saktë vlera e përllogaritur e kontratës për sistemin e survejimit, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VII, neni 59, “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës”.

Gjithashtu, në DT, nga grupi për hartimin e specifikimeve teknike dhe termave të referencës, janë vendosur indirekt parametra cilësie vetëm të një produkti nga një prodhues i vetëm, ku operatorët ekonomik janë orientuar drejt një prodhuesi të paracaktuar, pasi është vendosur autorizim prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, duke favorizuar operatorë të cilët gëzojnë autorizim e prodhuesit, e për pasojë kemi ulje të konkurrencës në mënyrë të ndjeshme.

Për këtë rekomandoj:

-Autoriteti Kontraktor në rastet e studimit të tregut, duhet të vendosë referenca mbi cilësinë dhe parametra kryesorë të pajisjeve të ndryshme elektrike-elektronike, në mënyrë që të përcaktojë më saktë vlerën e përllogaritur të kontratës.

-Autoriteti Kontraktor, në të ardhmen të marrë masa që në specifikimet teknike dhe termat e referencave të përdoren standarde dhe parametra normale cilësie, të përshkruhet qartë dhe saktë infrastruktura e rrjetit ekzistues, në mënyrë që të mund të marrin pjesë edhe prodhues të



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

ndryshëm. Të mos vendoset autorizimi i prodhuesit në rastet kur është e pamundur mospërdorimi i markave, me qëllim rritjen e konkurrencës në treg.

Menjëherë në vazhdimësi

10. Nga auditimi i procedurave me objekt “*Shërbimi i informatizimit të aktivitetit dhe dokumentacionit të sekretarive mësimore*”, për vitet, 2014, 2015, 2016” rezultoi se, ky shërbim është përftuar për nevojat e UPT-së, nga njëti operator ekonomik “B” shpk. Nga auditimi konstatohet se në rastin konkret ndonëse është i njëti shërbim, vlera e këtij shërbimi është rritur pa asnjë argument nga viti në vit, e konkretisht për vitin 2014, operatori ekonomik është likuiduar për vlerën prej 1,600,000 lekë pa TVSH, për vitin 2015 ku shërbim është kryer me vlerën prej 1.855,000 lekë pa TVSH dhe për vitin 2016 vlera e tij është rritur në shumën prej 1,918,800 lekë pa TVSH, pra në total ku shërbim ka kushtuar 5,373,000 lekë pa TVSH. Nëpërmjet këtij shërbimi, është realizuar përmbushja e qëllimit mbi mundësimin e funksionimit informatik në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, emetimin e dokumenteve zyrtare të provimeve si dhe ofrimi i shërbimeve më cilësore ndaj studentëve dhe pedagogëve në funksion të procesit mësimor.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se, ky program dhe ky shërbim nuk do të jetë funksional, pasi UPT, po implementon dhe do vërë në funksion infrastruktura hardëare për instalimin lokal të sistemit UGOV, kjo në kuadër të projektit të ndërtimit të rrjetit telematik për Universitet Shtetërorë Publike, sipas ligjit nr.9704, datë 02.04.2007 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një Qendre Shërbimesh dhe të një Rrjeti Telematik për Universitetet”

Pra si konkluzion, nga ana e AK të Universitetit Politeknik të Tiranës, për tre vitet e mësipërme, nga të ardhurat dytësore, u sigurua shërbimi i informatizimit të “SEKRETARIA”, i cili tashmë, nuk do të funksionojë, si pasojë e mungesës së hartimit të projekteve afatgjata dhe koordinimit të veprimeve të UPT-së me Ministrinë e Arsimit dhe më gjerë, duke sjellë përdorim të fondeve publike, pa eficiencë, pa efektivitet dhe pa ekonomikitet, të cilat në total llogariten në vlerën prej 5,373,000 lekë pa TVSH.

Për këtë rekomandoj:

Nga ana e Autoritetit Kontraktor të UPT-së, të merren masa që programimet buxhetore afatmesëm dhe afatgjata të orientohen nga masterplanet strategjike të Qeverisë dhe Ministrisë së Arsimit në bashkëpunim me njësitë vartëse dhe në veçanti projektet Informatike (IT) të jenë të qëndrueshme dhe afatgjata, duke siguruar që çdo shpenzim i realizuar, të jenë të mirëstudiuara në koordinim me strukturat qeveritare në nivel qendror dhe lokal, për të pasur performancë maksimale në përdorim të fondeve publike.

Menjëherë në vazhdimësi

11. Nga auditimi i të gjitha procedurave të prokurimit për mallra, shërbime dhe rikonstruksione, për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017, të përzgjedhura nga grupi i KLSH-së konstatohet se, në Universitetin Politeknik të Tiranës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, sektori i prokurimeve (sipas organigramës organizative) është caktuar si Njësi e Prokurimit, por e pa shoqëruar me Urdhrin përkatës, nga Titullari i AK. Gjithashtu në disa raste anëtarët e komisioneve të



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

posaçme (kur kjo detyrë i është ngarkuar një strukturë tjetër), janë burime njerëzore të pa trajnuara pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike (APP), për pasojë u evidentuan mangësi të elementeve të procedurave prokuruese, si në përlogaritjen e fondit limit, në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, të cilat duhet t'i paraqesin në mënyrë të hollësishme dhe argumentuar për çdo kriter të vendosur prej tyre duke i pasqyruar në dokumentat e tenderit.

12. Nga auditimi, rezultoi se, në procedurat “*Kërkesë për propozim*” të realizuara gjatë vitit 2014, me objekt “*Blerje dokumentacioni specifik*”; “*Blerje orendi dhe pajisje zyre*”; “*Shërbim për mirëmbajtjen e ndërtesave*”, nga ana e Njesisë së Prokurimit, për hartimin e fondit limit është mbështetur në oferta të sjella nga operatorë ekonomikë, të cilët nuk kanë paraqitur NIPT-in, e për pasojë fondi limit konsiderohet “fiktiv”. Ftesa për ofertë u është dërguar 5 operatorëve ekonomikë dhe jo nga një listë e përditësuar, si dhe pa argumentuar arsyen e përzgjedhjes së tyre, në një proces verbal të veçantë, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu VI, geramat “b” dhe “c”.

Ndërsa për vitet 2015, 2016 dhe 2017, kjo e mangësi nuk është konstatuar, pasi AK ka zbatuar përputhshmërinë ligjore të realizimit të procedurave tenderuese të financura nga fondi i UPT-së.

13. Nga auditimi rezultoi se, raporti përmbledhës i hartuar nga Komisionet e Vlerësimit të Ofertave dhe i miratuar nga titullari i Autoriteti Kontraktor i UPT-së, nuk përmban në mënyrë të detajuar; referencën e procedurës, përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve, çmime/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës, ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit, ofertuesin e renditur të parin, informacionin nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrja në lidhje me to, në kundërshtim me ligjin nr 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, (VKM nr. 1, datë 10/01/2017, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”) dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 68.

14. Nga auditimi rezultoi se, të gjitha dosjet e procedurave prokuruese që na u vunë në dispozicion, ishin te pa inventarizuara në kundërshtim me ligjin “Për arkivat”. Plotësimi dhe administrimi i dosjeve nuk paraqitet në nivelin e kërkuar, pasi nuk janë arkivuar, nuk janë nënshkruar si nga marrësi në dorëzim ashtu dhe nga dorëzuesi. Dosjet e procedurave prokuruese nuk janë plotësuar sipas ligjit për arkivat, ka mungesë të dokumentacioneve shoqëruese, kryesisht mungon në dosje përlogaritja e fondeve limit, apo dokumente të tjera, në kundërshtim me Ligjin “Për Prokurimin Publik”, Kreu II, neni 12, pika 3.

Për pikat 11,12,13, dhe 14 rekomandoj:

-Në fillim të çdo viti të veprimtarisë ushtrimore të ngrihet Njësia e Prokurimit e miratuar me Urdhër nga Titullari i AK .

-Të shmanget fiktiviteti në studimin e tregut për prokurimet për blerje mallra, duke marrë oferta nga ato subjekte të regjistruara në QKL që kanë si aktivitet kryesor mallin, punën apo shërbimin që do prokurohet.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

-Në dokumentet e tenderit të hartohen dhe paraqiten në mënyrë të hollësishme duke e argumentuar për çdo kriter të veçantë.

- Anëtarët, në grupet e punës për llogaritjen e vlerës së kontratës dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përzgjidhen nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, në cilësinë e specialistëve të fushës së prokurimit ose të aplikohet marrja e ekspertëve të jashtëm, në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve, të vendosen specialistë të fushës përkatëse, dhe të trajnohen anëtarët e saj, pranë Agjencisë së Prokurimeve, me qëllim që të rritet efica e përdorimit të burimeve dhe fondeve publike në dispozicion.

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimimit të përgatitë raportin përmbledhës, ku një vend të veçantë duhet për ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit, informacionin nëse ka pasur ankesa dhe vendimarrja në lidhje me to.

Vazhdimisht

15.Nga auditimi rezultoi se, në bazë të kërkesave për mallra, shërbime ose punë, të paraqitura nga administrata e Rektoratit (AK) për vitet buxhetore, 2014, 2015, 2016 dhe 2017, është përgatitur regjistri i parashikimeve, brenda datës 15 janar të çdo viti, por nga ana e KAD (Këshillit Administrues Drejtues), tashmë i emërtuar Bordi i Administrimit (BA) krijuar në bazë të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, detajimi i fondeve është miratuar me vonesë dhe janë dërguar jashtë afateve në Ministrinë së Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencisë së Prokurimeve Publike. respektivisht:

Për vitin 2014, sipas vendimit të KAD nr. 2, datë 08/04/2014 për “Miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2013 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2014”;

Për vitin 2015, sipas vendimit të KAD nr. 3, datë 05/05/2015 për “Miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2014 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2015”;

Për vitin 2016, sipas vendimit të KAD nr. 2, datë 11/02/2016 për “Miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2015 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2016”;

Për vitin 2017, sipas vendimit të BA nr. Nr. 23, datë 04/05/2017 “Miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2016 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2017”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, (VKM nr. 1, datë 10/01/2017, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”) dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”neni 4 dhe Udhëzimit të APP nr. 2, dt 27.01.2015.

Për këtë rekomandoj:

Bordi i Administrimit, në përmbushje të misionit të tij, duhet të kryejë me përputhshmëri, me rregullshmëri dhe në kohë, funksionet e tij konform dispozitave ligjore, me për të mos shkaktuar vonesa për parashikimet dhe realizimet e procesit të prokurimeve, sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Menjëherë në vazhdimësi



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

16. Nga auditimi rezultoi se, në administratën e Rektoratit të UPT-së, ende nuk është plotësuar njësia e auditimit të brendshëm, rekomandim i lënë në auditimin e mëparshëm të KLSH-së, sipas Raportit Përfundimtar me shkresë nr.850/7 prot datë 05.05.2014.

Në strukturën organike aktuale (e cila ende nuk është e miratuar dhe vazhdon të jetë në një proces të tejzgjatur për pozicionimin e saj), ekziston “struktura” me 1 përgjegjes sektori dhe 1 specialist (vakand), ku vetëm përgjegjësi i sektorit është i punësuar, kjo në kundërshtim me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin public” i ndryshuar.

Nga ana e titullarëve të UPT-së (ish Rektori dhe Rektori aktual), nuk është përmbushur detyrimi ligjor dhe administrativ, për plotësimin e vendeve vakande në sektorin e auditit. Kjo strukturë organizative nuk plotëson kërkesat e minimumit ligjor, 1 drejtues dhe 2 specialistë, gjendje e cila vazhdon edhe me momentin e miratimit të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”.

Kështu, nga ana e Rektorit në cilësinë e Kryetarit të Senatit, organ i cili sipas ligjit miraton paraprakisht ndryshimet në strukturën e institucionit, nëpërmjet mosveprimit ka refuzuar të paraqesë për shqyrtim në senat, propozimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe Administratorit, sipas shkresës nr.1090 prot datë 21.09.2016, për plotësimin e kësaj njësie në përputhje me kërkesat dhe aktet nënligjore në fuqi. Ky veprim është bërë në kundërshtim me ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, neni 38 pika 1/ç.

Gjithashtu, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, vendim marrja për plotësimi e strukturës së auditimit është në koordinim midis Rektorit dhe strukturës kolegjiale (Bordi i Administrimit).

Kështu, nga Bordi i Administrimit, me shkresë nr.7 prot datë 08.02.2017, ka vlerësuar se është e domosdoshme që veprimtaria e njësisë së auditimit të brendshëm, të pezullohet deri në shqyrtimin dhe marrjen e një vendimi për veprimtarinë e sektorit në fjalë, kjo në kundërshtim të detyrave dhe përgjegjësi të tij ligjore, e për rrjedhojë që nga muaji shkurt të vitit 2017 e në vazhdim, pranë UPT-së, ndonëse me një strukturë të paplotë nuk realizohet qëllimi i misionit të auditimit, gjë që e ngarkon me përgjegjësi Bordin e Administrimit.

Edhe pse *Njësia e auditit të Brendshëm, për vitin 2015, 2016 dhe 2017*, ka vijuar punën ndonëse me strukturë të paplotësuar, nga auditimi u konstatua se, kjo punë audituese nuk e justifikon qëllimin dhe misionin që duhet të këtë struktura audituese e brendshme e njësisë publike, duke rezultuar në raporte auditimi jocilësore. Auditimi i Brendshëm është një prej dy shtyllave themelore të Kontrollit të Brendshëm i cili duhet të shërbejë si filtër kontrolli brenda institucionit.

Për këtë rekomandoj:

Senati i UPT dhe Bordi i Administrimit, të marrin të gjitha masat për ringritjen e strukturës së auditimit të brendshëm , me 1 drejtues dhe 2 specialistë, të cilët duhet të jenë në funksion të përmirësimit të gjendjes menaxheriale të përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare, me qëllim



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

përdorimin efektiv të fondeve publike dhe sigurimin e cilësisë së punës në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe njësitë universitare të varësisë.

Menjëherë

17. Nga auditimi, në lidhje me objektin “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ligjore për rikthimin në detyrë të z.I”, rezultoi se, z. I mban titullin “Profesor”, i cili ka qënë në marrëdhënie pune pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, deri në datën 06.09.2009, me detyrë punonjës kërkimor –shkencor (personel akademik) në departamentin e teknologjisë të Gjeoinformacionit, pranë ish Institutit të Gjeoshkencave. Më pas në periudhën nga data 07.09.2009 deri në datën 08.09.2013, z.I ka ushtruar funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë, referuar vertetimit nr.24 prot, datë 24.11.2014 të Kuvendit të Shqipërisë.

Me mbarimin e mandatit të deputetit, z.I i është drejtuar UPT-së me kërkesë nr.1106 prot, datë 24.09.2013, duke kërkuar rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, si pedagog dhe jo si punonjës kërkimor–shkencor (personel akademik) në departamentin e teknologjisë të Gjeoinformacionit, pranë ish Institutit të Gjeoshkencave, gjë që e cila nuk u mundësua, për shkak se nga Universiteti Politeknik i Tiranës, i ka kthyer përgjigje, z. I duke refuzuar kërkesën për kthimin në detyrën e mëparshme, për shkak se, pika 7 e nenit 50 të ligjit “Për arsimin e lartë” e cila parashikon këtë të drejtë, ka hyrë në fuqi me ndryshimet e bëra me ligjin nr.10307, datë 22.07.2010, pra pas largimit nga detyra, e po ashtu nuk rezulton që midis palëve të ketë ndonjë marrëveshje të shkruar për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës në përfundim të detyres së funksionarit public, pasi nga ana e Departamentit, për të plotësuar nevojat e veprimtarisë mësimore në këtë department, është punësuar sipas procedurave përkatëse personel akademik me kohë të plotë.

Z.I, ka kërkuar pranë dy shkallëve të Gjykatës Administrative Tiranë, të drejtën për kthimin në vendin e punës si pedagog i përhershëm, por në të dyja vendimet e Gjykatës Administrative , është marrë vendimi për kthimin si punonjës shkencor akademik dhe jo si pedagog. Gjithsesi, theksojmë që është gabim i rrëndë që nuk është vepruar menjëherë pas përfundimit të procesit gjyqësor për rikthimin e tij në punë. Me zgjedhjen e Rektorit, me Vendimin nr.50 datë 28.07.2016, është vepruar drejt që Prof.Dr. I është rikthyer në detyrën e mëparshme si personel akademik me kohë të plotë në Institutin e Gjeoshkencave Energjisë Ujit dhe Mjedisit, duke filluar marrëdhënie financiare në të njëjtën datë me vendimin e mësipërm

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga ana e Rektorit të Universitetit Politeknik të Tiranës, në bazë të nenit 22 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Status i deputetit” i ndryshuar është parashikuar se: “*Institucionet e administratës publike, në të cilat deputetët kanë qënë të punësuar, pas mbarimit të mandatit të deputetit dhe nëse nuk kanë arritur moshën e pensionit, janë të detyruar ta rikthejnë atë në vendin e mëparshëm të punës*” si dhe duke respektuar autonominë dhe lirinë akademike të Universitetit Politeknik të Tiranës, si dhe në bazë të ligjit nr. 80/2015 datë 19.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH”, i njihet e drejta e rikthimit në detyrë, duke interpretuar ligjin me frymën pozitive për individin, duke mundësuar pa diskutim rikthimi i z.Hoxha si personel akademik pranë UPT-së.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

C. REKOMANDIME PËR MASA ZHDENTIMI

1. Sipas nenit 5 ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në zbatim të këtij neni “Bordi i Administrimit të UPT cakton në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe përcakton pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit”.

Për sa më lart, ndonëse ligji i jep autonomi, por kjo pavarësi është e kushtëzuar nga të ardhurat financiare, pasi për realizimin e misionit të tij, UPT financohet nga buxheti i shtetit me rreth 75 % të fondeve dhe në këto kushte nuk mund të caktojë vetë pagat pa u mbështetur në dispozita të tjera nënligjore që duhet të rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni që deri sot nuk kanë dalë e për rrjedhojë është krijuar vakum ligjor në interpretimin dhe funksionimin e autonomisë së UPT. Mungesa e dispozitave të tjera ligjore në përcaktimin e formës së institucionit, nuk lejon që Bordi i Administrimit të ushtrojë këtë funksion.

Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht nga ky kusht, Bordi i Administrimit me vendimin nr. 18, date 03.02.2017 ka miratuar dhe rritur masën e shpërblimit për veten e vet me shumë se 2 herë, duke përfutur padrejtësisht shumën prej **280,281 lekë**. Miratimi i tarifave të shpërblimit të anëtarëve të Bordi i Administrimit, është jo vetëm në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.02.2012, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore” lidhja nr. 1, por përben edhe konflikti interesi, pasi në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar është përcaktuar: “Interesat privatë të zyrtarit janë ato interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga, të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre”.

Për këtë rekomandoj:

Marrjen e masave ligjore për arkëtimin e vlerës së përfutur nga Kryetari i Bordit të Administrimit, dhe anëtarët e tjerë në shumën prej **280,281 lekë**, sipas lisës nr. 1, bashkëlidhur vendimit.

2. Në muajin qershor 2016 është likuiduar Agjencia e Akreditimit, në shumën prej 1,965,000 lekë me objekt “Vlerësimin e akreditimit të Universitetit Politeknik Tiranë”. Dokumenti justifikues i paraqitur për kryerjen e pagesës me emërtimin “Faturë arkëtimi”, është një fletë formati A4, jo sipas modelit të miratuar me ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 101 “Përmbajtja e faturës”, pasi nuk ka të dhëna për: numrin serial që e identifikon faturën, nuk ka numrin e identifikimit të TVSH-së të personit të tatueshëm që kryen furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, sipas përcaktimit të nenit 92, të këtij ligji.

Kjo pagesë është bazuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave nr. 29/1, datë 16.08.2016 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”. Ky udhëzim mbështetet në nenin 62, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

aktualisht i shfuqizuar. Kjo pagesë nuk ka mbështetje ligjore dhe është e pajustificuar pasi, Akreditimi i UPT është bërë në kohën hyrjes në fuqi të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në nenin 5, të këtij ligji, “Roli i shtetit në arsimin e lartë”, pika 2, germa “b” përcaktohet se: “Shteti, nëpërmjet organeve dhe strukturave përgjegjëse të tij, është përgjegjës për monitorimin e standardeve në arsimin e lartë për hapjen dhe akreditimin e institucioneve e të programeve të studimit që ato ofrojnë”.

Krahas pagesës së mësipërme për akreditimin e UPT, është ngritur Grupi i Vetëvlerësimit individual (GVI) me objekt “Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies”. Për punën e kryer ky grup është paguar në shumën prej **1,507,886 lekë**, pagesë e cila është e pajustificuar dhe e paargumentuar pasi vetëvlerësimi duhet të kruhej nga “Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” e cila ka për objekt kryerjen e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, si një kusht për Akreditimin e UPT-së.

Për këtë rekomandoj:

Marrjen e masave ligjore për arkëtimin e vlerës së përfituar nga Grupi i Vetëvlerësimit (GVI) në shumën prej 1,507,886 lekë, sipas tabelës bashkëlidhur urdhër shpenzimeve nr. 207, 208, 209, 213, datë 22.02.2017.

C.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Nga auditimi, në lidhje mbi vlerësimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën tenderuese me objekt “*Blerje dhe instalim i sistemit të kamerave për sigurinë e objekteve të UPT, viti 2016.*”, është s’kualifikuar operatori ekonomik “F” sh.p.k , për shkak të specifikimeve teknike dhe termave të referencave, të cilat rezultuan se i plotësonte vetëm një prodhues në treg, pasi specifikimet teknike të kamerës të markës “D”, të paraqitur prej tij nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në DST markës “H”.

Autoriteti kontraktor nuk duhej të kishte përcaktuar terma të referencave të produkteve të markës “H” dhe të vendoste parametra normal cilësie, duke vendosur kriteret që të nxisin konkurrencën dhe duke zgjeruar tregun e produkteve, atëherë OE “F” sh.p.k (me kamerat e markës “D”), do të ishte shpallur fitues me vlerë më të ulët, në të cilën asnjë kamerë apo produkt, nuk mund ti plotësojë plotësisht 100 % specifikimet teknike të DST (përveç markës “H”) dhe diferenca midis 2 ofertave të kamerave të markave të ndryshme në vlerën **1,707,332 lekë me TVSH**, përbën menaxhim pa efektivitet dhe efikasitet të fondeve të UPT.

Për këtë rekomandoj:

Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që në të ardhmen, në programimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit për mallra, shërbime dhe punë të hartohen kërkesa për kualifikim që sigurojnë konkurrencën e nevojshme të prokurimit për të arritur rezultate të dëshirueshme në menaxhimin me efikasitet të përdorimit të fondeve publike.

Menjëherë në vazhdimësi



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

2. Nga auditimi i shpenzimeve operative konstatohet se, në tre raste janë kryer shpenzime pa efektivitet, në shumën prej **1,103,741 lekë**, e konkretisht:

a. Me urdhër shpenzimin nr. 741, datë 31.05.2016 është likuiduar shoqëria private “E” në shumën 185,741 lekë, sipas shkresës së ish Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 5232/1, datë 20.05.2016 me objekt: *“Organizimin e panairit pranë City Park për njohjen e kriterëve të pranimit të maturantëve në vitin akademik 2016-2017”*.

Shkresa e mësipërme është dërguar për zbatim nga 14 Universitet Shtetërorë, për të lidhur kontratës me subjektin “E” me objekt *“Organizimin e panairit pranë City Park për njohjen e kriterëve të pranimit të maturantëve në vitin akademik 2016-2017”*.

Pagesa e kryer me tarifën 70 Euro/m² për stendën e vendosur nga UPT në “E”, është kryer pa procedurë prokurimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në kundërshtim me ligjin “Për prokurimin publik”, pagesë e cila përbën përdorim pa efektivitet të fondeve publike, pasi për kryerjen e këtij aktiviteti, ish Ministria e Arsimit duhej të përdorte ambientet e çdo Universiteti, si dhe publikimin e kriterëve në faqen zyrtare të MASH dhe të 14 Universiteteve të vendit, apo mënyra të tjera komunikimi me median e shkruar dhe elektronike.

b. Në muajin Gusht 2015 dhe 2016 janë kryer shpenzime në shumën prej 918,000 lekë, për shërbimin e kryer nga shoqëria “Pass-Programi Alternativa sociale Stimulue” për akomodim, trajtim ushqimor dhe shpenzime transporti në Jalë, për këshillat studentorë të UPT, me objekt *“Njohjen dhe zbatimin e neneve të rregullores së këshillave të fakulteteve”*.

Kjo kategori shpenzimi konsiderohet pa efektivitet dhe e paargumentuar, pasi njohja e rregullores të këshillave studentore do të ishte më efektive të bëhej gjatë vitit shkollor në ambientet e universiteteve. Gjithashtu zhvillimi i këtyre aktiviteteve në muajin Gusht në JALË, që “përkon” me zhvillimin e aktiviteteve rinore të disa partive politike nxit joshjen e studentëve në politikë, ndërkohë që ata duhet të kenë objektiv përgatitjen cilësore. Këto veprimtari janë në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 80/2015, pika 3 ku përcaktohet se: *“Institucionet e arsimit të lartë ruajnë neutralitet politik”*.

Për këtë rekomandoj:

-Të analizohen nga Senati dhe Bordi i Administrimit të gjitha rastet e shpenzimeve që shkaktojnë kosto të panevojshme dhe të përcaktohen detyrime të qarta ndaj personave që kryejnë procedura prokurimi me efekte financiare për buxhetin e institucionit dhe të konsiderohen shkelje e disiplinës në punë dhe në çdo rast të shoqërohen me masa disiplinore apo administrative.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Nga auditimi në njësitë vartëse pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, konstatohet se, me vendimin e Senatit dhe Bordit të Administrimit nr. 5, datë 01.11.2016 është vendosur “Hapja e degës së Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU) në qytetin e Korçës, për zhvillimin e masterit profesional me objekt: *“Restaurimin e monumenteve të kulturës”*, në të cilin janë miratuar edhe efektet financiare të hapjes së kësaj dege.

Sipas programit financiar, shpenzimet për hapjen e kësaj dege do përballohen nga tarifat e regjistrimit dhe të shkollimit për 50 studentë, në shumën totale prej 5,125,000 lekë. Në fakt



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

janë regjistruar 37 studentë nga të cilat janë realizuar të ardhura në shumën prej 3,792,500 lekë, ndërsa shpenzimet në përfundimin të vitit akademik janë parashikuar në shumën 12,307,000 lekë.

Nga të ardhurat e realizuara mbulohen vetëm 30 % e shpenzimeve, fakt që tregon se do ishte më efektive që hapja e kësaj dege të bëhej pranë Fakultetit të Arkitekturës në mbështetje të nenit 1, të ligjit 80/2015 pika c, me qëllim “Ofrimin e mundësive të barabarta për të përfituar nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës”.

Duhet theksuar se, hapja e kësaj dege në Korçë nuk gjen mbështetje në nenin 29, të ligjit nr. 80/2015, pika 3, ku përcaktohet se: *“Kriteret dhe procedurat për hapjen e degëve të institucioneve të arsimit të lartë, vendase dhe të huaja, të akredituara në vendin e origjinës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”*.

Kronologjia e hartimit dhe miratimit të dokumentacionit nga ish Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe vendimi i Senatit dhe Bordit të Administrimit, nuk rezultojnë të jenë në koherencë me dispozitat ligjore pasi:

Këshilli i Akreditimit me vendimin 145, datë 31.03.2016 “Për hapjen e programit të ciklit të dytë master profesional në “Restaurim Monumentesh Kulturore” të Universitetit politeknik të Tiranës, është bazuar në ligjin nr.9741, datë 21.03.2016. Fakt që tregon se, vendimi i Senatit dhe Bordit të Administrimit është marrë në një kohë që ligji për Arsimin e Lartë është shfuqizuar nga dalja e ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015. Ministri me urdhrin nr. 191, datë 22.04.2016 autorizon hapjen e kësaj dege pasi programi mësimor t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, ndërkohë që sipas dokumentacionit që administrohet, procesi i akreditimit ka përfunduar rreth 1 muaj para daljes së urdhrit të ministrit (31.03.2016). Këshillit të Akreditimit ka vendosur që forma e studimit në këtë degë të jetë më kohe të plotë, pra mësimi do të zhvillohet në ditët zyrtare të punës, dhe stafi pedagogjik do të sigurohet nga Fakulteti i Arkitekturës Tiranë. Nga verifikimi i kryer konstatohet se mësimi nuk është zhvilluar gjatë ditëve zyrtare të punës, pasi nga auditimi i shpenzimeve rezultuan pagesa të “shpenzimeve udhëtim e dieta” pjesore në shumën prej 102,500 lekë gjatë ditëve të shtuna dhe të diela deri në datën 31.05.2017 (pa llogaritur shpenzimet e kësaj natyre deri në fund të programit mësimor). Pagesa e shpenzimeve udhëtim e dieta për ditët e shtuna dhe të diela është në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 20.04.2016 “Për disa ndryshime në VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës Brenda vendit”, Kreu I, ku përcaktohet se, punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme të cilët trajtohen financiarisht për shërbim jashtë qendrës së banimit vetëm gjatë ditëve zyrtare të punës.

Për këtë rekomandoj:

Nga ana e titullarit Akademik (Rektorit) dhe titullarit të Autoritetit Kontraktor (Administratorit), të vazhdohet, koordinimi dhe bashkëpunimi, pa mbivendosje kompetencash, në respekt të frymës së mirëkuotimit dhe të zbatimit të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdimisht

V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

-Miratimi i ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, është shoqëruar me mbivendosje kompetencash, për shkak të interpretimeve të ndryshme të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike mes Rektorit të Universitetit dhe Administratorit në drejtim të ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe veprimeve administrative. Kështu, mjaft praktika, administrative, financiare dhe realizimi i prokurimeve, në disa raste kanë rezultuar me probleme, si rezultat i mos zbatimit të nenit 141, e Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH”, **(mosmiratimi i akteve nënligjore brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit).**

Deri më tani, nga Ministria e Arsimit, Sporti dhe Rinisë në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, nuk janë hartuar dhe miratuar një pjesë e rëndësishme e akteve nënligjore (VKM dhe Udhëzime) si derivate të ligjit të mësipërm, ku mos miratimi i tyre kanë krijuar një ngërç në funksionimin e institucionit.

-Universiteti Politeknik i Tiranës, për periudhën prej daljes së ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë e në vijim, *nuk ka marrë asnjë masë për të përditësuar Statutin dhe rregulloret e funksionimit me ndryshimet ligjore që ka pësuar kuadri ligjor mbi arsimin e lartë*, konkretisht ligji”. UPT ka vijuar të funksionojë me Statutin e miratuar nga Senati në datën 25.06.2008, si dhe Rregulloren e Brendshme, miratuar me urdhrin nr. 60, datë 26.06.2015, të Rektorit të UPT. Për rrjedhojë, detyrat dhe të drejtat e personelit të institucioneve të arsimit të lartë nuk janë përcaktuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njëkohësisht edhe procedura e punësimit të personelit akademik pranë departamenteve të UPT është hartuar nga Rektorati në Tetor 2010, procedurë e cila nuk është rishikuar pas ndryshimeve që ka pësuar Ligji për Arsimin e Lartë. Kështu edhe kriteret për punësim për çdo kategori të personelit akademik dhe administrativ duhet të përcaktohen në përputhje me legjislacionin në statutin e institucionit dhe rregulloren e brendshme.

-Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm të administratës së Rektoratit të UPT-së konstatohet se, ende *nuk është plotësuar njësia e auditimit të brendshëm*, rekomandim i lënë në auditimin e mëparshëm dërguar me shkresën nr.850/7 prot datë 05.05.2014.

Në strukturën organike aktuale (e cila ende nuk është e miratuar dhe vazhdon të jetë në një proces të tejzgjatur për pozicionimin e saj), ekziston “struktura” me 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist (vakant), ku vetëm përgjegjësi i sektorit është i punësuar, në kundërshtim me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të njëjësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.

Nga ana e titullarëve të UPT-së, nuk është përmbushur detyrimi ligjor dhe administrativ, për plotësimin e vendeve vakante në sektorin e auditimit, pasi kjo strukturë organizative nuk plotëson kërkesat e minimumit ligjor, 1 drejtues dhe 2 specialistë, gjendje e cila vazhdon edhe me momentin e miratimit të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, ku tashmë vendim marrja nuk është e titullarit (Rektorit) por e strukturës kolegjiale (Bordi i Administrimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

- Nga auditimi me objekt “Ndërtimi i shtesës së Korpusit Kryesor të Universitetit Politeknik të Tiranës”, rezultoi se pas miratimit të projektit fillestar Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit, është kërkuar hartimi dhe miratimi i projektit të shtesës së Korpusit Kryesor në Këshillin Kombëtar të Restaurimit, me qëllim unifikimin e veshjes së jashtme duke u referuar materialeve të fasadës së korpusit qendror të UPT, i shpallur Monument Kulture i kategorisë së dytë me urdhër nr. 122 prot. datë 05.03.2007, në bazë të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, ku në thelb është kërkuar dhe ndryshimi i fasadës së shtesës së UPT-së, duke mos e bërë eficiente projektin e mëparshëm që fondet publike të përdoren me ekonomikitet. Zërat e pandryshuar të cilat ishin në preventivin fillestar, ruajtën të njëjtin çmim njësi, ndërsa zërat e rinj u vendosën me negocim. Në procesverbalin e datës 20.04.2015, midis palëve, është negociuar për çmimet e reja, ku zëri “Veshje fasade me pllaka mermer traventinë 100 cm x 50 cm, trashësi 3 cm, me ngjyrë dhe teksturë si monumentet e kulturës në sheshin “Nën Tereza”, e ventiluar, me strukturë mbajtëse metalike të galvanizuar, me ankorim vida inoksi, me kapëse çeliku inoksi”, u propozua me 8,800 lekë/m² dhe pas negocimit u ul me 240 lekë/m², ku u miratua çmimi 8,560 lekë, ku sasia përfundimtare rezultoi 2,858.75 m², me vlerë 24,470,900 lekë pa TVSH. Ndërkohë me projekt-preventivin fillestar zëri nr. 30 “Veshje me fasadë me pllaka traventinë trashësi 3 cm, e ventiluar, me strukturë mbajtëse metalike e galvanizuar, me ankorim vida inoxi, me kapëse çelik inox”, ka qenë e parashikuar në sasinë prej 451 m², me çmim të ofertuar 1,800 lekë/m². Në thelb zëri i veshjes me traventinë është në kuptimin e njëjtë të procesit të punës, por me ndryshimin e fasadës dhe përmasave të saj ka ndryshuar edhe çmimi.

Përsa më sipër, ndryshimi i fasadës u shoqërua edhe me ndryshim preventivi shtesë i kontratës me vlerë prej 54,401,280 lekë me TVSH, me financim buxheti i shtetit. Ky ndryshim vjen si rrjedhojë e mos koordinimit të Institucioneve të nivelit qendror me UPT-në, duke sjellë si pasojë rritjen e vlerës së kontratës. Rritja e vlerës së kontratës krahasuar me kontratën fillestare nuk konsiderohet dëm ekonomik nga Grupi i Auditimit të KLSH-së por rritje e kostos së objektit dhe përdorim jo efektiv i fondeve publike që akorduan shtesë nga buxheti i shtetit, për shkak të ndryshimit të projektit të tenderuar.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga Universiteti Politeknik Tiranë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale pwr nga sasia, **por janë materiale për nga konteksti**⁴, të cilat konsistojnë si më poshtë:

1. Nga auditimi, u evidentua mungesa e akteve nënligjore, duke rekomanduar masa dhe përmushje ligjore adresuar MASR, në cilësinë e ministrisë së linjës e cila ka detyrimin të nxjerrë apo të propozojë miratimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit të nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”. Kjo gjë ka sjellë që UPT ka funksionuar, duke mos përditësuar statutin dhe rregulloret

⁴ ISSAI 1320: Përcaktimi i materialit për nga konteksti përfshin gjykimin profesional të audituesit, i cili ndikohet nga kuptueshmëria që ka audituesit nga njësisë, procedurave të vlerësimit të riskut, si dhe natyrës dhe shkallës së shkeljeve të konstatuara



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN e LIGJSHMËRISË DHE REGULLSHMËRISË FINANCIARE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

sipas kërkesave të ligjit të ri të arsimit të lartë, duke mos u pasqyruar në mënyrë të plotë situatën ligjore dhe atë faktike.

2. UPT, në përgjithësi ka vepruar në përputhje me ligjet dhe rregullat që rregullojnë veprimtarinë e UPT-së. Krahas anëve pozitive u konstatuan dhe të meta dhe mangësi në procedurat e prokurimit publik, pagesave të ndryshme, në mosfunksionimin si duhet të veprimtarisë së auditimit të brendshëm, krahas këtyre mangësive u konstatuan edhe pagesa të parregullta në aspektin e vetvlerësimit të institucionit për akreditimin e tij si Universitet Publik në shumën prej 1.5 milionë lekë, si dhe pagesa të tjera të parregullta në shpërblimin e Bordit të Administrimit duke sjellë përfitim të paderjtë të anëtarëve të këtij bordi në shumkën prej 280 mijë lekë.

3. Sistemet e kontrollit të brendshëm, nuk kanë funksionuar në disa komponentë të tij si mosfunksionimi i plotë i veprimtarisë së auditit të brendshëm, evidentimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut, përcaktimi i aktiviteteve të kontrollit shtesë për minimizimin e tyre si dhe përcaktimi i gjurmës së auditimit.

4. UPT ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fazën e planifikimit, zbatimit dhe raportimit të Projektbuxheteve afatmesme dhe vjetore, ka dorëzuar në afat dhe ka përgatitur në përputhje me kriteret e vlerësimit pasqyrat financiare, si dhe ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit për inventarizimin e pronës.

Opinion i kualifikuar:

Në opinionin e KLSH-së, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, përvec efekteve të cështjeve që përshkruhen në paragrafin e Bazës për Opinion të Kualifikuar, transaksionet e lidhura me llogaritë vjetore të Universitetit Politeknik të Tiranës për periudhën objekt auditimit, përputhen në të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT